



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë”

Tiranë 2025

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	6
1.1 Konteksti i problemit social.....	6
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	7
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	8
2.4 Peshë në buxhet	10
2.5 Feedback-u i subjektit.....	14
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	14
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	14
3.2 Objektivi i auditimit.....	15
3.3 Pyetjet e auditimit	16
3.4 Fushëveprimi i auditimit	16
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	17
4.1 A kanë kryer institucionet përgjegjëse monitorim të duhur e të mjaftueshëm të cilësisë së ujit të lumit të Lanës?	17
4.1.1 A kanë kryer institucionet përgjegjëse monitorimin e cilësisë së trupit ujqor “Lumi Lana”? ...	17
<i>Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer monitorim të plotë të stacioneve të monitorimit dhe të treguesve të përcaktuar</i>	<i>17</i>
4.1.2 Si ka qenë ecuria ndër vite e cilësisë së trupit ujqor “Lumi Lana”?	24
<i>Lumi Lana ka treguar vazhdimisht një nivel të konsiderueshëm ndotje në stacionet e monitoruara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit</i>	<i>24</i>
4.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masa efektive për eliminimin e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane të patrajuara në lumin Lana?	34
4.2.1 A janë marrë masa për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve me qëllim eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin Lana?	34
<i>Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës Kanalizime Tiranë nuk rezultoi të kenë kryer investime të përshtatshme për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve</i>	<i>34</i>
4.2.2 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse trajtimin e ujërave të ndotura urbane që gjenerohen në qytetin e Tiranës?	53
<i>Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime, Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës – Kanalizime Tiranë sh.a. nuk kanë arritur të sigurojnë trajtimin e ujërave të ndotura urbane që gjenerohen në qytetin e Tiranës</i>	<i>53</i>

AKRONIMET

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve
AMBU	Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore
UKT	Ujësjetllës Kanalizime Tiranë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
ITUN	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
PMBU	Plani për Menaxhimin e Basenit Ujor
PKMM	Plani Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit
RGJM	Raport i Gjendjes në Mjedis
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
KFU	Kodi i Furnizimit me Ujë
JICA	Japan International Cooperation Agency
TU	Trup ujor
KA	Kriter auditues
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	European Organization of Supreme Audit Institutions
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions

PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “*Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në lumin e Lanës në Tiranë*” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin e masave të marra nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës – Kanalizime, Bashkia Tiranë, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a., Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, mbi situatën e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin Lana.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore përfaqëson një prioritet strategjik për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, në përputhje me objektivat kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Ruajtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, në veçanti, kërkon ndërhyrje të mirëkoordinuara në të gjithë ciklin e menaxhimit të ujit, përfshirë kontrollin e ndotjes nga burimet urbane. Në këtë kontekst, trajtimi i ujërave të ndotura urbane mbetet një nga sfidat më të mëdha për administrimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në vend. Si një komponent kyç i infrastrukturës mjedisore urbane, mungesa ose mosfunksionimi i sistemeve të trajtimit ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e lumenjve dhe cenimin e cilësisë së jetës në zonat urbane.

Rrjeti i kanalizimeve në qytetin e Tiranës është projektuar i tillë që shkarkon drejtpërdrejt dhe pa asnjë trajtim në lumin Lana, ndërkohë që në zonat periferike të qytetit të Tiranës kryesisht shkarkimet janë individuale. Investimet e kryera nga UKT sh.a, si institucion varësie i Bashkisë Tiranë, kryesisht kanë qenë të orientuara më shumë në sektorin e furnizimit me ujë, në krahasim me sektorin e rrjetit të kanalizimeve. Bashkia Tiranë dhe UKT sh.a. nuk rezultoi të kenë marrë masa për planifikimin e investimeve të tilla që të minimizojnë shkarkimin e ujërave të ndotura urbane në lumin Lana.

Në këtë drejtim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka siguruar monitorimin e pjesshëm të treguesve mjedisorë në lumin e Lanës, duke monitoruar vetëm 2 nga 4 stacionet e përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për lumin Lana. Monitorimi i kryer nga AKM ka konsistuar kryesisht në treguesit fiziko-kimikë, ndërsa për vitet 2022-2023 është monitoruar edhe prezenca e metaleve të rënda. Në të gjithë Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga të dhënat e monitorimeve të vëna në dispozicion nga AKM, lumi Lana konstatohet në Klasën V – Gjendje e keqe, ku shfaqen vlera përtej limiteve të përcaktuara të nevojës biokimike për oksigjen, fosforit, amoniakut, nitrateve, që dëshmojnë një nivel të lartë ndotjeje, të shkaktuar kryesisht nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane. Pavarësisht se këto raporte, përpos faktit që janë publike, vazhdimisht u janë dërguar institucioneve të qeverisjes qendrore e vendore, situata mjedisore në lumin Lana vijon të mbetet e pandryshuar, madje në monitorimin e vitit 2024 të dy stacionet u klasifikuan në Klasën V – Gjendje e keqe.

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane ITUN Kashar, parashikuar për të kryer një nivel trajtimi sekondar (për kapacitetin 350,000 p.e) për fazën e parë dhe terciar në nivelin përfundimtar të trajtimit (për kapacitetin 681,680 p.e), është jashtë funksionit. Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze dhe është ratifikuar në Kuvend me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008. Kjo kontratë është ndërprerë në vitin 2018 dhe deri në këtë datë, punimet ishin kryer rreth 70% ose në vlerën 56 Milion Euro. Që nga ai moment, palët iu drejtuan Gjykatës së Arbitrazhit, i cili nëpërmjet vendimmarrjes së vitit 2024, ka përlllogaritur një detyrim prej rreth 13.5 milionë euro dëmshpërblim nga pala shqiptare për kontraktorin, për ndërprerjen e njëanshme të kontratës.

Që nga ndalimi i punimeve në vitin 2018, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve ka realizuar shërbimin e mirëmbajtjes së investimit nëpërmjet procedurave të prokurimit. Ky shërbim në kantierin e implantit të trajtimit të ujërave të ndotura, është kryer me qëllim ruajtjen e strukturave dhe investimit të kryer, për në momentin e rivënies në jetë të projektit të ITUN Kashar. Mirëmbajtje e kryer nuk ka parandaluar problematikat, pasi fokusi kryesor i mbrojtjes së strukturave (investimit) ka patur një peshë shumë të vogël ose nuk është parashikuar aspak në zërat e punimeve të mirëmbajtjes, punime si mbrojtja nga ndryshkja e strukturave të hekurit, masat për

mbrojtjen nga rrëshqitjet e tokës, etj. Aktualisht, AKUK është duke kryer procedurat për përzgjedhjen e konsulentit, duke synuar rivënien në jetë të projektit të ITUN Kashar.

Miratimi i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024 – 2029 është një hap pozitiv në përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* të BE-së, lidhur me menaxhimin e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë dokument është paraqitur gjendja e trupave ujorë që bëjnë pjesë në këtë basen ujor, ndër të tjerë edhe për lumin Lana. Përpos evidentimit të statusit ekologjik të secilit prej tyre, PMBU Ishëm ka përcaktuar edhe masat që institucionet përgjegjëse të qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të marrin për përmirësimin e cilësisë në këtë trup ujor. Pavarësisht sa më sipër, Bashkia Tiranë nuk rezultoi të ketë marrë masat e nevojshme për hartimin e plan-veprimeve lidhur me zbatimin e masave takuese të përcaktuara në PMBU Ishëm, lidhur me lumin Lana, për të dëshmuar angazhimin institucional për përmirësimin e situatës.

Pavarësisht përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së lidhur me menaxhimin e burimeve ujore dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane, institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore nuk kanë zbatuar kërkesat që rrjedhin nga ky kuadër ligjor, sa i përket situatës së shkarkimit të ujërave të ndotura të patrajuara urbane në lumin e Lanës.

Për të gjitha çështjet e mësipërme, janë dhënë rekomandime në drejtim të përmirësimit të shkaqeve që çojnë në këto mangësi me qëllim eliminimin dhe zbutjen e ndikimeve negative që shkarkimet e ujërave të ndotura urbane në lumin e Lanës kanë në mjedis dhe shëndetin e popullatës.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Ndotja e Lumit të Lanës në kryeqytetin e vendit tonë i tejkalon ndjeshëm standardet kombëtare dhe të Bashkimit Evropian (BE), kriteret e Direktivës së BE-së për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe udhëzimet globale të cilësisë së ujit, çka e bën atë lumin e dytë më të ndotur në Shqipëri (pas lumit Gjanica në Fier), referuar Raporteve të Gjendjes në Mjedis të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nivelet e tilla të ndotjes së ujërave të këtij lumi përbëjnë kërcënim për shëndetin publik, ekosistemet dhe cilësinë e jetesës për popullatën e Tiranës dhe zonave përreth. Nga të dhënat e siguruar nga Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU), Lumi Lana, pjesë e Basenit Ujor Ishëm, buron nga malet e Dajtit dhe kalon përmes qytetit të Tiranës, përpara se të bashkohet me lumin e Tiranës dhe të formojnë lumin Ishëm. Ka një gjatësi prej rreth 21 km dhe shtrihet në një rajon me densitet të lartë urban. Lumi Lana është një nga lumenjtë kryesorë në Tiranë, me probleme të ndotjes për shkak të shkarkimeve urbane dhe industriale. Në nivel baseni, BU Ishëm mbulon një sipërfaqe të konsiderueshme që përfshin zona urbane e rurale dhe përballet me sfida të ndotjes, kryesisht nga urbanizimi. Ndotja kryesore në lumin e Lanës vjen nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, mbetjet urbane, industriale, ndërtimet pa leje që ngushtojnë rrjedhën e lumit; erozioni i tokës dhe dëmtimi i ekosistemit lumor. *Monitorimet* tregojnë nivele të larta të metaleve të rënda, materieve organike dhe ndotësve të tjerë fiziko-kimik.

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të qytetit të Tiranës është një sistem i kombinuar që përfshin ujërat e bardha dhe ato të përdorura, urbane dhe industriale. Që nga viti 1964, rrjeti i ujërave të ndotura të qytetit të Tiranës është projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që ky sistem të derdhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në lumin e Lanës. Nga UKT sh.a. bëhet me dije se numri i pikave të shkarkimit të kolektorëve që shkarkojnë në këtë lumë është afërsisht 85, sa i përket segmentit të sistemit të shtratit të këtij lumi, nga Shkoza e deri tek “Pallati me Shigjeta”.

Në vitin 2008, Shqipëria siguroi një kredi të butë përmes JICA (Japan International Cooperation Agency) për ndërtimin e një *impianti të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)*. Ky projekt ishte një hap i madh drejt përmirësimit të infrastrukturës urbane, duke premtuar një zgjidhje afatgjatë për trajtimin e ujërave të zeza, ujëra të cilat për vite me radhë kanë rrjedhur të patrajtuara drejtpërdrejt në lumin e Lanës. ITUN Kashar synonte të pastronte ujërat e ndotura përpara se ato të ktheheshin në natyrë, duke përmirësuar cilësinë e jetës për mbi 350,000 banorë. Punimet nisën në vitin 2014, me një kontratë në vlerë prej 81 milionë eurosh me kompanitë që morën përsipër zbatimin e projektit. Në vitin 2018, MIE ndërpreu kontratën me kompanitë ndërtuese, konflikt i cili vijoi ndërmjet palëve në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, u zhvillua dhe përfundoi me vendim kundër për shtetin shqiptar dhe vlerë financiare të llogaritur deri tani rreth 13.5 milion Euro, pa llogaritur shpenzimet e përfaqësimit dhe mirëmbajtjes së veprës pjesore, e cila e thellon këtë efekt financiar.

Eliminimi i derdhjeve të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara në lumin e Lanës do të kishte efekte pozitive të dukshme në mjedis, shëndet publik dhe ekonomi. Ai do të çonte në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm, duke përmirësuar cilësinë e jetës për banorët dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më

të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me masat e marra nga institucionet shqiptare për eliminimin e derdhjeve të ujërave të përdorur të patrajtuar në lumin e Lanës.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Problematikat lidhur me menaxhimin e integruar të burimeve ujore, sikurse janë dhe derdhjet e ujërave të ndotur të patrajtuar në ujëra sipërfaqësorë, janë procese komplekse që kërkojnë bashkëpunimin dhe koordinimin e disa institucioneve dhe agjencive. Sa i përket çështjes specifike, këtu do të prezantohen subjektet e përfshira në auditimin mbi masat e marra për eliminimin e derdhjes së ujërave të patrajtuara në lumin Lana, duke përshkruar funksionin dhe rolin e tyre në këtë proces.

Bashkia Tiranë, si organi i qeverisjes vendore që ka nën administrim pjesën më të madhe ku shtrihet lumi i Lanës, që nga burimi e deri pranë bashkimit me lumin e Tiranës, sipas nenit 23 të Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, është përgjegjëse për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territorin e juridiksionit të saj.

Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, referuar KFU-së, ka për objekt largimin e kontrolluar të ujërave të ndotura që prodhohen në zonën e shërbimit nga konsumatorët, si dhe trajtimin e tyre përpara shkarkimit në mjedisin e trupës ujore pritëse përfundimtare në rast se zona e shërbimit është e pajisur me impiant trajtimi, mirëmbajtjen e elementëve përbërës të sistemit të kanalizimit, si dhe mbledhjen e tarifës nga konsumatorët për këto shërbime.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që lidhen me burimet e integruara të ujit në Shqipëri, duke siguruar funksionimin dhe monitorimin efektiv të sistemit plotësisht të integruar të ujit në vend.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizime (AKUK) menaxhon sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri, nën varësinë e MIE-s. Ajo harton strategjinë për zhvillimin e sektorit dhe planifikon investimet për ndërtimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujësjiellës-kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. AKUK mbikëqyr projektet që financohen nga buxheti i shtetit, bashkitë, shoqëritë e “Ujësjiellës-Kanalizimeve” dhe institucionet ndërkombëtare, duke siguruar zbatimin e rregullave teknike dhe monitorimin e tyre.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka si funksion monitorimin e cilësisë së mjedisit në Shqipëri¹. AKM është institucioni përgjegjës për zbatimin e Planit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, pjesë e të cilit është dhe monitorimi i ujërave sipërfaqësorë (ndër të tjera lumenjtë), ku janë parashikuar edhe stacionit e monitorimit për lumin e Lanës. Këto rezultate AKM i pasqyron në Raportin e Gjendjes së Mjedisit, i cili është një raport i përvitshëm ku krahas të dhënave të tjera mbi tregues të ndryshëm mjedisorë publikohen edhe të dhënat mbi monitorimet e kryera përgjatë gjithë vitit.

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Kritere politike:

- VKM nr. 73, datë 07.02.2018 “*Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2027*;
- VKM nr. 624, datë 08.11.2023 “*Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm*”;
- VKM nr. 448, datë 26.7.2023 “*Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030*”.

¹ Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, Nr. 120 datë 12.01.2021, neni 5, pika f.

Kritere teknike:

- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”;
- Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 29/2024 “Për burimet ujore”;
- Ligji nr. 431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 246, datë 30.04.2014 “Për vendosjen e standardeve të cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore”;
- VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”;
- VKM nr. 83, datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”;
- VKM nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare Të Mjedisit”;
- VKM nr. 431, datë 17.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.”;
- VKM nr. 221, datë 26.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbajtjet”;

Kriteret e monitorimit dhe raportimit:

- Raporte vjetore të gjendjes së mjedisit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Raporti i Agjencisë Evropiane të Mjedisit, 2023

Praktikat e mira:

- Direktiva 2000/60/KE “Direktiva Kuadër e Ujit”;
- Direktiva 91/271/KE “Mbi trajtimin e ujërave të ndotura urbane”;
- Direktiva 2008/105/KE “Mbi standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikës së ujit”;
- Direktiva 2013/39/BE “Ndryshimi i Direktivave 2000/60/KE dhe 2008/105/KE lidhur me substancat prioritare në fushën e politikës së ujit”.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Raporti i Gjendjes në Mjedis

Bazuar në aktivitetin monitorues në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, AKM përgatit Raportin e Gjendjes së Mjedisit, ku paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë (përfshirë ujërat sipërfaqësorë, si lumenjtë, etj.), si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e tyre. Qëllimi kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit është që të kuptohen pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga sektorë të ndryshëm dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative.

Duke qenë se një ndër fokusimet kryesore të këtij auditimi do të jetë edhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane grupi i auditimit ka përmbledhur në vijim disa nga dokumentet kryesore politike lidhur me këtë çështje.

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2027

Këshilli i Ministrave, me anë të VKM-së nr. 73, datë 07.02.2018 ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2027. Ndër objektivat strategjike të përcaktuar në pikën 2.5 të këtij dokumenti, citojmë objektivin nr. 2 “*Cilësia e ujit*”, ku synohet sigurimi i një cilësie të mirë të ujit të të gjitha burimeve ujore, duke arritur statusin e “*gjendjes së mirë të ujit*” deri në vitin 2027, nëpërmjet aplikimit të akteve dhe akteve nënligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së. Ndër rezultatet kryesore të pritshme përfshihet dhe ulja e ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimit të shkarkimeve të lëndëve kimike të rrezikshme në trupa ujorë.

Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm (PMBU) 2024-2029

Këshilli i Ministrave, me anë të VKM-së nr. 624, datë 08.11.2023, ka miratuar Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024-2029. PMBU-ja është mjeti kryesor për menaxhimin e trupave ujorë brenda një rajoni të caktuar baseni ujor, në këtë rast zona e Basenit të Lumit Ishëm, ku përfshihet dhe lumi i Lanës. Ky dokument përmban përshkrimin e përgjithshëm të basenit ujor, duke përfshirë kryesisht hidrometeorologjinë, përdorimin e tokës dhe të ujit, kategorizimin e trupave ujorë, vlerësimin teknik të gjendjes bazë, përmbledhjen e presioneve dhe ndikimeve në trupat ujorë, përmbledhjen e masave që synojnë zbutjen e ndikimeve të identifikuara, analizë ekonomike/ teknike për trupat ujorë që zakonisht përshkruhen si “trupa tepër të modifikuar” për të cilët nuk është e mundur arritja e statusit të mirë, analizën ekonomike për identifikimin e rikuperimit të nevojshëm të burimeve dhe kostove mjedisore të shërbimeve të ujit, etj.

Strategjia Kombëtare e Sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Këshilli i Ministrave, me anë të VKM-së nr. 448, datë 26.7.2023, ka miratuar Strategjinë Kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2023-2030. Në analizën e përgjithshme të faktorëve, të cilët kanë një ndikim domethënës në qasjen strategjike që do të synohet të implementohet në sektorin e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, grupi i punës është ndalur në mënyrë të veçantë në faktorin demografik, hidrologjik dhe atë zhvillimor.

Faktori i parë, i cili është marrë në shqyrtim për të analizuar skenarët e zhvillimit të sektorit, është ai demografik. Referuar të dhënave të INSTAT-it të vitit 2023, popullsia në Shqipëri: 2.761.785 banorë, ndërkohë projeksioni i popullsisë nga INSTAT-i për vitin 2031 llogaritet të jetë 2.745.996 banorë. Pra vihet re se numri i popullsisë pothuajse do të mbesë i njëjtë. Rreth 54% e popullsisë së vendit jeton në qytete. Tri bashkitë më të mëdha (Tiranë, Durrës dhe Fier) përbëjnë gjysmën e popullsisë totale, ku 30% e popullsisë totale banon në Bashkinë e Tiranës, pasuar nga Bashkia Durrës me 11% dhe Bashkia Fier me 10%. Faktori i dytë i analizuar është ai hidrografik. Arsyeja e analizës së këtij faktori është e rëndësishme për të bërë një pasqyrim të qartë të potencialeve të burimeve ujore që janë në dispozicion, sfidat mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe të cilësisë së burimeve ujore nga ujërat e ndotura urbane. Faktori i tretë i rëndësishëm për t’u mbajtur në konsideratë është dhe ai i zhvillimit ekonomik të vendit, ku kryesisht për efekt të këtij dokumenti strategjik, rëndësi të veçantë merr zhvillimi i vrullshëm infrastrukturor ndërtimor².

Në këtë dokument politik, sa i përket qëllimit të politikës nr. 2 “*Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura për popullsinë*”, janë përcaktuar objektivat strategjike në nivel kombëtar, si më poshtë:

Sa i përket mbulimit me *sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura*, deri në vitin 2025 synohet mbulimi 55.5%, ndërsa për vitin 2030 synohet 65.5%.

Sa i përket mbulimit me *sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura*, deri në vitin 2025 synohet mbulimi 16.5%, ndërsa për vitin 2030 synohet 25%.

² Strategjia Kombëtare e furnizimit me ujë dhe e kanalizimeve 2023-2030, fq 5

2.4 Pesha në buxhet

Në funksion të identifikimit të vlerësimit financiar për problemin social në fokus, grupi i auditimit identifikoi shumatat monetare të akorduara nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat e veta apo nga financimi i huaj, për subjektet nën auditim, të detajuara në formë tabelare dhe grafike sipas dinamikës kohore të periudhës audituese.

I. Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK)

AKUK është person juridik publik, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për infrastrukturën. AKUK financohet nga buxheti i shtetit dhe çdo burim tjetër i ligjshëm financiar, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi për statusin që institucioni ka bazuar në VKM nr. 431 datë 11.07.2018, për ngritjen dhe funksionimin e saj.³ Lidhur me aspektet financiare të sektorit UK, dokumenti i Strategjisë në pikën 1.4.7 “Infrastruktura dhe Investimet në Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve” ka theksuar se:

- ✚ Sektori i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri është duke u përballur me infrastrukturën e amortizuar si pasojë e nevojave për mbulim me investime për të gjithë sistemet në zonat urbane dhe rurale. Infrastruktura aktuale në sektorin e ujit mbetet e amortizuar si rezultat i nevojave për investime për të përmbyllur të gjithë sistemet.
- ✚ Për shërbimet e ujësjetllës, asetet fikse për banorë variojnë nga 0 në 157,000 lekë/banorë me një mesatare prej 16,000 lekë/banorë, ndërsa mesatarja për ujërat e ndotura është shumë më e ulët, me 13,000 lekë/banorë dhe shkon nga 0 deri në 359,000 lekë/banor. Kjo do të thotë që kostot e amortizimit dhe kostot e mirëmbajtjes (llogaritur si pjesë e vlerës së aseteve) do të rriten me kalimin e kohës kur infrastruktura e vjetër ekzistuese do të zëvendësohet dhe zgjerohet, duke përkeqësuar mbulimin e kostove operacionale për shërbimet UK.


Sipas të dhënave të administruara nga AKUK fondet e investimeve për periudhën 2013-2024 janë:

Të dhënat në mijë lekë

AKUK, Buxheti, plani i shpenzimeve për periudhën 2013 deri në vitin 2023; (Buxheti i shtetit + Financimi i Huaj) Periudha e analizuar												
Emërtimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Total FU+K (Financimi i Huaj)	3 179 712	7 351 754	7 175 376	8 504 013	6 435 508	3 734 721	5 133 868	2 261 270	2 578 312	1 669 274	1 713 274	21 336 865
Total FU+K (Buxheti i Shtetit)	3 036 542	3 040 458	4 122 056	4 542 324	4 187 758	3 380 970	4 139 814	7 904 355	12 910 076	8 428 226	12 223 972	40 951 199
Totali i investimeve	6 216 254	10 392 212	11 297 432	13 046 337	10 623 266	7 115 691	9 273 682	10 165 625	15 488 388	10 097 500	13 937 246	62 288 064

Burimi: Strategjia Kombëtare UK, fq 21; AKUK dhe INSTAT, si dhe përpunuar nga grupi i auditimit

Të paraqitura në formë grafike, investimet e AKUK gjithësej për periudhën 2013-2023 janë si më poshtë:



Burimi: Të dhënat nga AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit.

³Urdhër nr. 88 datë 24/02/2020 Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e AKUM, neni 20.


Grupi i auditimit të KLSH ka analizuar komponentët e strukturës buxhetore të investimeve për sa i takon peshës që zënë shpenzimet për Ujësjet, për Kanalizime dhe Impiantin e trajtimit të UN për periudhën 5-vjeçare 2019-2023, ku paraqitet situata si në tabelë.

Të dhënat në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Totali (2019-2024)
Total U+ K + ITUN (Financimi i Huaj)	5,133,868	2,261,270	2,578,312	1,193,186	1,592,740	1,473,559	14,232,935
Total U + K + ITUN (Buxheti i Shtetit)	4,139,814	7,904,355	12,910,076	8,428,225	12,203,565	11,192,650	56,778,686
TOTAL UJESJELLËSA	6,003,857	7,757,662	12,809,161	7,491,303	11,325,764	10,059,629	55,447,376
Buxheti i Shtetit	2,532,078	6,320,704	11,520,434	6,656,035	10,247,290	8,586,070	45,862,611
Financimi i Huaj	3,471,779	1,436,958	1,288,727	835,268	1,078,474	1,473,559	9,584,766
TOTAL KANALIZIME	2,130,820	1,402,920	2,156,380	1,270,951	1,681,262	1,557,846	10,200,179
Buxheti i Shtetit	616,402	686,241	866,795	934,381	1,167,204	1,557,846	5,828,869
Financimi i Huaj	1,514,417	716,679	1,289,585	336,570	514,058	0	4,371,310
TOTAL IMPIANTE (ITUN)	502,893	323,232	176,130	101,998	416,703	561,833	2,082,789
Buxheti i Shtetit	355,222	215,599	176,130	80,650	416,496	561,833	1,805,930
Financimi i Huaj	147,671	107,633	0	21,348	208	0	276,859
TVSH dhe Kosto Lokale	636,112	681,811	346,717	757,159	372,576	486,901	3,281,276
Ujeselësa	377,318	429,220	184,505	23,046	9,070	337,113	1,360,272
Kanalizime	244,456	214,072	16,943	546,346	257,459	149,788	1,429,064
Impiante	14,338	38,519	145,269	187,767	106,046	0	491,940
Totali i investimeve Financim i Huaj + Buxhet Shteti	9,273,682	10,165,625	15,488,388	9,621,412	13,796,305	12,666,209	71,011,621

Burimi: AKUK

Në trajtë grafike, orientimi i trendeve të shpenzimeve të AKUK për periudhën paraqitet në vijim:



Nga analiza e mësipërme rezultoi se:

1. Nga auditimi në AKUK, investimet nuk janë rritur në mënyrë lineare; ka një *përqendrim në v.2021 si një vit kulmor*. Financimi në v.2024 është më i ulët se në v.2019 për fushën e kanalizimeve, por është më i lartë për trajtimin e ujërave (impiantet) ku tregohet një *rritje afatgjatë*, por me luhajtje e këtyre financimeve. Nuk ka pasur shpenzime nga ana e AKUK në qytetin e Tiranës për periudhën e analizuar 2019-2024 në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura.
2. Financimit i investimeve në sistemin e furnizimit me ujë dhe infrastrukturën e kanalizimeve të ujërave të ndotura, ka evidentuar se raportet e financimit të huaj dhe të buxhetit të shtetit janë përmbysur me kalimin e viteve. Kështu,

- gjatë periudhës 2013-2019, ka dominuar në strukturë financimi i huaj kundrejt buxhetit të shtetit (duke u luhatur nga raportet 70% me 30% në vitin 2014 dhe 2015, e duke zbritur në mënyrë graduale 60% me 40% në vitet 2016 e 2017, dhe më tej në kuotat 50% me 50% në vitin 2018).

gjatë periudhës 2020-2024, kjo strukturë ka ndryshuar plotësisht, ku dominojnë investimet e financuara nga fondet e buxhetit të shtetit dhe financimi i huaj kalon në minorancë. Ky raport i financimit të buxhetit ndaj financimit të huaj bëhet 70% me 30% në vitin 2020, e duke rritur kontributin e buxhetit në mënyrë graduale 80% me 20% gjatë viteve 2021 dhe 2022, dhe më tej arrin në nivelin 86% ndaj 14% (në vitin 2023) dhe 70% me 30% (në vitin 2024).

II. Peshë e fondeve në buxhetin e Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a. (UKT sh.a.)

Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjetës kanalizimeve funksionojnë në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Vendimit të KM Nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur”. UKT sh.a. është shoqëri aksionere, e cila ka rezultuar nga:

- bashkimi me përthithje i shoqërisë së përthithur “Ujësjetësi Fshat” Tiranë, me shoqërinë përthithëse “Ujësjetës-Kanalizime Qytet” Tiranë, dhe është krijuar “Ujësjetës Kanalizime Tiranë” Sh.a. (2003);
- bashkimi me përthithje HEC Lanabregas -UKT në datën 28.12.2012 në bazë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.02, datë 27.08.2012 dhe Nr.03, datë 17.09.2012;
- ndarja e shoqërisë UKT: Në datë 22.08.2017 në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.11, datë 31.08.2016, janë miratuar modalitetet për ndarjen e aksionerëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetës Kanalizime Tiranë. Ndarja e shoqërisë UKT është miratuar në datë 20.11.2017, në bazë të Vendimit të Asamblesë Nr.11, datë 13.11.2017, mbështetur në VKM Nr.63, datë 27.01.2017, në 3 shoqëri të reja, të tilla si: Ujësjetësi Kanalizime Bashkia Kamëz, shoqëria Ujësjetësi Kanalizime Bashkia Vorë dhe Ujësjetësi Kanalizime Bashkia Tiranë

UKT sh.a. ka për objekt veprimtarie, shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjen e tij. Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimin dhe/ose blerjen e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitjen e tij, mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Studimin, projektimin e ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë me konsumatorët në zonën e shërbimit. Lidhjen e konsumatorëve me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Projektimin, miratimin dhe zbatimin e skemave të furnizimit me ujë. Zhvillimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duke e përshtatur atë me standardet ndërkombëtare. Shërbimin ndaj konsumatorit në funksion të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ato të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Zbatimin e rregulloreve higjeno-sanitare dhe mjedisore të miratuara për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Të dhëna ndër vite, 2019 – 2024 mbi sistemin e kanalizimeve nga UKT sh.a., si më poshtë:

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i klientëve	251.866	254.796	259.338	265.159	272.406	279.302
Shkalla e lidhjes – kanalizime (%)	91%	95%	94%	95%	94%	95%
Vëllimi mesatar i ujërave të ndotur/frymë	113 m3/v	116 m3/v	120 m3/v	121 m3/v	118 m3/v	121 m3/v
Sasia e ujit të ndotur të faturuar (m3/y)	29.528.922	28.120.741	29.519.899	30.346.808	30.545.397	32.144.619
Shkalla e arkëtimit (%)	89.34%	76.51%	84.68%	94.60%	95.52%	100.12%

Burimi: UKT sh.a. Tiranë

Niveli i te ardhurave nga shitja (niveli i faturimit) për UKT sh.a. gjatë periudhës 2019-2024 paraqitet si në tabelë:

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Vlera e faturuar Në lekë	3,222,951,258	2,912,344,923	3,128,155,139.8	3,237,175,815	3,244,884,942	3,396,924,344

Burimi: UKT sh.a.

Konkluzion:

Përmes investimeve kapitale, UKT sh.a. mund të ndikojë në rritjen e shkallës së mbulimit me shërbime të ujit tek qytetarët, entet shtetërore, dhe subjektet private; në zvogëlimin e nivelit të humbjeve në rrjet dhe në trajtimin e ujërave të ndotura. Pesha specifike që zënë fondet e shpenzuara për sistemin e kanalizimeve dhe të shkarkimit të ujërave të ndotur në totalin e buxhetit vjetor të UKT sh.a., është ende në nivele të ulëta, ngaqë mesatarja e fondeve vjetore të akorduara për rrjetin e kanalizimeve gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare është 13.2%, dhe analizuar sipas viteve përgjatë periudhës 2015-2024 variojnë nga 2-58% të investimeve gjithsej të shoqërisë së ujësjellës kanalizimeve Tiranë.

- Vetëm në 6 vite (2015, 2016, 2017, 2020, 2021 dhe 2024) rezultoi që pesha specifike e fondeve të investimeve të destinuara për rrjetin e kanalizimeve nga UKT sh.a. ndaj totalit të investimeve, është mbi nivelin mesatar (në%) të investimeve 10-vjeçarit të AKUK për rrjetin e kanalizimeve/totalit investime AKUK prej 14%, (përkatësisht 10,200 mijë /71,011 mijë).
- Niveli më i ulët i fondeve të orientuara për investimet kapitale në rrjetin e kanalizimeve e grumbullimit të ujërave të ndotura në masë absolute është në vitin 2019 prej 7 milionë lekë si dhe në vitin 2023 prej 11.3 milionë lekë.
- Në vitin 2022 që është shënuar niveli më i lartë i investimeve gjithsej nga UKT sh.a prej 2,791,574,968 lekë, pesha specifike e fondeve të shpenzuara për sistemin e kanalizimeve dhe grumbullimit të ujërave të ndotura është vetëm 2% e tyre, shumë kjo e barabartë me 57,2 milionë lekë.

Niveli i arkëtimit të faturës së ujit, (*fatura korrente dhe detyrimet e mbartura*) tregojnë se në vitin 2020 ka një rënie e ndjeshme në shkallën e arkëtimit (76.51%), kjo mund të jetë pasojë e pandemisë së COVID-19. Nga viti 2021 e në vazhdim, ka një rritje të qëndrueshme, duke arritur në 100.12% në 2024, dhe që tregon tejkallim të objektivit të parashikuar. Nga analiza e vlerave të arkëtuara: me përjashtim të rënies në vitin 2020, më pas vlerat e arkëtuara janë rritur çdo vit. Viti 2024 shënon rreth 13.7% rritje në krahasim me vitin 2020.

III. Pesha e fondeve në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

AKM është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të MTM-së. AKM-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme⁴. Për periudhën 2019-2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, fondet buxhetore të shpenzuara për monitorimin e cilësisë së ujërave rezultojnë si më poshtë:

Viti	Buxheti total	Fondi buxhetor për monitorimin e cilësisë së ujërave	Pesha specifike (%)
2019	69,883,295	4,047,550	5.8
2020	96,952,683	4,349,706	4.5
2021	137,321,902	2,701,564	2.0
2022	155,478,424	3,556,753	2.3
2023	184,696,131	6,754,000	3.7


Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet buxhetore të përdorura nga AKM në kuadër të programit “*Monitorimi i cilësisë së ujrave*” zënë një peshë specifike të ulët kundrejt buxhetit të përgjithshëm të institucionit. Ato variojnë nga 2.0% në vitin 2021 (që është niveli më i ulët i periudhës), deri në 5.8% në vitin

⁴ VKM nr. 568, datë 17.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Kapitulli I, pika 1.

2019 (që është niveli më i lartë relativ i tyre). Ndryshe nga tendenca e buxhetit të përgjithshëm të AKM që ka arritur çdo vit në rritje (nga 69.9 milionë lekë në vitin 2019 ka arritur në 184.7 milionë lekë në vitin 2023, ose me rritje 2.6 herë), ritmi i rritjes së fondeve për monitorimin është 1.6 herë, që në masë absolute i takon vetëm shtesës prej 2.7 milionë lekë.

Analizuar buxheti i përgjithshëm i këtij institucioni gjatë 5-vjeçarit 2019-2023, fondet totale janë 644 milionë lekë me progresion rritës nga viti në vit, kurse fondet e 5-vjeçarit për monitorim janë 21.4 milionë lekë, shumë kjo e barabartë me 3.3% të buxhetit të përgjithshëm. Fondet e buxhetit të shtetit që janë akorduar për programin e monitorimit të cilësisë së ujrave janë pakësuar me 32.5% në vitin 2021 dhe 12.2% në vitin 2022 kundrejt vitit referuar 2019 duke u pakësuar përkatësisht me -1.3 milionë lekë, dhe 490 mijë lekë.



Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

2.5 Feedback-u i subjektit

Subjektet e përfshira në auditim AKM, UKT, AMBU, AKUK, u janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit. Bashkia Tiranë, pavarësisht se kërkoi më shumë kohë për përgjigjen e pyetësorëve dhe përgatitjen e dokumentacionit, nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit evidenca të masave të marra nga Bashkia Tiranë lidhur me masat e marra për eliminimin e derdhjes së ujërave të ndotura urbane në lumin e Lanës.


3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve nën auditim, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë risku ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit

ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial.


Fig.1 Analiza SWOT



3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Masat e marra për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në lumin e Lanës në Tiranë” ka si objektivi kryesor vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve të përfshira në auditim, lidhur me masat e marra për menaxhimin e cilësisë së ujit të trupit ujor “Lumi Lana”, duke synuar reduktimin dhe eliminimin e derdhjeve të ujërave të ndotura urbane të patrajuara drejtpërdrejt në këtë mjedis pritës. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë mbi monitorimin e cilësisë së trupit ujor “Lumi i Lanës”, si dhe reduktimin/ eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane të patrajuara. Pas vlerësimit të aktivitetit të institucioneve subjekt i këtij auditimi, grupi i auditimit vlerëson se institucionet nuk kanë marrë masat e nevojshme për të garantuar eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin Lana në Tiranë.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur në fokus të tij vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, nga njëra anë për monitorimin e gjendjes mjedisore dhe të cilësisë së ujit në trupin ujqor "Lumi i Lanës" dhe nga ana tjetër mbi masat e marra për eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin Lana dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Auditimi është fokusuar në *shkarkimin e ujërave të ndotura urbane*, nisur nga evidentimi i vazhdueshëm i kësaj problematike në Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Grupi i auditimit ka marrë pjesë në një proces marrje mostre, në zbatim të programit vjetor të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësorë nga Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në dy stacione monitorimi të lumit të Lanës, përkatësisht (i) në Lanabregas dhe (ii) në Kashar. Gjithashtu, grupi i auditimit ka kryer vizitë në terren në kantierin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura ITUN Kashar. Kështu më konkretisht në këtë auditim janë trajtuar (i) monitorimi ndër vite i stacioneve të monitorimit në lumin e Lanës dhe publikimi i rezultateve, (ii) bashkëpunimi ndërinstytucional për marrjen e masave, (iii) planifikimi, nevojat, investimet dhe projektet që janë planifikuar/ zbatuar përgjatë periudhës objekt auditimi lidhur me rrjetin e kanalizimeve për të eliminuar derdhjen e ujërave të përdorura në lumin e Lanës, (iv) situata me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura ITUN Kashar dhe hapat e marra lidhur me rivënien në punë të tij.

Periudha objekt auditimi është 2020-2024, megjithatë të dhëna historike jashtë kësaj periudhe janë pasqyruar për të dhënë një panoramë më të qartë të ecurisë së treguesve të ndryshëm mjedisorë ndër vite.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Pyetja kryesore: A KANË GARANTUAR MASAT E MARRA NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË UJIT NË LUMIN LANA?

Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masa efektive për përmirësimin e cilësisë së ujit në lumin Lana.

Raportet e Gjendjes në Mjedis të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit konstatojnë prej vitesh se statusi i cilësisë së ujit në këtë trup uhor klasifikohet në gjendje shumë të ndotur, duke shfaqur përkeqësim edhe në fillim të rrjedhës në Lanabregas, përgjatë viteve të fundit.

Monitorimi i kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka qenë i pjesshëm, duke mos monitoruar të gjithë stacionet e monitorimit dhe të gjithë treguesit, për të vlerësuar plotësisht cilësinë e ujit dhe statusin ekologjik të lumit Lana.

Nga ana tjetër, mungesa e ndërhyrjes nga Bashkia Tiranë dhe Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a. në rrjetin e kanalizimeve, mospërfundimi i investimit për Impiantin e Trajtit të Ujërave të Ndotura Kashar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve, si dhe mungesa e ofrimit të zgjidhjeve alternative nga të gjithë këto institucione, ka sjellë që ujërat e ndotura urbane të pjesës më të madhe të qytetit të Tiranës të vijojnë të shkarkohen të patrajuara, duke ndikuar negativisht në cilësinë e ujit të këtij trupi uhor.

Situata aktuale paraqet nevojën për angazhim të menjëhershëm të institucioneve të sipërpërmendura, në zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në përfundim të këtij auditimit, për të garantuar përmirësimin e situatës.

4.1 A kanë kryer institucionet përgjegjëse monitorim të duhur e të mjaftueshëm të cilësisë së ujit të lumit të Lanës?

4.1.1 A kanë kryer institucionet përgjegjëse monitorimin e cilësisë së trupit uhor “Lumi Lana”?

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer monitorim të plotë të stacioneve të monitorimit dhe të treguesve të përcaktuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM) dhe aktet nënligjore plotësuese.

Për periudhën e auditimit të përcaktuar 2020 – 2024, për çdo vit Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, duke ngarkuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e tij. Në kreun V të VKM-së nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e PKMM”, i ndryshuar, përcaktohet se shpenzimet operative për monitorimin e cilësisë së mjedisit, për përpunimin e treguesve mjedisorë, si dhe për kontrollin e saktësisë së tyre, përballohen nga buxheti i ministrisë, i miratuar për këtë qëllim. Për administrimin e fondit të saj për monitorimin, ministria hyn në marrëdhënie kontraktore me institucionet e specializuara për monitorimin e mjedisit. Në pikën 4.1 të Aneksit I të VKM-së së sipërcituar listohen treguesit mjedisorë të gjendjes së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë (lumenjtë, liqenet), ku përfshihet (i) alkaliniteti, (ii) Konduktiviteti specifik, (iii) aciditeti, (iv) përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen NKO, (v) përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen NBO, (vi) përmbajtja e nitrateve dhe azotit, (vii) përmbajtja e fosforit P, (viii) përmbajtja e amonikut NH₂, (ix) vlera e pH-së, (x) vlera e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave, (xi) treguesit bakterialë. Në pikën 4, gërma Ç, të këtij Aneksi, sa i përket shkarkimeve të lëngëta urbane, përcaktohet monitorimi i cilësisë së tyre si pH, përmbajtja e NKO-së, përmbajtja e NBO5-së, alkaliniteti, aciditeti, përmbajtja e sulfureve, përmbajtja e amoniakut, përmbajtja e fenolëve, përmbajtja e fosforit, përmbajtja e azotit dhe metaleve të rënda.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka monitoruar të gjithë stacionet e monitorimit në lumin Lana të përcaktuar në PKMM.

Stacionet e monitorimit janë përcaktuar nga Projekti CEMSA (*Consolidation of the Environmental Monitoring System in Albania*), iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian, që synonte konsolidimin e sistemit të monitorimit mjedisor në Shqipëri dhe kishte për qëllim përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në kuadër të këtij projekti, u ngrit një rrjet i gjerë stacionesh monitorimi për të mbikëqyrur komponentë të ndryshëm mjedisorë, ku ndër të tjera është përcaktuar rrjeti i stacionit të monitorimit të ujërave sipërfaqësorë lumenj, në total 151 stacione, 4 prej të cilëve në pika të ndryshme të lumit Lana, si më poshtë:

Tabela nr. 1: Stacionet e monitorimit në lumin Lana

Nr.	Nr. rendor PKMM	Kodi i stacionit	Baseni	Lumi	Emri i stacionit	Gjatësia	Gjerësia
1	15	AL30R_La10	Ishëm	Lana	Lana (La), Dajti-Gurore, Tirana – në rrjedhën e Lanës (Gurore, Dajti, Tirana); rreth 200-300 në rrjedhën e poshtme të burimit në Gurore	41.34678333	19.89323056
2	16	AL30R_La60	Ishëm	Lana	Lana (La), Kashari – në lumin Lana pas Koka Kola Enterprise, rreth 200 m në rrjedhën e urës rreth 700-800 m larg nga Koka Kola që kryqëzohet me superstradën Tiranë-Durrës. (Al RV 27)	41.35869167	19.74591111
3	65	AL30R_La30	Ishëm	Lana	Lana (La), tek ura ne rrugën e Kavajës, ne kryqëzimin e Bulevardit Gj.Fishta & B.Curri	41.32240556	19.79173333
4	102	AL30R_La40	Ishëm	Lana	Lana (La), Casa Italia – rreth 50 m në rrjedhën e poshtme ne urën mbi lumin Lana ne fund te rrugës Todo Manco, rreth 600 metra mbrapa kompleksit Casa Italia	41.33870833	19.77645278

Burimi: Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit

Nga auditimi u konstatua se AKM-ja ka kryer monitorimin e 2 prej stacioneve, përkatësisht stacionet me nr. rendor 1 dhe 4 sipas tabelës më sipër. Nga AKM bëhet me dije se përzgjedhja e këtyre stacioneve është bërë në bazë të prioriteteve, pasi kjo vlerësohet sipas buxhetit në dispozicion, ku në një basen përzgjedhja e stacioneve të kampionimit kryhet sipas kriterit të përfaqësimit sa më të plotë të gjendjes së cilësisë së ujërave në varësi të shkallës së ndikimit të aktivitetit të njeriut, duke marrë në konsideratë gjithë gjatësinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, të mesme dhe të poshtme.

Qëllimi i përcaktimit të disa stacioneve të monitorimit përgjatë një trupi ujour është kryer nisur edhe nga tipologjitë e ndryshme të pjesëve të caktuara të këtij trupi ujour, për të evidentuar dhe identifikuar ndikimet/ presionet në secilën prej këtyre pjesëve. Pavarësisht se, edhe monitorimi i pjesshëm i kryer nga AKM-ja ka mjaftuar për të konkluduar se ndotja e lumit të Lanës nga shkarkimet e ujërave të ndotur urbane është në nivel të lartë, monitorimi i secilit prej këtyre stacioneve do të pasqyronte më qartë nivelin dhe llojin e ndotjes në secilën prej pjesëve përbërëse (me veçoritë përkatëse) të këtij trupi ujour. Kjo pasi, në shtrirje të ndryshme të lumit të Lanës karakterizohet aktiviteti i ndryshëm, p.sh. një pjesë e lumit të Lanës nga rrethrotullimi i Shkozës deri te Pallati me Shigjeta shtrihet në zonë të urbanizuar, ka shtrat të sistemuar, ndërkohë që pjesa tjetër ka rrjedhje të lirë. Pjesa nga Lanabregas e deri të rrethrotullimi i Shkozës dhe nga Pallati me Shigjeta e në vijim (zona periferike) është urbanizuar në dekadat e fundit dhe popullsia kryesisht shkarkon në gropa septike ose në përrenj/ kanale që kalojnë në afërsi të tyre në mënyrë individuale. Gjithashtu, pjesa pas zonës së Astirit konsiderohet edhe zonë industriale, pra tipologjia e shkarkimeve është e ndryshme nga pjesa e urbanizuar e qytetit të Tiranës.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka siguruar monitorimin e të gjithë treguesve të përcaktuar në PKMM.

Sa i përket përcaktimit në PKMM-të e miratuara nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit për vitet 2020 - 2024, të publikuara në faqen zyrtare të AKM-së, rezultoi se për stacionet e monitorimit në

trupat ujqorë sipërfaqësore lumenj (përfshirë stacionet në lumin e Lanës) do të monitorohen treguesit, si më poshtë:

Tabela nr. 2: Treguesit për t'u monitoruar në ujërat sipërfaqësorë lumenj

Treguesit mjedisorë të gjendjes					
Nr.	Treguesi mjedisor	Shpeshtësia	Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave	Institucioni përgjegjës për monitorimin	Institucioni përgjegjës për regjistrimin
1	Alkaliniteti	Çdo dy muaj	Përpunim statistikor/ paraqitje tabelare/ grafike	AKM	AKM
2	Konduktiviteti elektrik	Çdo dy muaj		AKM	AKM
3	Aciditeti	Çdo dy muaj		AKM	AKM
4	Nevoja kimike për oksigjen (NKO)	Çdo dy muaj		AKM	AKM
5	Nevoja biokimike për oksigjen (NBO)	Çdo dy muaj		AKM	AKM
6	Përmbajtja e kampionimeve të azotit N-NO ₂ , N-NO ₃	Çdo dy muaj		AKM	AKM
7	Përmbajtja e fosforit, P-PO ₄ , P-total	Çdo dy muaj		AKM	AKM
8	Përmbajtja e amoniumit	Çdo dy muaj		AKM	AKM
9	Vlera e pH	Çdo dy muaj		AKM	AKM
10	Vlera e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave	Çdo dy muaj		AKM	AKM
11	Qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve	Çdo dy muaj		AKM	AKM
12	Treguesit bakterialë	Çdo dy muaj		AKM	AKM
13	Transparenca (oksigjeni i saturuar), ngopshmëria me oksigjen	Çdo dy muaj		AKM	AKM
14	Lënda pezull	2 herë në vit		AKM	AKM
15	Oksigjeni i tretur	Stinore		ISHP	AKM
16	Metalet e rënda: Hg, Pb, Cd, As, Cu	4 herë në vit		Subjekti fitues në tender	AKM
Treguesit mjedisorë të ndikimit					
17	Cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve	Jo më pak se 4 herë në vit	Paraqitje tabelare dhe grafike	Subjekti fitues në tender	AKM
18	Erozioni i shkaktuar nga lumenjtë	2 herë në vit	Përpunim statistikor/ paraqitje tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM
19	Qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve	2 herë në vit		Subjekti fitues në tender	AKM
20	Tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.1	Vjetore		Subjekti fitues në tender	AKM
Treguesit mjedisorë të trysnisë					
21	Cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve	Jo më pak se 4 herë në vit	Përpunim statistikor/ paraqitje tabelare	Subjekti fitues në tender	AKM

Burimi: Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit

Nga auditimi u konstatua se AKM-ja ka monitoruar në vazhdimësi disa prej treguesve mjedisorë të gjendjes, si alkaliniteti, konduktiviteti elektrik, nevoja kimike për oksigjen, nevoja biokimike për oksigjen, përmbajtja e kampionimeve të azotit (N-NO₂, N-NO₃), përmbajtja e fosforit (P-PO₄, P-total), përmbajtja e amoniumit, vlera e pH, lënda pezull, oksigjeni i tretur.

Gjithashtu, nëpërmjet kontratës së lidhur me Universitetin Bujqësor të Tiranës, AKM-ja ka siguruar monitorimin e metaleve të rënda në lumin e Lanës për vitet 2022 – 2023, por jo për vitet e tjera periudhë auditimi.

AKM-ja nuk ka monitoruar/ siguruar monitorimin nëpërmjet kontratave me subjekte të treta, sa i përket aciditetit, vlerës së fonit radioaktiv natyror dhe radioaktivitetit të ujërave, qëndrueshmërisë së shtretërve të lumit, treguesit bakterialë, transparenca, cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumit, erozionit të shkaktuar, komponentë që përkojnë me treguesit mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë, sipas përcaktimit në PKMM.

Grupi i auditimit ka kërkuar vënien në dispozicion të shpalljeve/ publikimeve përkatëse, për të afuar subjektet e interesuara që mund të kryejnë analizat të cilat nuk kryhen nga AKM-ja, por nga AKM është bërë me dije se nuk ka shpallje/ publikime, por subjektet interesohen vetë pranë AKM pas publikimit të PKMM-së së vitit aktual, duke paraqitur propozimet e tyre.

Mbi shpeshtësinë e analizimit të treguesve

Në PKMM-në e hartuar çdo vit nga AKM dhe të miratuar nga MTM, është përcaktuar se për treguesit mjedisorë të gjendjes frekuenca është e monitorimit është “çdo dy muaj”. Nga AKM-ja këto tregues janë analizuar 4 herë në vit, duke bërë me dije se “sipas Direktivës Kuadër të Ujit, frekuenca është 4 herë në vit”. Pra, pavarësisht se DKU e përcakton periodicitetin “stinor” (sikurse

cituar nga AKM), AKM-ja e propozon për miratim me frekuencë “çdo dy muaj”, e më tej nuk e zbaton me argumentimin se DKU e përcakton ndryshe.

Mbi monitorimin e zbatimit të PKMM-së dhe publikimin e rezultateve

Në çdo vit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka publikuar Raportin e Gjendjes në Mjedis, ku pasqyrohen rezultatet e monitorimit të kryer nga AKM-ja për vitin paraardhës. Gjithashtu, nga AKM janë vënë në dispozicion shkresat përcjellëse që u drejtohen institucioneve, për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të AKM-së, që synojnë përmirësimin e gjendjes mjedisore, bazuar në rezultatet e monitorimeve.

Përpos Raporteve të Gjendjes në Mjedis, nuk rezultoi që AKM-ja të ketë hartuar raporte vjetore mbi zbatimin e PKMM-ve për të njohur MTM-në me një krahasim plan-fakt, ku të evidentohen jo vetëm monitorimet e kryera (të cilat pasqyrohen në RGJM), por edhe devijimet dhe mosrealizimet nga PKMM-ja, sa i përket stacioneve të përcaktuara që nuk janë monitoruar, treguesve të caktuar që nuk janë monitorues, frekuenca të ndryshme nga sa përcaktuar, etj. Hartimi i një dokumenti të tillë, përpos faktit se do të mundësonte krahasimin plan – fakt me PKMM-në e miratuar, do të shërbente edhe për ministrinë përgjegjëse për mjedisin, për të paraqitur dhe dokumentuar nevojat e shtuara për AKM-në lidhur me fonde buxhetore dhe strukturën organizative sa i përket aktivitetit monitorues.

Në pikën 6.1.3 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 21, datë 25.10.2016, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcaktohet se në procesin vjetor të rinovimit të dakordësisë për planin, duhet të bëhet një krahasim midis planit dhe realizimit. Krahasimi midis planit dhe faktit nuk kufizohet vetëm në sferën financiare, por mund të përdoret për të monitoruar të gjitha llojet e të dhënave, si stafi, treguesit e performancës, etj. Pas një periudhe kohe të caktuar, mblidhen të dhënat aktuale të treguesit dhe krahasohen me planin. Në rastin e devijimeve të rëndësishme, mund të merren masa rregulluese për të parandaluar dështimin e plotë në arritjen e treguesit.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk rezultoi të ketë siguruar monitorimin e prezencës së substancave prioritare në lumin e Lanës.

Në Aneksin I “*Normat e cilësisë së mjedisit të trupave ujore për substanca të caktuara*”, Pjesa A “*Normat e cilësisë së mjedisit (EQN)*”, të VKM-së nr. 246, datë 30.04.2014 “*Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore*”, përcaktohen substancat prioritare (listë që përfundon me numër rendor 33, por me 42 substanca të renditura), të cilat kanë tendencë të akumulohen në Sediment dhe/ ose në biotë, që i referohet të gjithë organizmave të gjalla në një zonë, flora dhe fauna si një njësi, sipas përcaktimit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit⁵. Për këto substanca, AKM duhet të kryejë analizat e tendencave afatgjatë dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që përqendrimet e tyre të mos rriten shumë. AKM monitoron sedimentin dhe/ ose biotën në mënyrë që të japë të dhëna të mjaftueshme për një analizë të besueshme të tendencës afatgjatë. Sipas përcaktimit në pikën 10 të këtij akti, AKM siguron që monitorimi të kryhet të paktën çdo tre vjet, n.q.s. në bazë të gjykimit dhe njohurive teknike të saj nuk justifikohet një shpeshtësi tjetër monitorimi. Lista e substancave prioritare në mjediset ujore është miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 267, datë 07.05.2014, ku nga 42 substanca prioritare të listuara, 20 prej tyre janë identifikuar si substanca të rrezikshme prioritare. Ndotja kimike e ujërave sipërfaqësore përbën një kërcënim për mjedisin ujor, me efekte të tilla si toksiciteti akut dhe kronik në organizmat ujorë, akumulimi i ndotësve në ekosistem dhe humbja e habitateve dhe biodiversitetit, dhe gjithashtu përbën një kërcënim për shëndetin e njeriut⁶. Nga auditimi u konstatua se AKM-ja nuk

⁵ <https://www.eea.europa.eu/help/glossary/eea-glossary/biota>

⁶ Pika 1, Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2013/39/EU, datë 12.08.2013 “*Mbi substancat prioritare në fushën e politikave të ujit*”

ka kryer/ siguruar monitorimin e këtyre substancave, me përjashtim të monitorimit të prezencës së metaleve të rënda në vitet 2022-2023.

Fondet e alokuara për AKM-në për monitorimin e plotë të ujërave sipërfaqësorë janë të pamjaftueshme.

★ Fact box nr. 1

Në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024, ndër të tjera është cituar se “për t’u harmonizuar më tej me *acquis* të BE-së për ujin, **Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm fondet dhe të përmirësojë kapacitetin zbatues të agjencive kryesore kombëtare të lidhura me ujin, të miratojë një plan zhvillimi kapacitetesh dhe të krijojë një program kombëtar të monitorimit të ujit me koordinim dhe burime të mjaftueshme**”⁷.

Nga ana e AKM-së bëhet me dije se një nga problematikat që ka sjellë mosrealizimin e plotë të PKMM-së lidhet ngushtësisht me fondet në dispozicion. Sikurse bëhet me dije nga AKM, pavarësisht se kërkesat kanë qenë gjithmonë në rritje nga drejtoritë teknike për realizimin e treguesve të programit të mjedisit, buxheti i alokuar përgjithësisht nuk ka pësuar rritje që nga viti 2021. Sa i përket llogarisë 602 “*Mallra dhe shërbime*”, llogari e cila është në total për të gjithë shpenzimet e AKM-së, pasi nuk ka zë të veçantë për ujërat në PBA, rezultoi, si më poshtë:

Viti	Plan (në lekë)	Fakt (në lekë)
2020	24,400,000	16,583,146
2021	47,710,284	28,680,403
2022	42,936,367	40,409,186
2023	48,200,000	42,751,487
2024	42,960,000	37,712,970

Burimi: AKM

Sa i përket buxhetit të akorduar për AKM-në, në llogarinë 604, lidhur me kontratat me palë të treta për monitorimin e treguesve të përcaktuar në PKMM, analizat e të cilave nuk kryhen nga AKM, rezultoi, si më poshtë:

Viti	Plan (në lekë)	Fakt (në lekë)
2020	7,000,000	4,349,706
2021	2,889,716	2,701,564
2022	7,039,633	3,556,753
2023	10,000,000	6,754,000
2024	5,000,000	4,044,660

Burimi: AKM

Përgjatë periudhës së auditimit 2020 – 2024, laboratorit i AKM-së ka qenë i akredituar për parametrat kryesore fiziko-kimike: *pH*, *përçueshmëria*, *alkaliniteti*, *mbetjet e ngurta pezull*, *nevoja kimike për oksigjen*, *nevoja biokimike për oksigjen*, *nitrite*, *nitrate*, *amonium*, *ortofosfor dhe fosfor total*. Fushat aktuale të akreditimit mbulojnë një pjesë të vogël të treguesve të cilët duhen monitoruar periodikisht, për të vlerësuar statusin ekologjik të trupave ujorë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk janë paraqitur observacione nga subjektet e audituara.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka realizuar monitorimin e plotë, sipas përcaktimit në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, si më poshtë:

- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit janë përcaktuar 4 stacione monitorimi përgjatë lumit të Lanës, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka monitoruar në vijimësi vetëm 2

⁷ “*Albania 2024 Report*” – European Commission, fq. 86

nga stacionet e monitorimit në këtë trup ujqor, duke mos kryer monitorim të 2 stacioneve të tjera të monitorimit, të përcaktuar nga projekti CEMSA dhe të përfshirë në rrjetin e stacioneve të monitorimit të mjedisit.

- Në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit janë përcaktuar 16 tregues mjedisorë të gjendjes, 4 tregues mjedisorë të ndikimit dhe 1 tregues mjedisor i trysnisë (në total 21 tregues) për t'u monitoruar, ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka monitoruar vetëm 10 prej treguesve mjedisorë të gjendjes..

- Në asnjë rast përgjatë periudhës së auditimit nuk rezultoi të jetë siguruar monitorimi i elementëve biologjikë të cilësisë, pavarësisht përfshirjes së tyre në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, duke pamundësuar vlerësimin e statusit ekologjik të lumit të Lanës.

- Frekuenca në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për monitorimin e treguesve mjedisorë të gjendjes është përcaktuar "çdo dy muaj", ndërsa Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka kryer këtë monitorim në frekuencë stinore, pra çdo 3 muaj, duke analizuar treguesit 4 herë në vit, e jo 6 herë në vit sipas frekuencës së përcaktuar.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk rezultoi të ketë publikuar shpallje/ thirrje në fillim të viteve përkatës, me qëllim që subjektet e interesuara publike/ akademike, etj., të paraqesin interesin e tyre për të dhënë kontribut lidhur me analizimin e treguesve që nuk kryhen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Mungesa e monitorimit të të gjithë stacioneve të monitorimit pamundëson vlerësimin e ndikimit dhe niveleve të ndotjes në pjesë të caktuara me ndikime/ presione të ndryshme, ndërkohë që mungesa e analizimit të të gjithë treguesve pamundëson vlerësimin e plotë të statusit ekologjik të trupit ujqor, duke mos mundësuar të dhëna mbi prezencën e substancave të rrezikshme, aspektit mikrobiologjik, pesticideve, etj.

2. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka hartuar raporte vjetore mbi zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, në këtë mënyrë duke mos kryer krahasimin plan-fakt, për të evidentuar dhe paraqitur pranë ministrit përgjegjës për mjedisin, jo vetëm aktivitetin monitorues të kryer (i cili pasqyrohet në Raportin e Gjendjes në Mjedis), por edhe atë të pakryer, sa i përket stacioneve të monitorimit, treguesve të përcaktuar për analizim dhe frekuencës përkatëse, në mospërputhje me pikën 6.1.3 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 21, datë 25.10.2016, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Mungesa e hartimit të krahasimit plan-fakt, pamundëson analizimin e shkaqeve që sjellin mosrealizimet e objektivave, në këtë mënyrë duke riskuar në mënyrë të përvitshme përcaktimin e objektivave jo në përputhje me kapacitetet logjistike e financiare të AKM-së, sa i përket monitorimit të cilësisë së ujërave, dhe rrjedhimisht duke sjellë mosrealizimin e tyre.

3. Gjetje nga auditimi: Sa i përket substancave prioritare të përcaktuara në Direktivën 2013/39/EU, VKM-në nr. 246, datë 30.04.2014 dhe VKM-në nr. 267, datë 07.05.2014, ku përfshihen substanca të ndryshme kimike, metale të rënda, pesticide (si Chlorpirofos, etj.), nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është siguruar kryerja e monitorimit vetëm sa i takon 5 metaleve të rënda (As, Cu, Hg, Cd, Pb) (nëpërmjet kontratës së lidhur me Universitetin Bujqësor të Tiranës për vitet 2022-2023), ndërkohë që Agjencia Kombëtare e Mjedisit vetë nuk i kryen këto analiza dhe nuk ka siguruar kryerjen e monitorimit të pjesës tjetër të 42 substancave prioritare përgjatë viteve periudhë auditimi.

4. Gjetje nga auditimi: Pavarësisht miratimit të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, për zbatimin e të cilave ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit, fondet e alokuara kanë qenë vazhdimisht të pamjaftueshme për realizimin e plotë të monitorimit. Kjo ka sjellë që Agjencia Kombëtare e Mjedisit të prioritetizojë stacionet që do të monitorojë, pavarësisht miratimit të tyre në

Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, si dhe kufizim në lidhjen e kontratave me palë të treta për analiza/ monitorime që nuk kryhen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

5. Gjetje nga auditimi: Përgjatë periudhës së auditimit 2020 – 2024, laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka qenë i akredituar për parametrat kryesore fiziko-kimike: *pH*, *përçueshmëria*, *alkaliniteti*, *mbetjet e ngurta pezull*, *nevoja kimike për oksigjen*, *nevoja biokimike për oksigjen*, *nitrite*, *nitrate*, *amonium*, *ortofosfor* dhe *fosfor total*. Pavarësisht përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së, i cili kërkon standarde të plota për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësorë, laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbetet i akredituar vetëm për disa tregues fiziko-kimikë. Mungesa e analizave mikrobiologjike, e prezencës së metaleve të rënda, pesticideve dhe substancave të tjera kufizon vlerësimin e plotë të statusit ekologjik të ujërave, ndaj përfshirja e tyre në procesin monitorues është e domosdoshme.

Konkluzion 1: Sipas përcaktimit në nenin 60, pika 1, gërma a, të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti përgjegjës, ndër të tjera, për hartimin e PKMM-së, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për mjedisin çdo vit. Nisur nga konstatimet e mësipërme, sa i përket aktivitetit monitorues në mjedis të AKM-së, grupi i auditimit vlerëson se, edhe pse ky program hartohet dhe dërgohet për miratim nga vetë AKM, është po AKM që *a priori* e konsideron të pamundur zbatimin e tij, për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore dhe të stafit në strukturën e monitorimit pranë AKM. Pavarësisht se për një pjesë të treguesve të përcaktuar në PKMM AKM-ja nuk është e akredituar dhe nuk kryen analizim, nga auditimi u konstatua se AKM nuk ka publikuar thirrje për të ftuar subjektet e interesuar për realizimin e analizimeve përkatëse, në zbatim të PKMM-ve, por ka qenë në pritje të shprehjes së interesit të vetë subjekteve dhe paraqitjes së propozimeve. Gjithashtu, sa i përket frekuencës, AKM-ja propozon frekuencën “*çdo dy muaj*” ose 6 herë në vit për analizimin e 8 nga 10 tregues, frekuencë të cilën nuk e zbaton me pretendimin se “*sipas DKU-së frekuenca është stinore*”, pra çdo 3 muaj ose 4 herë në vit. AKM-ja ka vijuar me hartimin e programeve të brendshme vjetore të monitorimit, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, të cilat prioritetizojnë stacionet e monitorimit, në ndryshim nga Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, i miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin. Në përfundim të çdo viti, AKM pasqyron rezultatet e monitorimit në Raportin e Gjendjes në Mjedis, por nuk dokumenton dhe bën me dije ministrin përgjegjës për mjedisin mbi aktivitetin e pakryer (monitorim të stacioneve, treguesve dhe sipas frekuencës së përcaktuar).

Konkluzion 2: Pavarësisht miratimit të VKM-së nr. 246, datë 30.04.2014 dhe nr. 267, datë 07.05.2014, duke përafruar legjislacionin kombëtar me acquis të BE-së, përkatësisht Direktivën 2013/39/EU, sa i përket monitorimit të substancave prioritare në trupa ujorë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk rezultoi të ketë kryer/ siguruar kryerjen e monitorimit të këtyre substancave në lumin e Lanës, me përjashtim të 5 metaleve të rënda për vitet 2022-2023.

Konkluzion 3: Fondet e pamjaftueshme të alokuara dhe mungesa e investimeve kanë kufizuar përmbushjen e detyrimeve monitoruese të mjedisit për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, duke pamundësuar monitorimin e të gjithë stacioneve të monitorimit, treguesve të përcaktuar në PKMM, si dhe substancave prioritare.

1.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për kryerjen e monitorimeve në të gjitha stacionet e përcaktuara në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, duke siguruar analizimin e të gjithë treguesve të përcaktuar.

Pas miratimit të PKMM-së për vitin pasardhës dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të hartojë dhe publikojë thirrje/ shpallje për shfaqjen e interesit nga institucione shtetërore/ akademike, etj., sipas praktikës institucionale, për realizimin e monitorimit të treguesve të cilët janë pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, por nuk analizohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Pas miratimit të PKMM-së për vitin pasardhës dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi:

Në përfundim të çdo viti, Agjencia Kombëtare e Mjedisit të hartojë një raport vjetor (krahasim plan-fakt) mbi zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, drejtuar ministrit përgjegjës për mjedisin, ku të evidentohen në çdo rast jo vetëm aktiviteti monitorues i kryer, por edhe ai i pakryer në raport me sa përcaktuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Brenda 3-mujorit të parë të 2026 dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masat për kryerjen/ sigurimin e kryerjes së monitorimit të substancave prioritare, në mënyrë që të mundësohen të dhëna mbi praninë ose mospraninë e tyre në lumin e Lanës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të hartojë një relacion mbi buxhetin total të nevojshëm për zbatimin e Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe të kërkojë alokimin e fondeve të duhura nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Brenda vitit 2025

5.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në kuadër të planifikimeve buxhetore për vitin pasardhës, të kërkojë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit parashikimin e rritjes së gamës së analizave dhe standardeve laboratorike, me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore për monitorim të plotë dhe cilësor të trupave ujorë sipërfaqësorë.

Për vitin 2026 e në vijimësi

4.1.2 Si ka qenë ecuria ndër vite e cilësisë së trupit ujor “Lumi Lana”?

Lumi Lana ka treguar vazhdimisht një nivel të konsiderueshëm ndotje në stacionet e monitoruara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Monitorimi i parametrave fiziko-kimikë, ekologjikë dhe hidrologjikë për trupat ujorë sipërfaqësorë është instrumenti i vetëm për të përcaktuar statusin e tyre, si dhe për të vlerësuar arritjen e objektivave mjedisore të vendosur. Analiza e të dhënave periodike të monitorimit, ndihmon gjithashtu në përcaktimin sasior të ndryshimeve mjedisore, duke siguruar informacion për gjendjen e sistemeve ujore, si dhe duke nxitur përmirësimin e gjendjes aktuale të tyre. Ligji nr. 111/2012, në nenin 28, kërkon vendosjen e normave të cilësisë së mjedisit për të gjitha ujërat, si sipërfaqësor dhe nëntokësor, në këtë kuadër janë miratuar dy akte nënligjore specifike kombëtare që përcaktojnë normat e cilësisë për ujërat sipërfaqësor, VKM nr. 246, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore” dhe VKM nr. 267, datë 7.5.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”. Sipas Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), Shtetet Anëtare mund të zbatojnë parimet për vendosjen e standardeve të cilësisë të përcaktuara në Shtojcën IX. Në këtë kuptim, DKU-ja lejon fleksibilitet për kontekstin lokal (pasi ujërat ndryshojnë ndjeshëm nga njëri vend në tjetrin për shkak të klimës, përdorimit të tokës, industrisë, bujqësisë, etj.).

Grupi i auditimit ka administruar të dhëna nga AKM mbi cilësinë e parametrave në stacionin L1 – Lanabregas dhe L2 – ish-Dogana, për vitet 2010 – 2023, sa i përket treguesve si oksigjeni i tretur, NBO5, NH4, NO3, PO4, P-total, NO2 dhe pH. Nga AKM është vënë në dispozicion tabela “Vlerat

limite të parametrave kimike në lumenj”, përcaktuar edhe Tabelën 3-1 të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, si më poshtë:

Tabela nr. 3: Vlerat limite të parametrave kimike në lumenj sipas DKU


	Njësia	Vlerat limite të parametrave kimike				
		Gjendje e Lartë Kl. I	Gjendje e Mirë Kl. II	Gjendje e Moderuar Kl. III	Gjendje e Varfër K. IV	Gjendje e Keqe Kl. V
Oksigjen i tretur	mgO/l	>7	>6	>5	>4	<3
NBO ₅	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)			>6.5	>6		
pH (alkalin)			<8.5	<9		
NH ₄	mgN/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO ₂	mgN/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO ₃	mgN/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO ₄	mgP/l	<0.05	<0.10	<0.2	0.5	>0.5
P-total	mgP/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit


Paraqitja grafike e të dhënave ndër vite në stacionet e monitorimit të lumit Lana

Disa prej treguesve më përfaqësues mbi ndotjen në lumin e Lanës paraqiten, si më poshtë⁸:

Grafiku nr. 1. Të dhënat 2010 – 2023 mbi Nevojën Biokimike për Oksigjen




Grafiku nr. 2. Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e Oksigjenit të Tretur




⁸ Në të gjithë grafikët, janë pasqyruar me ngjyra të ndryshme fashat sipas klasifikimit, ku me ngjyrë të kuqe është pasqyruar fasha “Klasa V – gjendje e keqe”.


Grafiku nr. 3: Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e amoniakut



Grafiku nr. 4: Të dhënat 2014 – 2023 mbi nivelin e ortofosfateve (PO4)



Grafiku nr. 5: Të dhënat 2010 – 2023 mbi nivelin e fosforit total (P_{total})



Burimi: AKM/ Përpunuar nga grupi i auditimit

Mbi stacionin L1 – Lanabregas

Sa i përket treguesit “**NBO5 – Nevoja biokimike për oksigjen**”, ky tregues ka ardhur duke u përkeqësuar, ku është klasifikuar në Kl. II-IV 2-4 përgjatë viteve të ndryshme, ndërkohë që në vitin 2023 është klasifikuar në “**Kl. V – Gjendje e keqe**”.

Sa i përket treguesit “**NH4 – niveli i amoniakut**”, ky tregues ka ardhur duke u përkeqësuar, ku është klasifikuar në Kl. II-IV përgjatë viteve, ndërkohë që është klasifikuar në “**Kl. IV – Gjendje e varfër**” për vitet 2020 – 2022 dhe në “**Kl. V – Gjendje e keqe**” në vitin 2023.

Sa i përket treguesit “**PO4 – niveli i fosfatit**”, ky tregues ka ardhur duke u përkeqësuar, ku është klasifikuar në Kl. I-III përgjatë viteve, ndërkohë që është klasifikuar në “**Kl. IV – Gjendje e varfër**” për vitin 2023.

Mbi stacionin L2 – ish-Dogana

Ndotja e lumit Lana në këtë stacion paraqitet vazhdimisht në nivele mjaft të larta, ku sa i përket treguesve mbi nevojën biokimike për oksigjen, vlerat e amoniakut dhe fosforit (NBO5, NH4, PO4 dhe P-total), ky stacion është klasifikuar në “**Kl. V – Gjendje e keqe**” që nga të dhënat më të hershme të vëna në dispozicion, që datojnë nga viti 2010, e në vijim deri në të dhënat e fundit në vitin 2023.

Nga të dhënat dhe paraqitja grafike e mësipërme, është lehtësisht e dallueshme që stacioni i monitorimit L2 – ish Dogana, i cili është i pozicionuar pasi lumi Lana kalon pjesën e urbanizuar të qytetit të Tiranës paraqet një nivel ndotje të lartë, edhe në krahasim me stacionin L1 – Lanabregas, i cili është në pjesën lindore të qytetit, në fillim të pjesës së urbanizuar.

Këto të dhëna janë pasqyruar çdo vit në Raportet e Gjendjes në Mjedis për secilin prej viteve, ku nga AKM në mënyrë të vazhdueshme është rekomanduar marrja e masave nga organet e pushtetit vendor dhe qendror për të minimizuar shkaktarët e ndotësve, pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe në zona bregdetare, si dhe realizimin e investimeve në trajtimin e shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në Tiranë dhe Fier, pasi gjendja dhe cilësia e tyre vijon të jetë në të njëjtën situatë.

AKM-ja i është drejtuar Bashkisë Tiranë, duke informuar ndër të tjera mbi rezultatet e monitorimit në stacionet e lumit Lana për vitin 2024, ku citohet “**Stacioni i monitorimit “Lanabregas” dhe “ish-Dogana, Kashar” vlerësohet Klasa V – Gjendje shumë e keqe. Shkaktarët kryesorë të ndotjes janë shkarkimet urbane dhe industriale. Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ujërave në këto stacione monitorimi**”⁹.

Vlerat e prezencës së metaleve të rënda tejkalojnë normat limit të lejuara në lumin e Lanës.

Për vitet 2022-2023, nëpërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka siguruar monitorimin e lumit të Lanës mbi metalet e rënda, nga ku ka rezultuar, si më poshtë:

Tabela nr. 4: Rezultatet e monitorimit të prezencës së metaleve të rënda në lumin Lana 2022 - 2023.

Për stacionin L1 – Lanabregas					
Parametri	2022			2023	
	Përmbajtja	Klasifikimi		Përmbajtja	Klasifikimi
As	3.0 (µg/l)	Gjendje mirë sipas VKM /DKU		2.33 (µg/l)	Gjendje mirë sipas VKM /DKU
Cu	0.86 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e lartë sipas DKU		5.05 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e lartë sipas DKU
Hg	n.d. ¹⁰			-	-
Cd	n.d			0.18(µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e lartë sipas DKU
Pb	12.04 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e keqe sipas DKU.		5.35 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e keqe sipas DKU.
Për stacionin L2 – ish-Dogana, Kashar					
Parametri	2022			2023	
	Përmbajtja	Klasifikimi		Përmbajtja	Klasifikimi

⁹ Nëpërmjet shkresës nr. 2477 prot., datë 05.03.2025

¹⁰ (*) nuk detektohet.

As	n.d		5.67 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM /DKU
Cu	0.84 (µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e lartë sipas DKU	2.11(µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e lartë sipas DKU
Hg	n.d		-	-
Cd	n.d		0.21(µg/l)	Gjendje mirë sipas VKM /DKU
Pb	19.91(µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e keqe sipas DKU.	10.8(µg/l)	Gjendje e mirë sipas VKM Gjendje e keqe sipas DKU.

Burimi: AKM

Në Raportin e Gjendjes në Mjedis 2023, citohet se “bazuar në rezultatet e përmbajtjes së metaleve të rënda, ujërat e Lanës dhe të lumit Ishëm janë të kontaminuara referuar përmbajtjes së As (Arsenikut). Vlerat mesatare janë më të larta se nivelet e rekomanduara nga VKM dhe DKU (>10µg/l), duke i konsideruar të Klasës A2 – cilësi e mirë. Gjithashtu, Cd (Kadmiumi) është më i lartë se vlera e parashikuar nga VKM (5µg/l), por edhe shumë më e lartë se limiti (1µg/l). Përmbajtja e Cd dhe Pb (Plumbi) tejkalon vlerat e përcaktuara nga DKU për trupën ujore të Ishmit (Lumi i Lanës, i Tiranës dhe i Ishmit) për shkak të ndotjes urbane që shkaktohet nëpërmjet ujërave të përdorura në aglomeratin e Tiranës”.


Ecuria e cilësisë së ujit të lumit të Lanës nuk përputhet me objektivat strategjike të përcaktuara.

Në pikën 2.5 dhe 3.2 të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018 – 2027, miratuar nëpërmjet VKM-së nr. 73, datë 07.02.2018, është përcaktuar objektivi strategjik lidhur me cilësinë e ujit, ku synohet sigurimi i statusit “cilësi e mirë” për ujin e të gjitha burimeve ujore deri në vitin 2027, duke aplikuar aktet ligjore dhe nënligjore të cilat transpozojnë direktivat e BE-së. Pavarësisht se objektivi është përcaktuar për vitin 2027, ka kaluar më shumë se 80% e jetëgjatësisë/ shtrirjes në kohë të strategjisë, jo vetëm nuk shihet asnjë përmirësim në klasifikimin e secilit prej stacioneve të monitorimit, por në komponentë të caktuar dhe në vlerësimin e përgjithshëm ka pasur përkeqësim në klasifikimin e stacionit të monitorimit L1 – Lanabregas, ndërkohë që gjendja në L2 – ish-Dogana vijon të mbetet e rënduar, ku për vitin 2024 janë klasifikuar të dy stacionet në gjendje “Shumë të keqe”.

Mbi ndjekjen në terren të procesit të marrjes së mostrave në stacionet e monitorimit

Grupi i auditimit mori pjesë në një proces marrje mostrash në datën 04.02.2025, të kryer nga specialistët e laboratorit të AKM-së, në kuadër të programit vjetor të monitorimit nr. 221 prot., datë 10.01.2025. Në këtë proces, u morën mostra në dy stacionet e monitorimit, respektivisht në Stacionin e Monitorimit të Lanës në Lanabregas (me koordinata specifike të marrjes së mostrave N 41.333750 E 19.876528) dhe Stacioni i Monitorimit të Lanës në Kashar (me koordinata specifike të marrjes së mostrave N 41.3386999 E 19.7764331), pasqyruar në hartën e mëposhtme.

Harta nr. 1: Fragment harte me stacionet e monitorimit ku u krye marrja e mostrave



Burimi: Google Earth, përpunuar nga grupi i auditimit

Fillimisht, u morën mostrat e testimit në stacionin e monitorimit në Lanabregas, pasqyruar në pamjet fotografike, si më poshtë:



Foto nr. 1: Foto e Lanës në Stacionin e monitorimit Lanabregas




Foto nr. 2: Marrja e mostrave në Stacionin e monitorimit Lanabregas

Më tej përfaqësuesit e AKM vijuan me marrjen e mostrave për kryerjen e analizave në stacionin e monitorimit të lumit Lana në Kashar (ish-Dogana), pasqyruar në pamjet fotografike, si më poshtë:



Foto nr. 3: Foto nga lumi i Lanës në Stacionin e monitorimit në Kashar



Foto nr. 4: Marrja e mostrave në Stacionin e monitorimit Kashar

Treguesit që u monitoruan ishin temperatura e ujit, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, TOC, nitritet, nitratet, amoniaku, P-total, PO4, lëndë pezull. Në kohë reale u matën në terren (i) temperatura e ujit, (ii) pH dhe (iii) oksigjeni i pranishëm në mg/l, ndërkohë që mostrat e marra u transportuan në kushtet e përshtatshme pranë laboratorit të AKM për kryerjen e analizave të treguesve të tjerë fiziko-kimikë.

Klasifikimi i cilësisë së ujërave është kryer sipas Direktivës Kuadër të Ujit, ku ujërat e lumenjve klasifikohen në pesë klasa, ku gjendja e moderuar ose klasa e tretë, konsiderohet si klasa me nivelin minimal të pranueshëm të cilësisë së ujërave të lumenjve.

Në këtë monitorim, ka rezultuar se:

Tabela nr. 5: Rezultatet e monitorimit të datës 04.02.2025

Nr.	Parametri	L1 (mg/ml)	Klasifikimi	Norma	L2 (mg/ml)	Klasifikimi L2	Norma
1.	NBO ₅	9	Gjendje e varfër – Klasa IV	< 18	82	Gjendje e keqe – Klasa V	<18
2.	Përmbajtja e amoniakut	0.22	Gjendje e mirë – Klasa II	< 0.3	19.59	Gjendje e keqe – Klasa V	>1.5
3.	Përmbajtja e nitriteve	0.027	Gjendje e mirë – Klasa II	< 0.06	0.075	Gjendje e moderuar – Klasa III	>0.12
4.	Përmbajtja e nitrateve	0.19	Gjendje e lartë – Klasa I	< 0.8	1.95	Gjendje e mirë – Klasa II	<2
5.	Përmbajtja e orto - fosfateve	0.04	Gjendje e lartë – Klasa I	< 0.05	1.24	Gjendje e keqe – Klasa V	>0.5
6.	Përmbajtja e fosforit total	0.045	Gjendje e lartë – Klasa I	< 0.1	1.5	Gjendje e keqe – Klasa V	>1

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përpunuar nga grupi i auditimit

Stacioni i monitorimit L1, në këtë monitorim të kryer, është klasifikuar në Klasën II – Gjendje e mirë. Ky stacion është në pjesën lindore të qytetit të Tiranës, në Lanabregas, dhe është në fillimet e rrjedhës së lumit të Lanës. Stacioni i monitorimit L2, në këtë monitorim të kryer, është klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe. Nga AKM citohet se “përmbajtja e lartë e amoniakut, nitrateve dhe fosfateve është dëshmi e shkarkimeve urbane dhe aktiviteteve përreth. Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vlerësojmë se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajtuara sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë”.


Mbi Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm

Nëpërmjet VKM-së nr. 624, datë 08.11.2023 është miratuar Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024 – 2029. Ky dokument është një hap pozitiv në implementimin e kuadrit ligjor të përafuar me acquis të BE-së, lidhur me menaxhimin e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë dokument është paraqitur gjendja e trupave ujorë që bëjnë pjesë në këtë basen ujor, ndër të tjerë edhe trupi ujor “Lumi Lana”. Përpos evidentimit të statusit ekologjik të tij, PMBU Ishëm ka përcaktuar edhe masat që institucionet përgjegjëse të qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të marrin për përmirësimin e cilësisë në këtë trup ujor.

Në pikën 10.5.2 të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm janë përcaktuar trupat ujorë më “në risk”, ku për lumin e Lanës listohet, si më poshtë:

- Trupi ujor 351487 – rrjedhat e sipërme të lumit të Lanës në skajet lindore të qytetit (i referohet pjesës së lumit të Lanës nga burimi e deri në rrethrotullimin e Shkozës) – “ndonëse ende në formë natyrore, trupi ujor që kalon përmes qytetit është tepër i ndikuar nga ujërat e ndotura të patrajtuara, duke sjellë kështu nivele mjaft të larta të nevojës biokimike për oksigjen (BOD₅) dhe depozitime të mbetjeve të ngurta”;
- Trupi ujor 351485 – rrjedha e poshtme e 351487 (i referohet pjesës së sistemuar të lumit të Lanës nga rrethrotullimi i Shkozës deri te “Pallati me Shigjeta”) – “trupi ujor është tepër i kontaminuar nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara. Edhe kjo pjesë është tepër e modifikuar për shkak të kanalizimeve, ndaj objektivi ekologjik për këtë trup do të ishte “potenciali i mirë ekologjik”;
- Trupi ujor 351483 dhe 351481 (i referohet pjesës vijuese nga “Pallati me Shigjeta” deri në pikën e bashkimit me Lumin e Tiranës në Laknas) – “për sa i përket trupave ujorë të rrjedhës së sipërme të Lanës, edhe këto trupa ujorë janë tepër të kontaminuar nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara, siç tregohet nga nivelet jashtëzakonisht të larta të BOD₅)”.

Harta nr. 2: Përcaktimi i statusit përfundimtar të trupave ujorë sipërfaqësorë



Burimi: Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024 – 2029

Mbi ndikimin në ujë

Një nga risqet e tjera që paraqet ndotja e lartë e lumit të Lanës, është edhe në ujë, pasi “*në basenin e Ishmit, në përgjithësi, ujërat sipërfaqësore konsiderohen si burim kryesor për ujë, me lumenjtë Ishëm dhe Zezë si burime kryesore*”¹¹. Sipas MBZHR-së, sipërfaqja e tokës bujqësore në basenin e lumit Ishëm është rreth 26,000 ha dhe sipërfaqja ku fermerët kanë akses në ujë është rreth 8,000 ha.

Mbi ndikimin në mjedis


Përpos ndikimeve mjedisore, estetike, etj., në qytetin e Tiranës, ku edhe kalon në pjesën më të madhe të shtrirjes së tij, Lumi Lana bashkohet në Laknas me lumin e Tiranës dhe më tej me Lumin e Ishmit, për t’u derdhur më tej në deltën e Ishmit në detin Adriatik. Niveli i lartë i ndotjes në lumenjtë që përbëjnë basenin e Ishmit, të cilët bashkohen dhe derdhen të patrajtuar, kanë shkaktuar një situatë të rënduar mjedisore dhe ekologjike në deltën e Ishmit, në afërsi të Kepit të Rodonit.

Harta nr. 3: Delta e Ishmit



Burimi: Google Earth Pro, datë imazhi 16.06.2024

Harta nr. 4: Pozicionimi në hartë i deltës së Ishmit



Burimi: Google Earth Pro

¹¹ “Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm”, fq. 4-22.

Gjendja pranë deltës së Ishmit, shkaktuar nga prurjet e lumit, përfshirë këtu edhe mbetje të ngurta urbane, etj., të akumuluar nga lumenjtë përbërës, ndër të tjera dhe lumi i Lanës (i cili konsiderohet ndër më të ndoturit pjesë e këtij baseni ujor), paraqitet, si më poshtë:

Foto nr. 5: Pamje nga delta e Ishmit



Foto nr. 6: Pamje nga delta e Ishmit



Mbi monitorimin e zbatimit të programit të masave të përcaktuara në PMBU Ishëm

Pas miratimit të PMBU Ishëm, AMBU-ja i dërgon Bashkisë Tiranë për njohje dhe zbatim PMBU Ishëm, duke pasqyruar masat kryesore sa i përket lumit të Lanës për të cilat Bashkia Tiranë është përgjegjëse (ose bashkëpërgjegjëse), si (i) Përfundimi i ndërtimit dhe vënia në punë e ITUN Kashar, (ii) zëvendësimi i argjinaturës mbrojtëse të dëmtuar me një argjinaturë të re, si dhe (iii) lejimi i kalimit të faunës ujore në trupin e modifikuar me strukturë të panatyrshme të shtratit të tij duke modifikuar pragjet aktuale, sa i përket pjesës së lumit të Lanës të konsideruar TUTM (trup ujor tepër të modifikuar)¹². Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje, duke caktuar një person kontakti nga Bashkia Tiranë D.B., me qëllim ndjekjen në vazhdimësi dhe zgjidhjen e problematikave aktuale dhe të ardhshme që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore¹³.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezultoi të ketë korrespondencë vijuese ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe AMBU-së, lidhur me ecurinë në raport me masat e përcaktuara për përmirësimin e situatës në lumin e Lanës.

Gjithashtu, AMBU-ja ka dërguar Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, duke listuar masat takuese për institucionet e përfshira në përmirësimin e situatës në lumin Lana, si më poshtë:

1. Shkresa nr. 1063 prot., datë 17.07.2024, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ku për trupin ujor lumi Lana përcaktohet masa “*Rehabilitim i trupave ujorë, kontroll i sedimenteve duke aplikuar qasjen ZBN (Zgjedhjet e Bazuar në Natyrë) për të arritur objektivat mjedisore*”;
2. Shkresa nr. 1064 prot., datë 17.07.2024, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, ku për trupin ujor lumi Lana përcaktohet masa “*Përfundimi i ndërtimit dhe vënia në punë e ITUN Kashar*”.

¹² Njëpërmjet shkresës nr. 1071 prot., datë 17.07.2024

¹³ Njëpërmjet shkresës së Bashkisë Tiranë nr. 27863/1 prot., datë 26.08.2024, administruar në AMBU me nr. 1071/1 prot., datë 27.08.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e administruara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga Raportet e Gjendjes në Mjedis të publikuara, rezultoi se vazhdimisht që nga viti 2010 e deri në vitin 2024, gjendja mjedisore e lumit Lana ka pasqyruar një nivel të konsiderueshëm ndotje. Situata ka mbetur thuajse e pandryshuar në stacionin e monitorimit L2 – ish-Dogana, i klasifikuar vazhdimisht në Klasën V – Gjendje e keqe. Ndërkohë situata është përkeqësuar në stacionin e monitorimit L1 – Lanabregas, pavarësisht se ky stacion është i caktuar në fillim të rrjedhës së lumit dhe paraprin zonën e urbanizuar të qytetit të Tiranës. Për monitorimin e vitit 2024, të dy stacionet rezultojnë të vlerësuar në Klasën V – Gjendje e keqe.

7. Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet VKM-së nr. 624, datë 08.11.2023 është miratuar Plan i menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, ku janë pasqyruar ndër të tjera statusi i trupave ujorë pjesë të këtij baseni, presionet e identifikuara, si dhe një plan masash për përmirësimin e situatës, duke përcaktuar edhe aktorët përkatës për zbatimin e secilës prej masave, si Bashkia Tiranë, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve. Pavarësisht sa më sipër, institucionet përgjegjëse, si Bashkia Tiranë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve nuk rezultoi të kenë marrë masat e nevojshme për hartimin e planeve të zbatimit lidhur me masat takuese të përcaktuara në Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, lidhur me lumin Lana, për të përmbushur angazhimin institucional për përmirësimin e situatës. Mungesa e marrjes së masave nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të masave, duke mos shfaqur angazhim në caktimin e pikave të kontaktit dhe hartimin e planeve të zbatimit, mund të riskojë arritjen e objektivave të synuar në afatet e përcaktuara.

Konkluzion 4: Pavarësisht angazhimeve të shtetit shqiptar në përafrimin e legjislacionit me acquis-in e BE-së, hartimin dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe publikimit të Raporteve të Gjendjes në Mjedis nga AKM-ja, ku vazhdimisht që nga viti 2010 (për sa është vënë në dispozicion grupit të auditimit) e deri në vitin 2024, gjendja mjedisore e lumit Lana ka pasqyruar një nivel të konsiderueshëm ndotje. Në një moment kur situata ka mbetur thuajse e pandryshuar sa i përket situatës në stacionin e monitorimit L2 – ish-Dogana, stacion i klasifikuar në mënyrë të vazhdueshme në “Klasën V – Gjendje e keqe”, situata është përkeqësuar edhe në stacionin e monitorimit L1 – Lanabregas, pavarësisht se ky stacion është ende në fillim të rrjedhës së lumit, pra pa kaluar nëpër zonën e urbanizuar të qytetit të Tiranës.

7.1. Rekomandimi:

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në cilësinë e institucionit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, të marrë masat për garantimin e angazhimit institucional të institucioneve të identifikuara si përgjegjëse për zbatimin e masave të përcaktuara, duke:

- Kërkuar caktimin e pikave të kontaktit nga secili prej institucioneve;
- Kërkuar hartimin dhe miratimin e planeve të veprimit nga institucionet e identifikuara, në kuadër të zbatimit të planit të masave;
- Organizuar në mënyrë të tillë që të ketë takime periodike për hapat konkrete të marra, problematikat e hasura, me qëllim që zbatimi i masave të jetë i aplikueshëm;
- Krijuar një sistem efektiv periodik monitorimi lidhur me hapat e ndërmarrë nga secili prej institucioneve të identifikuara, me qëllim minimizimin e riskut të mosarritjes së objektivave mjedisorë të caktuar për lumin e Lanës.

Brenda vitit 2025 dhe në vijimësi

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, lidhur me Gjetjen nga auditimi nr. 7 dhe Rekomandimin 7.1, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka paraqitur observacionin, administruar në KLSH me nr. 113/12 prot., datë 25.07.2025, ku pretendohet, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “Në lidhje me rezultatet e pasqyruara në Projekt Raportin e Auditimit, shprehemi se jemi parimisht dakord me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet. Gjithsesi vlerësojmë të paraqesim disa sqarime lidhur me Rekomandimin 7.1. Konkretisht:

Pas miratimit të PMBU Ishëm, AMBU-ja ka vijuar me hapat e nevojshëm për të siguruar zbatimin efektiv të këtij plani. Ky proces përfshin një bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional, alokimin e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe monitorim sistematik të progresit të zbatimit të masave. Kjo është realizuar përmes dërgimit të shkresave zyrtare, ku janë detajuar masat pëkatëse që kërkojnë përfshirjen dhe angazhimin e tyre. Megjithatë, një nga sfidat kryesore të evidentuara në këtë proces është siguria financiare për zbatimin e masave. Ndër të tjera, kemi kërkuar edhe vendosjen e pikës së kontaktit nga të gjithë institucionet e përfshira (bashkëlidhur lista), por vetëm nga Bashkia Tiranë na ka ardhur një pikë kontakti. Nëpërmjet shkresave, AMBU-ja gjithashtu ka kërkuar nga institucionet përkatëse që të integrojnë masat në program-buxhetin afatmesëm dhe në dokumentet vjetore të planifikimit financiar... Gjithashtu, sqarojmë se nuk mund të hartohet një plan i dedikuar për lumin e Lanës apo për çdo trup tjetër të konsideruar me status të keq, pasi AMBU-ja në zbatim të PMBU Ishëm do të hartojë planin e veprimit të programit të masave për të gjithë basenin dhe trupat ujorë që ai përmban”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit ka trajtuar shkresat e AMBU-së (që lidhen me lumin Lana) në seksionin “Mbi monitorimin e zbatimit të programit të masave të përcaktuara në PMBU Ishëm”, ku janë cituar shkresat e AMBU-së drejtuar Bashkisë Tiranë, AKM, AKUK, si dhe përgjigja e ardhur nga Bashkia Tiranë. Grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë lidhur me hapat e ndërmarra për planifikimin e zbatimit të masave, por nga Bashkia Tiranë nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që tregon angazhim institucional për hedhjen e hapave për përmirësimin e situatës në lumin Lana, në kuadër të masave të përcaktuara në PMBU Ishëm, ndërkohë që institucionet e tjera (sikurse cituar edhe nga AMBU-ja në observacion, nuk kanë caktuar as pikë kontakti, përpos faktit që nuk kanë hartuar plan-veprime. Grupi i auditimit vlerëson se, për të bërë efektive masat e përcaktuara në PMBU Ishëm, është e nevojshme që të gjithë institucionet e përfshira të shfaqin angazhimin e tyre nëpërmjet caktimit të pikave të kontaktit dhe më tej hartimit të plan-veprimeve përkatëse për masat e përcaktuara, përfshirë masat për përmirësimin e gjendjes në lumin e Lanës. Në rekomandimin nr. 7.1, grupi i auditimit nuk ka kërkuar hartimin e një plani të dedikuar për lumin e Lanës, por krijimin e një sistemi efektiv monitorimi, për të garantuar se masat e përcaktuara të zbatohen nga institucionet përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e situatës në lumin Lana. Grupi i auditimit ka theksuar nevojën që çdo institucion i përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në masat e përcaktuara në PMBU Ishëm, të hartojë një plan veprimi për masat që i takojnë, për të minimizuar riskun e mosarritjes së objektivave të përcaktuara.

Në pikën 1.2 të PMBU Ishëm, përcaktohet gjithashtu se AMBU-ja ka përgjegjësinë të sigurohet se kërkesat e parashtruara nga legjislacioni kombëtar dhe DKU-ja e BE-së, sidomos objektivat mjedisorë dhe programi i masave të përcaktuara në PMBU, të jenë koordinuar përgjatë gjithë sektorëve dhe programeve brenda basenit ujor. Edhe në ligjin e ri për burimet ujore nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, të përafuar më tej me *acquis* të BE-së, në nenin 9, pika 2, gërma c, përcaktohet se AMBU-ja siguron bashkërendimin e dispozitave të ligjit, në lidhje me përmbushjen e objektivave mjedisorë dhe të programeve të masave me autoritetet e tjera. Për sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

4.2 A kanë marrë institucionet përgjegjëse masa efektive për eliminimin e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara në lumin Lana?

4.2.1 A janë marrë masa për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve me qëllim eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin Lana?

Bashkia Tiranë dhe Ujësjellës Kanalizime Tiranë nuk rezultoi të kenë kryer investime të përshtatshme për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve.

Sistemi i kanalizimeve në qytetin e Tiranës karakterizohet nga një përzierje e kanalizimeve të veçanta të ndërlidhura dhe kanalizimeve të kombinuara, duke çuar në kapërderdhje të pakontrolluara të ujërave të ndotura, të cilat gjithashtu çojnë në përmytje që ndikojnë në ekonominë e qytetit dhe mjedisin. Kjo situatë është përkeqësuar pasi zhvillimi i rrjeteve të ujërave të ndotura dhe kanalizimeve të ujërave të shiut nuk ka ecur në ritmin e urbanizimit më të shpejtë të Tiranës. Deri në këtë moment, ujërat e ndotura të mbledhura nga këto sisteme kanalizimesh derdhen direkt në lumenj, përfshirë këtu Lumin Lana Sipas informacioneve të vëna në dispozicion, gjatësitë e kanalizimeve për Tiranën janë rreth 650 km, me këtë dinamikë sipas viteve.

Tabela nr. 6: Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve për Tiranën 2019-2024

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Km linear	580	595	600	619	630	649

Burimi: UKT sh.a.

Sistemet më të reja të kanalizimeve janë zakonisht kanalizime të veçanta, shpesh të ndërtuara në pjesët e sipërme të sistemeve të kanalizimeve. Kanalizimet e vjetra ekzistuese janë përgjithësisht kanalizime të kombinuara. Në Tiranë ka disa kapërderdhje të kanalizimeve për largimin e ujit të tepërt të shiut gjatë reshjeve të dendura dhe lehtësimin e rrjeteve të kanalizimeve në rrjedhën e poshtme. Megjithatë, kjo nuk parandalon vërshimet e shpeshta të pakontrolluara të ujërave të ndotura të përziara (me ujërat e shiut) në rrugë dhe në shtëpi. 30% e popullsisë aktualisht përdor sistemet pa kanalizime (gropat septike) por edhe këto pa trajtim të llumit fekal për ato që kërkojnë zbrazje. Pjesa tjetër prej 70% përdor sistemet e kombinuara të kanalizimeve (përzierja e ujërave të shiut dhe ujërave të ndotura)¹⁴.

Relacioni i datës 01.12.2020 i hartuar nga ana e AMBU-së mbi verifikimin e pikave të shkarkimit të ujërave të ndotur, ka konfirmuar faktin se, duke qenë se Tirana nuk ka impiant trajtimi dhe në shumë raste nuk kemi një ndarje të ujërave të bardha nga ato të zeza, shkarkimet kryesore bëhen në Lumin e Lanës dhe lumin e Tiranës. Zonat periferike të qytetit ujërat e zeza i shkarkojnë ose në gropa septike ose në përrenj apo kanale në afërsi që kalojnë në afërsi të tyre në mënyrë individuale. Sa më sipër konfirmohet edhe referuar dokumentit me titull *Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024 – 2029*. Konkretisht, referuar këtij dokumenti citohet se sistemi ekzistues i mbledhjes së ujërave të ndotura është sistem kanalizimesh i kombinuar për kullimin e ujërave të ndotura urbane të përziara me ujërat nga reshjeve. Sistemi shkarkohet në lumin e Lanës dhe Tiranës. Sistemi ekzistues i kanalizimeve është planifikuar të përdoret në maksimum. Për zonën e re pa sistem publik kanalizimesh, është planifikuar një sistem kanalizimesh i ndarë. ITUN-u Tiranë është në ndërtim e sipër, por punimet ndërtimore janë pezulluar.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se sipas raportit final të përgatitur nga ana e E. në bashkëpunim me E. me objekt *Shërbime konsulence për hartimin, modelimin dhe vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të ujërave të ndotura dhe të shirave në Tiranën e Madhe, Shqipëri dhe projekti paraprak i ndërhyrjeve prioritare* Raporti i projektit paraprak të ndërhyrjeve prioritare është parashikuar të dorëzohet në dhjetor 2025.

¹⁴ - UKT sh.a., Raport fillestar 03.06.2024, Raport final të përgatitur nga ana e E. në bashkëpunim me E. me objekt *Shërbime konsulence për hartimin, modelimin dhe vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të ujërave të ndotura dhe të shirave në Tiranën e Madhe, Shqipëri dhe projekti paraprak i ndërhyrjeve prioritare*

Gjendja aktuale e rrjetit të tubacioneve kryesorë që shkarkojnë ujëra të ndotura direkt në lumin e Lanës, paraqitet në fotot e mëposhtme:

Foto nr. 7-12: Disa nga tubat e shkarkimit të kanalizimeve në lumin e Lanës në Tiranë




Mbi zhvillimin e infrastrukturës së rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në qytetin e Tiranës Raporti për Planin Tematik 2012, (hartuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, JICA), bazuar në të dhënat agregate të ish-Ndërmarrjes së Ujës-jellës-Kanalizimeve të Tiranës (sot UKT sh.a.), dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Ujës-jellës-Kanalizimeve (AKUK), evidenton se gjatësia e përgjithshme e linjave të kanalizimeve është 559 km, ku përfshihen: kolektorët, kanalizimet kryesore dhe degëzimet. Numri i popullsisë i vlerësuar është rreth 787,500 banorë në zonën urbane, që shërbehet nga rrjeti i kanalizimeve me 79,4% mbulim, deri në fund të vitit 2011.

Shumica e tubacioneve ekzistuese të kanalizimeve nuk kanë kapacitetin e mjaftueshëm për të transportuar ujërat e zeza dhe ujin e shiut, sepse tubacionet ekzistuese duhet të jenë projektuar fillimisht për të pritur 3 deri në 5 herë të ujërave të zeza të pik-ut të kohës së thatë. Zonat kritike u përcaktuan edhe në studimin e vitit 2002 i financuar nga K.I. Mungesa e kapacitetit të tubacioneve kryesore / degëzimeve të kanalizimeve është përkeqësuar nga marrja e kapakëve të

pusetave dhe hedhja e mbeturinave nëpër kanalizime në disa zona. Për sa i përket furnizimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit, UKT ka kryer punën për rindërtimin e tubacioneve ekzistues të kanalizimeve dhe zëvendësim të **kapakëve** të pusetave, përveç vendosjes së tubacioneve të reja të kanalizimeve në zonat e pambuluar.

Harta nr. 5: Skema e sistemit të kanalizimeve në qytetin e Tiranës



Burimi: Masterplan - Ndihma Teknike dhe Financiare për Tiranën e Madhe T. & S.

Në dokumentin e hartuar nga Bashkia e Tiranës, të titulluar Plan i Veprimit për zhvendosje projekti Shtrati i Lumit Lana - rihvillim urban (amendamenti 1), publikuar me datën 17 Janar 2024, cilësohet se: “Shtrati i lumit Lana – Zhvillim Urban” është i rrënjosur fort në kuadrin e planifikimit të përgatitur për qytetin. Projekti është pjesë e rehabilitimit dhe përmirësimit më të gjerë të brigjeve ujore urbane të Tiranës qendrore. Vendi i projektit dhe rrethinat e tij të afërta kanë vuajtur nga mungesa e komoditetit për banim, lidhje e dobët me pjesën tjetër të qytetit, degradimi i mjedisit dhe përmbytjet periodike si rezultat i zhvillimit të paplanifikuar dhe të rregulluar keq të banimit dhe mangësive në infrastrukturën publike që i shërben zonës.”

Po kështu, dokumenti “TR030, Plani i ri i përgjithshëm vendor dhe një vizion strategjik për Tiranën si një entitet metropolitan policentrik dhe intensiv”¹⁵, njeh gjendjen e ndotjes në Lumin e Lanës, ku shprehimisht theksohet se: “Lumi i Tiranës është sot shumë i ndotur, për shkak të shkarkimeve të mbetjeve lokale.

Mbi hartën e sistemit të kanalizimeve në qytetin e Tiranës

Që nga viti 1964 rrjeti i ujërave të ndotura urbane të qytetit të Tiranës është projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që ky sistem të derdhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në lumin e Lanës. Rrjeti i kanalizimeve të kryeqytetit përfshin tre nivele:

- **Rrjetin Terciar**, i cili është rrjeti me dimension $< \text{Ø } 200 \text{ mm}$ dhe përbëhet kryesisht nga rrjeti i brendshëm që ndërtohet dhe mirëmbahet nga vetë qytetarët.
- **Rrjetin Sekondar**, që është rrjeti me dimension nga $\text{Ø } 200 \text{ mm} \div \text{Ø } 400 \text{ mm}$, i cili parashikohet në rrugët lidhëse të qytetit.
- **Rrjetin Primar**, është rrjeti me dimension nga $\text{Ø } 500 \text{ mm} \div \text{Ø } 2000 \text{ mm}$ (keson), i cili është rrjet kryesor.

Në Lumin e Lanës shkarkojnë rreth 85 tubacione apo kolektor, por nga auditimi ka rezultuar se UKT sh.a. nuk e kryen monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura në lumin e Lanës. UKT

¹⁵ -Tirana 030, (Raport përmbledhës), përgatitur nga S.B., U., I. në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

sh.a. ka në administrim dhe në strukturën e vet një laborator i cili kryen analizat e ujit të pijshëm dhe jo ujërave të shkarkimeve, etj.

Lidhur me planimetrinë e vendndodhjes së dekantuesve/ gropave septike që lidhen direkt me lumin e Lanës, rezultoi se ato nuk administrohen dhe menaxhohen nga UKT sh.a. dhe se në këtë shoqëri nuk ka një informacion mbi numrin dhe vendndodhjen e tyre. Rrjedhimisht, në UKT sh.a. mungon informacioni mbi frekuencën e pastrimit të tyre nga ana e Bashkisë Tiranë. Aktualisht, nga ana e UKT sh.a. nuk kryhet trajtim paraprak i ujërave të ndotura, të cilat derdhen të patrajtuara drejtpërdrejt në lumin e Lanës.

Një nga problematikat kryesore për UKT sh.a. sidomos gjatë këtyre viteve të fundit, është se gjatë reshjeve të dendura të shiut me rritjen e nivelit të Lumit të Lanës, kolektorët nuk arrijnë të shkarkojnë plotësisht, duke krijuar përmbytje në disa zona të qytetit të Tiranës. Ky rezultat vjen pasi në rrjetin e kanalizimeve, shkarkon edhe rrjeti i ujërave të shiut, duke sjellë një ndikim negativ në mjedis.

Për sa i takon përditësimit/ rishikimit të hartës së kanalizimeve të qytetit të Tiranës, duke marrë shkas nga fluksi i madh i ndërtimeve të reja gjatë 10 vjeçarit të fundit, rezultoi se, aktualisht nga ana e MIE dhe AKUK në bashkëpunim edhe me UKT sh.a. është duke u punuar në përditësimin dhe hedhjen e te dhënave nëpërmjet sistemit GIS të rrjeteve kryesore të qytetit të Tiranës, kjo në kuadër të hartimit të master-planit në lidhje me kanalizimet e Tiranës së Madhe. Me hartimin e këtij master plani do të pasqyrohet gjendja aktuale e këtij rrjeti si edhe përllogariten nevojat mbi ridimensionimin e tij.

Nga burimi i Lumit Lana deri tek rreth rrotullimi i Shkozës si edhe nga pallati me Shigjeta deri në pikën fundore, duke qenë se këto dy zona janë zona informale dhe nga Bashkia Tiranë nuk ka një investim në sistemimin e shtratit të Lumit si edhe rrjeti i kanalizimeve është ndërtuar nga vetë banorët, kjo ka bërë të pamundur identifikimin e këtyre rrjeteve. Nga ana e shoqërisë UKT sh.a. ka qenë e pamundur kryerja e një investimi i cili do sistemonte (*inventarizonte dhe monitoronte*) shkarkimet në lumin e Lanës. Ndodhur në këto kushte nga ana e Bashkisë Tiranë apo edhe Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë nuk ka qenë e mundur një studim i ri, pasi ka qenë një studim në fazë zbatimi.

Mbi shtrirjen dhe mbulimin e rrjetit të kanalizimeve të Tiranës

Për qytetin e Tiranës gjatësia e përgjithshme e linjave të kanalizimeve të ujërave ku përfshihen: kolektorët, kanalizimet kryesore dhe degëzimet është 596 km në muajin qershor 2016, arrin në 600.9 km në janar 2017; 603.4 në dhjetor 2019; 605 km në tetor 2020; 608.2 km në tetor 2021 dhe 609.5 km në muajin maj 2022. Në fund të vitit 2024 rrjeti i kanalizimeve në qytetin e Tiranës ka një gjatësi prej 697 Km dhe është i sistemit mix në 90% të tij. Ky rrjet punon me vetërrjedhje deri në pikat përfundimtare të shkarkimit¹⁶.

Përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT për Tiranën, treguesi “gjatësia e kanalizimeve për banor të lidhur”, sipas viteve është:


- Viti 2017: 600 km= 600,000 m /862,000 banorë= *0.69 m/banor*;
- Viti 2019: 603,000 m/ 895 mijë banorë= *0.67 m/banor*;
- Viti 2021: 608,000 m/ 912,000 banorë= *0.66 m/banor*;
- Viti 2022: 609,000 m/ 919,000 banorë = ***0.66 m/banor***;

Grafika e mëposhtme¹⁷ paraqet gjatësinë e llojeve të ndryshme të kanalizimeve në shtetet e BE-së, analizuar nga EurEau-Federata Evropiane e Shoqatave të Shërbimit të Ujit.

¹⁶ UKT sh.a., Info nga drejtori i Departamentit Inxhinierik, date 13.06.2025, dërguar me email

¹⁷ -Burimi: “*Europe’s Water in Figures, An overview of the European drinking water and waste water sectors*”, 2021

Grafiku nr. 6: Gjatësia e rrjeteve të kanalizimeve në shtetet e BE-së



Burimi: EurEau, Europe’s Water in Figures, An overview of the European drinking water and waste water sectors”, 2021.

Grafiku i mësipërm paraqet gjatësinë e rrjetit të kanalizimeve për banorë të lidhur. Treguesi i vlerës mesatare për gjithë shtetet e përfshira në studim është **6.7** m kanalizime/ për banor të lidhur dhe krahasuar me raportin e vitit 2017, gjatësia totale është rritur me 10%. Pra, krahasuar me vendet e BE-së, pjesë e këtij studimi, normat për qytetin e Tiranës janë mbi 10 herë më të ulëta.

Mbi jetëgjatësinë e rrjetit të kanalizimeve

Pothuajse të gjitha tubacionet e kanalizimeve në qytetin e Tiranës janë vendosur gjatë viteve 1930 - 1970. Raporti i JICA-s¹⁸ identifikon se gjendja e rrjetit të tubacioneve të kanalizimeve nuk është përkeqësuar shumë për shkak të punës periodike të kryer nga UKT për mirëmbajtjen e tyre. Analiza e kapacitetit të kolektorëve të kanalizimeve është kryer në studimet e kaluara. Veçanërisht, studimi i financuar nga Kooperacioni Italian në vitet 2002-2003 ka kryer një analizë të hollësishme hidraulike për kolektorët dhe tubacionet kryesore të kanalizimeve. Këto analiza nxorën përfundimin se këto tubacione kanë kapacitet të mjaftueshëm për të shërbyer si një sistem tubacionesh grumbullimi më vete. Studimi i mëparshëm i JICA gjithashtu, propozoi shtimin e një linje kryesore të sistemit të grumbullimit të ujerave të zeza drejt Impiantit të Trajtimit të Ujerave të Ndotura (ITUN), duke përdorur në mënyrë të frytshme tubacionet e kanalizimeve të kolektorëve ekzistues.

Mosha mesatare e kanalizimeve në Gjermani dhe rinovimi i tyre: Betoni dhe punimet me gur janë materialet më të përdorura. Përqindja e tubave plastikë vazhdon të rritet. Përqindja e rehabilitimit që përfshijnë rinovimin vazhdon të bjerë; përqindja e riparimeve po rritet, përqindja e metodave të rinovimit është e pandryshuar. Një total prej 1.1% e sistemit të kanalizimit në Gjermani rehabilitohet çdo vit. Duke marrë parasysh gjatësitë e lidhura me klasat përkatëse të moshës, një shifër prej 39.8 vjetësh rezultoi për moshën mesatare të rrjetit për kanalizimet e pjesëmarrësit.

Mosha mesatare e infrastrukturës nëntokësore të shumë vendeve¹⁹ është afërsisht 40 vjeçare dhe, në disa raste, deri në 150 vjeçare, që çon në dëmtimin e kanalizimeve dhe rritjen e shkallës së rrjedhjeve. Kjo ka një ndikim në besueshmërinë dhe cilësinë e infrastrukturës së përgjithshme

¹⁸ Burimi: Raporti për Planin Tematik 2012, (hartuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, JICA),

¹⁹ Burimi - <https://www.norva24.com/about-us/ageing-underground-infrastructure/>

nëntokësore e cila ndikon në të gjithë shoqërinë. Në Norvegji, Gjermani dhe Suedi, afërsisht 0,5 deri në 1,2 për qind e kanalizimeve rinovohen çdo vit.

Referuar të dhënave të administruara nga AKUK, del se Treguesi i Mbulimit me KUN për UKT sh.a. gjatë periudhës 2020- 2024 ka shënuar një rritje, respektivisht me 7,4%, pasi ky indikator për periudhën e auditimit është: në v. 2020: 89.75% ; në v. 2021: 89.8% ; në v. 2022: 90.74% ; në v. 2023: 94,35% dhe në v. 2024: 97,15%. Në këtë analizë evidentohet se, ky indikator për UKT sh.a. shënon një performancë më të mirë sesa mesatarja e këtij treguesi në shkallë kombëtare, ku niveli mesatar i mbulimit me kanalizime është në diapazonin nga 52% deri në 55.75% (në v. 2024).

Mbulimi me rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të ndotura

Sipas informacioneve dhe evidencave të administruara nga UKT sh.a., treguesi i mbulimit me shërbimet e KUN në vite ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel, me rritje pothuajse të papërfillshme. Nga auditimi i treguesve të UKT sh.a. dërguar grupit të auditim të KLSH-së, shkalla e mbulimit me rrjetin e kanalizimeve për qytetin e Tiranës është 91% në vitin 2019, 94% në vitin 2021 dhe 95% në vitin 2024, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 7: Të dhëna ndër vite 2019 – 2024 mbi sistemin e kanalizimeve

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i klientëve	251.866	254.796	259.338	265.159	272.406	279.302
Shkalla e lidhjes – kanalizime (%)	91%	95%	94%	95%	94%	95%
Vëllimi mesatar i ujërave të ndotur/ frymë	113 m3/v	116 m3/v	120 m3/v	121 m3/v	118 m3/v	121 m3/v
Sasia e ujit të ndotur të faturuar (m3/y)	29.528.922	28.120.741	29.519.899	30.346.808	30.545.397	32.144.619
Shkalla e arkëtimit (%)	89.34%	76.51%	84.68%	94.60%	95.52%	100.12%

Burimi: UKT sh.a.

Nga sa më sipër, evidentohet se Treguesi i Mbulimit me KUN për qytetin e Tiranës për vitin 2023 prej 94% ka shënuar një rritje respektivisht me 3% krahasuar me vitin 2019 dhe është ndjeshëm mbi nivelin e këtij indikator në shkallë vendi prej 54.8%, (sipas Raportit të Performancës së ERRU, viti 2023). Mbulimi me Kanalizime dhe Trajtimi i Ujërave të Ndotura, për qytetin e Tiranës, si tregues të parandalimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore për vitin 2021, sipas Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ²⁰ është 89.7%, kurse sipas UKT sh.a. raportohet 94%.

²⁰ Burimi: AKM, Raporti “Cilësia e ujërave sipërfaqësorë në vendin tonë 2021”, Tirane, fq. 50-51

Tabela nr. 8: Mbulimi me ujësjellës-kanalizime, viti 2021

Shoqëria	Mbulimi me ujesjelles (%)	Mbulimi me kanalizime (%)
	11 Mujori	11 Mujori
Shkoder	56	44.3
Fushe arrez	96.6	37.5
Puke	39.4	25.4
Vau i dejes	57.3	6.2
Malesi e madhe	58.3	1.9
Lezhe	74.6	61.6
Mirdite	55.3	39.8
Kurbin	46.2	37
Kukes	74.7	50.8
Tropoje	55.8	24.7
Has	69.1	0
Tirane	96.0	89.7
Kamez	72.1	82.6
Kavaje	97.8	73.3
Rrogozhine	66	7.8
Vore	56.4	50.8
Durres	90.8	54.6
Kruje	43.5	25.7
Diber	92.3	41.1
Bulqize	51	28.3
Burrel	83.7	46.6
Klos	34.4	6
Elbasan	70.9	56.9
Librazhd	28.7	21
Gramsh	89	0

Burimi: Raporti “Cilësia e ujërave sipërfaqësorë në vendin tonë 2021”, AKM

Nuk ka përputhje mes treguesve të nivelit të mbulimit me rrjetet kanalizimesh të raportuar nga ERRU, me shkallën e lidhjes me rrjetin e kanalizimeve të UKT sh.a., pasi nga UKT sh.a. për vitin 2022 ky tregues është 95% dhe më tej bie pas një viti në 94%, kurse sipas raportit të performancës së ERRU, ky indikator për operatorin UK Tiranë për vitin 2022 është 92.60% dhe në vitin 2023 është 93.00%.

Mungon shpjegimi se, për çfarë arsyeje është ulur në vitet 2021 dhe 2023 shkalla e lidhjes me rrjetin e kanalizimeve (në%). Më konkretisht, nga 95% në vitin 2020, treguesi bie në 94% në 2021; si dhe nga 95% në vitin 2022 mbulimi me shkallën e lidhjes me rrjetin e kanalizimeve zbrit në 94% në 2023, në një kohë që numri i klientëve/abonentëve ka ardhur në vazhdimësi në rritje nga viti në vit.

Është rritur nga vit në vit numri i klientëve, por ka oshilacione të treguesit të shkallës së mbulimit me kanalizimeve dhe të vëllimit mesatar të ujërave të ndotura për frymë të popullsisë së kryeqytetit, (ku nga 113 m3/frymë në vitin 2013, arrin në 121 m3/frymë në v.2022 dhe zbrit në 118 m3/frymë në vitin 2023);

Nga analiza e trendeve sa më sipër, evidentohet:

1. Rritja e numrit të klientëve

Numri i klientëve ka një rritje konstante çdo vit, duke kaluar nga 251,866 në 2019 në 279,302 në 2024. Kjo tregon një rritje të qëndrueshme të kërkesës dhe të shërbimit, duke sugjeruar që ky sektor po zgjeron bazën e tij të klientëve. Rritja e numrit të klientëve mund të jetë rezultat i faktorëve si zgjerimi i shërbimeve ose rritja e popullsisë në zonat përkatëse.

2. Shkalla e lidhjes – kanalizime (%)

Përpjekjet për të rritur shkallën e lidhjes me kanalizimet bazohen në faktin se, ky tregues varjon nga 91% në 2019, në 95% në 2024, me disa vite që qëndrojnë stabël/ të pandryshueshëm. Ka një përmirësim të vazhdueshëm në mbulimin e kanalizimeve, përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjeve me rrjetin e kanalizimeve. Pavarësisht rënieve të treguesit në vitet 2021 dhe 2023, shkalla e përgjithshme e lidhjes me kanalizime është mbi 90%.

3. Vëllimi mesatar i ujërave të ndotur për frymë

Vëllimi mesatar i ujërave të ndotur për frymë ka një rritje nga 113 m3/v në 2019 në 121 m3/v në 2024, me disa luhate. Ky ndryshim identifikon një rritje të pandryshme të vëllimit të ujërave të

ndotur për frymë, që mund të jenë pasojë e rritjes së numrit të klientëve ose ndryshimeve në përdorimin e ujit në zonat e shërbimit. Kjo mund të kërkojë një menaxhim më të mirë të ujërave të ndotur, duke optimizuar proceset për trajtimin e tyre.

Investimet e UKT-së janë fokusuar kryesisht në sektorin e furnizimit me ujë, në raport me sektorin e rrjetit të kanalizimeve.

Tabela nr. 9: Të dhënat mbi investimet e kryera nga ana e UKT sh.a për periudhën 2015- 2024

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Investime në sistemin e furnizimit me ujë (në lekë)	63,899,288	330,322,065	173,264,215	802,180,270	113,192,180	803,069,908
Investime në sistemin e kanalizimeve (në lekë)	88,738,873	130,626,143	30,230,120	120,492,945	7,027,807	263,192,912
INVESTIME TOTAL (në lekë)	152,638,161	460,948,208	203,494,335	922,673,215	120,219,987	1,066,262,803
Pesha specifike (në%) e inv të kanalizimeve /totalit	58%	28%	15%	13%	6%	25%
Popullsia e Tiranës (banorë sipas INSTAT)	834,151	842,981	862,361	883,996	895,160	906,166
Investime në rrjetin e kanalizimeve/nr popullsie (në lekë/ banor/ vit)	106.3 lek /banor/vit	154.9 lek /banor/vit	35.1 lek /banor/vit	136 lek / banor/vit	7.8 lek /banor/vit	290 lek /banor/vit

	2021	2022	2023	2024
Investime në sistemin e furnizimit me ujë (në lekë)	820,061,365	2,734,348,167	84,946,180	186,425,950
Investime në sistemin e kanalizimeve (në lekë)	150,756,753	57,226,801	11,252,924	67,059,570
INVESTIME TOTAL (në lekë)	970,818,118	2,791,574,968	96,199,104	253,485,320
Pesha specifike (në%) e inv të kanalizimeve /totalit	16%	2%	11%	27%
Popullsia e Tiranës (banorë sipas INSTAT)	912,190	919,511	925,268	925,268* (marrë e pandryshuar sa v.2023 mqs mungojnë të dhënat)
Investime në rrjetin e kanalizimeve/nr popullsie (në lekë/ banor/ vit)	165.3 lek /banor/vit	62.2 lek / banor/vit	12.6 lek /banor/vit	72.4 lek /banor/vit

Burimi: UKT sh.a., INSTAT, përpunuar nga grupi i auditimit

Fondet e UKT sh.a. të destinuara për përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të qytetit të Tiranës për periudhën 2015-2024 paraqesin një kurbë asimetrike dhe ato variojnë nga 2-58% të investimeve kapitale vjetore gjithsej.

Në vitet 2016 e 2018, nga UKT sh.a. janë realizuar investime për funksionimin e sistemit të kanalizimeve në vlerën përkatëse prej 130 milionë dhe 121 milionë lekë. Duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të krijuar në vitin 2019 (*tërmeti me pasoja të nevojës për rindërtim*), në vitin pasues 2019, ka një trend në rënie. Përndryshe, niveli i shpenzimeve për investime në sistemin e kanalizimit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura në 2020 ka arritur nivelin më të lartë të periudhës 2013-2024, prej 263.2 milionë lekë, që në fakt përfaqësojnë vetëm 25% të vlerës së investimeve gjithsej të UKT sh.a. për të vit.

Në vitet 2021, 2022 dhe 2023 trendi i fondeve të destinuara për sistemin e kanalizimeve nga UKT sh.a. ka ardhur në rënie, përkatësisht, 151 milionë, 57 milionë dhe 11 milionë lekë, edhe pse kemi rritje të buxhetit të përgjithshëm të investimeve, duke arritur vlerën më të lartë në vitin 2022 prej 2,8 miliardë lekë, ose + 1,8 miliardë lekë më shumë se viti i mëparshëm 2021. Në vitin 2023 investimet e përgjithshme të UKT janë 96 milionë, duke u rritur në vitin 2024 prej 2.6 herë ndaj investimeve totale të vitit të mëparshëm dhe arritur në shumën prej 253 milionë lekë.

Mbështetur në të dhënat e tabelave dhe grafikëve të mësipërm, rezultoi se, investimet kapitale gjithsej të UKT sh.a. në sistemin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve për periudhën e

analizuar 2015-2024 arrijnë në 7,038 milionë lekë.

Fondet e destinuar për përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të qytetit të Tiranës kulmojnë si masë relative (në%) në vitin 2015, ku pesha specifike e këtyre fondeve zinte 58% të investimeve vjetore gjithsej dhe me trend rënës, derisa në vitin 2022 shënjohej përqindja më e ulët e investimeve të realizuara për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve, me vetëm 2,1% të totalit të fondeve gjithsej të shpenzuara për investimet e UKT.

Për gjithë periudhën 2015-2024 investimet gjithsej të UKT sh.a. janë 7,038 milionë lekë dhe ato për sistemin e kanalizimeve vetëm sa 13.2% e tyre, ose 927 milionë lekë.

Vlera më e lartë e investimeve të UKT sh.a. i përket vitit 2022 prej rreth 2.8 miliardë lekë, ka dhe përqindjen më të ulët të fondeve të drejtuara për kanalizimet, prej 2%; kurse niveli maksimal për investimet në rrjetin e kanalizimeve dhe shkarkimeve të ujërave të përdorua të këtij 10-vjeçari është arritur në vitin 2020 prej 263.1 milionë lekë, që në fakt është sa $\frac{1}{4}$ e totalit të investimeve vjetore.

Mesatarja e fondeve vjetore të akorduara për sistemin e kanalizimeve gjatë kësaj periudhe 10-vjeçare është 20.1% e fondeve totale të investimeve, ndërsa niveli më i ulët i tyre në masë absolute është në vitin 2019 prej 7 milionë lekë si dhe në vitin 2023 prej 11.3 milionë lekë.

Për rrjedhojë, këto investime të rrjetit të kanalizimit që për periudhën 2015-2024 arrijnë në 926,6 milionë lekë, vlerësohet që kanë dhënë një ndikim të lehtë e të pa ndjeshëm në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime të ujit dhe zvogëlimin e shkarkimit të ujërave të ndotur në lumenjtë e kryeqytetit.

Pamjaftueshmëria dhe mungesa e burimeve të nevojshme financiare për infrastrukturën e kanalizimeve. Nivelet e investimeve në sektorin e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe përpunimit të ujërave të ndotura në qytetin e Tiranë janë dukshëm më të ulëta se sa nevojat, kjo sidomos në kushtet që infrastruktura e kanalizimeve është e vjetër, e dëmtuar dhe herë-herë joefikase. Ndryshimet demografike të lidhura me migrimin e popullsisë drejtë kryeqytetit pas ndryshimit të regjimit në vitin 1991 dhe rritja e ndjeshme pasuese e kërkesës për shërbimet e largimit të ujërave të zeza, kanë ndikuar në situatën e infrastrukturës së kanalizimeve, e cila në shumicën e rasteve funksionon me kapacitetin maksimal. *Edhe pse vitet e fundit investimet kanë ardhur në rritje, ato nuk janë më të orientuara dhe të bars-peshuara në furnizimin me ujë dhe infrastrukturën e kanalizimeve, dhe se ato asnjëherë nuk kanë qenë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat për investime kapitale²¹.*

Vetëm për përfundimin dhe vënien në punë të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura të Kasharit²², në përputhje me direktivën e ujërave të ndotura urbane (EU 91/271 KEE) dhe Direktivën Kuadër të Ujit (2000/60/KE), fondet e përlllogaritura janë 10,653 milionë lekë.

Mbi tarifën e grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura

Kodi i Furnizimit me Ujë, i miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, në pikën 2.1 përcakton se UK mbledh të gjitha detyrimet e konsumatorëve që ju siguron shërbimin e *grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*. Kjo tarifë duhet të mbulojë kostot e arsyeshme të kryerjes së një shërbimi efektiv për të tre këto komponentë. Tarifa, sipas përcaktimit në KFU, do të përlllogaritet sipas metodologjisë të përcaktuar nga ERRU dhe miratohet nga ERRU.

²¹ -Revista "Monitor", Dhjetor 2017: **Në Evropë përgjithësisht këto raporte janë të kundërta krahasuar me vendin tonë, ku kostot e shërbimeve të KUN (grumbullim dhe trajtim) përbëjnë 60%-70% të kostove totale, ndërsa ato të shërbimeve të ujës-jellësit zënë rreth 30%-40% të tyre.** Për të vlerësuar nga ana sasiore problemin e përballueshmëria së pagesës së tarifave, nëse i referohemi Bankës Botërore dhe KE ato kanë përdorur si kriter për të vlerësuar përballueshmërinë konsumin mujor për person prej **3m3 (ose 100 litra/ditë/person)**, dhe një nivel përballueshmërie 4% të të ardhurave mesatare të një familjeje. Në këtë vlerësim përjashtohet shtresa në nevojë e popullsisë në varfëri ekstreme që përbën rreth 2.5% të totalit të popullsisë.

²² -Referuar Tabelës 13-9 "Tabelat përkëtesë për kostot dhe fondet e masave për ujjat sipërfaqësorë", pjesë e Raportit Kryesor të PMBU Ishëm 2024-2029, miratuar me VKM nr.624, date 08.11.2023.

Sipas Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Entit Rregullator të Ujit me nr. 39, datë 09.2.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me nr. 22, datë 24.04.2019, është përcaktuar se “Kostot për shërbimet e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve në varësi të volumit të konsumuar dhe të shkarkuar. Tarifat do të ndjekin ritëm progresiv në varësi të volumit të konsumuar dhe të shkarkuar. Për ndotësit problematikë (që shkaktojnë ndotje të rënda), do të vihet një tarifë shtesë për ujrën e ndotura. Komponenti fikse në përgjithësi mbulon kostot fikse”. Mbi këtë bazë, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRSFULUN²³, me vendimin nr.47, datë 07.11.2017 ka miratuar tarifën për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., ku tarifa *volumetrike* e largimit të ujërave të ndotura është 11 lek/m³ për klientët familjarë, 30 lek/m³ për klientët publikë dhe 35 lek/m³ për klientët privatë, (në fuqi nga data 01.01.2018). Tarifa për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura për qytetin e Tiranës nuk ka pësuar rritje nga çmimi prej 11 lek/m³, argumentuar kjo dhe me faktin se nuk ka përfunduar ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Kashar (Projekti JICA).

Sipas kategorive të klientëve dhe kategorive të shërbimeve, tarifën volumetrike dhe ato fikse të miratuara për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. me vendimin e ERRU nr. 47, datë 07.11.2017 janë si më poshtë:

a. Tarifë volumetrike për shërbimet:

Kategoria e klientëve	Furnizim me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Klientë familjar	65 lekë/m ³	11 lekë/m ³
Klientë publik	140 lekë/m ³	30 lekë/m ³
Klientë privat	155 lekë/m ³	35 lekë/m ³
Klientë të veçantë (Prodhim pije alkolike, freskuese, pishina)	170 lekë/m ³	40 lekë/m ³
Furra buke	95 lekë/m ³	13 lekë/m ³
Shitje uji me shumicë	12 lekë/m ³	-
HEC Lanabregas	5 lekë/m ³	-

b. tarifë fikse

Klientë familjar	200 lekë/muaj/klient
Klientë publik	200 lekë/muaj/klient
Klientë privat	200 lekë/muaj/klient
Klientë të veçantë (Prodhim pije alkolike, freskuese, pishina) Furra buke	200 lekë/muaj/klient

Ky vendim i ERU ka miratuar dhe Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018, 2019 dhe deri në fund të vitit të 5-të (2022) sipas planit të biznesit, që janë si më poshtë:

Tabela nr. 10: Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës UKT sh.a. për vitin 2018 -2022

Treguesit e Performancës	Viti 2018	Viti 2019	Pritshmëria Viti 2022
Uji Pa të Ardhura (humbjet)	65%	60%	40%
Niveli i matjes	77%	78%	97%
Kohëzgjatja e furnizimit			24 orë/ditë
Eficensa e stafit			2.45 punonjës/000/lidhje
Mbulimi me ujë	90%	93.5%	95.3%
Mbulimi me kanalizime	78.7%	80.1%	83.5%
Norma e arkëtimit	90%	91%	92%

²³ - ERRSFULUN= Enti Rregullator i Sigurimit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Cilësia e ujit (klor + koliform)	sipas standardeve	sipas standardeve	sipas standardeve
----------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------

Nga shqyrtimi i tarifave të shërbimit të ujit për çdo shoqëri UK në basenin e lumit Ishëm, pasqyruar në Tabelën nr. 4-10 të PMBU Ishëm, konstatohet se për ujërat e ndotura, nga UK Tiranë sha për periudhën e auditimit aplikohen tarifat prej 11 lek/m³ për abonentët familjarë, 30 lek/m³ për abonentët shtetëror dhe 35 lek/m³ për subjektet private, të cilat për abonentët familjarë për trajtimin e ujërave të ndotura janë më të ulëta se sa tarifat e aplikuara nga UK Vorë dhe më të larta se UK Krujë, (si në tabelën e mëposhtme):

Tabela nr. 11: Tarifat e shërbimit të ujit në UKT sh.a. dhe UK Vorë dhe Krujë

Shoqëri UK	Uji i pijshëm lek/m ³			Tarifa fikse lek/klient/muaj			Për ujërat e ndotura		
	Familjar	Shtetëror	Private	Familjar	Shtetëror	Privat	Familjar	Shtetërore	Privat
UK Tiranë	65	140	155	200	200	200	11	30	35
U.K Vorë	65	140	155	200	200	200	15	30	35
U.K Krujë	35	80	100	100	200	200	8	12	12

Burimi: Tabela nr. 4-10, PMBU Ishëm

Niveli i lartë i gjendjes së llogarive të arkëtueshme (borxhet e pambledhura dhe të mbartura ndër vite), ndikon në mosrealizimin e investimeve në sistemin e kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të ndotura.

1. Bazuar në të dhënat e Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore të UKT sh.a. për vitin 2023 dhe Raportit të Audituesve Ligjorë mbi certifikimin e tyre, (protokolluar në UKT sh.a. me nr.1041/5, datë 02.07.2024), rezultoi një nivel i lartë i gjendjes së llogarive të drejtave të arkëtueshme, të mbartura ndër vite²⁴. Në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31.12.2023, vlera bruto e llogarive të arkëtueshme është 6,329,607 mijë lekë, ndërsa me datën 31.12.2022 niveli i llogarive të arkëtueshme është 6,031,917 mijë lekë. Për këto shuma, nisur nga natyra e aktivitetit që ka volum të madh të abonentëve dhe faturimeve, shoqëria ka kryer çmuarje për zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme, në përputhje me analizën e përshkruar në shënimin 5 të pasqyrave financiare “Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit”.

Baza e opinionit me rezervë të audituesve ligjorë, ka mbajtur parasysh faktet se:

1. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjonimin e llogarive të arkëtueshme, siç kërkohet në kërkesat e SNRF 9 “Instrumentet financiare”, i cili kërkon rivlerësim individual ose kolektiv të balancave të arkëtueshme, mbështetur në të dhënat historike.

2. Shuma analitike e llogarive të arkëtueshme në sistemin Oracle në mbyllje të ushtrimit, nuk rakordon me vlerën e llogarive të arkëtueshme të grupit, të shprehura në pasqyrat financiare.

Sipas vlerësimeve të kryera nga audituesit e KLSH-së, del se gjendja e grupit të llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2023 prej 6,3 miliardë lekë është e përbërë nga 5,1 miliardë në zërin “Llogari të arkëtueshme” dhe 1,2 miliardë lekë në zërin “Llogari të arkëtueshme të tjera”. Pesha totale e grupit të llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2023 është afro 29% të vlerës së Aktiveve Afatgjata Materiale, (raporti 6,3 miliardë lekë/ 22 miliardë lekë), ose rreth 22% të vlerës së Aktiveve Neto Gjithsej më datën 31.12.2023 (raporti 6,3 miliardë lekë / 29.6 miliardë lekë).

2. Treguesit Kryesorë të Performancës së raportuar nga ana e UKT sh.a. dhe AKUK për periudhën e analizuar pasqyrojnë mungesa rakordimi dhe për rrjedhojë këto të dhëna mund të konsiderohen si llogaritje të përafërta. *Më konkretisht,*

Referuar të dhënave që audituesit e KLSH-së kanë administruar nga UKT sh.a. për periudhën 2019-2024 niveli i arkëtimit varion nga 76.5% deri në 100.12% dhe këto tendenca, krahas rritjes së numrit të klientëve, vlerës së arkëtuar janë si në tabelë:

²⁴<https://opencorporates.al/documents/bilanci/1725010295Pasqyraeperformancspasqyraetardhuravedheshpenzimeve sipasnatyresUKTsha.xlsx 30 2024.xlsx>, ose Ekstrakti historic UKT sh.a. 12-9-2024.

Tabela nr. 12: Arkëtimet nga shërbimet e UKT sh.a. për periudhën 2019-2024

Periudha	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Indikatori						
Numri i klientëve	251.866	254.796	259.338	265.159	272.406	279.302
Shkalla e arkëtimit (%)	89.34%	76.51%	84.68%	94.60%	95.52%	100.12%
Vlera e arkëtuar	529.966.696	472.255.292	531.485.212	558.005.833	559.348.273	602.524.494

Burimi: UKT sh.a.

Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat e pasaportës së indikatorëve që **AKUK** ka raportuar për periudhën 2020-2024, për UKT sh.a. rezultoi një situatë tjetër treguesish në lidhje me nivelin e arkëtimit korrent e të përgjithshëm (në%), sipas kategorive të konsumatorëve:

Tabela nr. 13: Normat e arkëtimit të UKT sh.a. për periudhën 2020-2024 (raportuar AKUK-ut) në%

Indikatori		2020	2021	2022	2023	2024
Norma e Arkëtimit - Korente	%	82.52	75.3	62.9	62.6	65.9
Norma e Arkëtimit - Përgjithshme	%	128.6	122.6	104.8	87.7	89.3

Burimi: AKUK

Eficienca në mbledhjen e të ardhurave korente është elementi kryesor i qëndrueshmërisë financiare të shoqërive të Ujësjetllës Kanalizimeve. Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjetllës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj dhe varet kryesisht nga faktorët menaxheriale. Treguesi i llogaritur i Normës së Arkëtimit Korrent (NAK), *shpreh arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin përkatës (p.sh v.2023)*, si dhe treguesi i Normës së Arkëtimit e Përgjithshme (NAP), *përfshin edhe arkëtimet e debive të prapambetura që janë regjistruar përpara vitit raportues*.

NAK për UKT sh.a.: Sipas raportit të ERRU-së për vitin 2023 (Tiranë 2024, faqe 77), në lidhje me nivelin e arkëtimit të faturës korente për UKT sh.a. për vitin 2022 dhe 2023, rezultoi se UKT sh.a. kryeson me një normë arkëtimi korente përkatësisht, me 92.6% dhe 97.40%, pra, **mbi 82%**, që konsiderohet si tregues i performancës së mirë nga ana e ERRU për UK-të, ku treguesit relativë me të dhënat e NAK janë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 14: Norma e arkëtimeve korrente 2022 dhe 2023 për UK-të.

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2022 (%)	2023 (%)	Ndryshimi 2023-2022 (%)
1	Kamëz	UK	66.70	76.60	9.90
2	Durrës	UKR	73.90	79.70	5.80
3	Tiranë	UK	92.64	97.40	4.80

Burimi: ERRU për vitin 2023 (Tiranë 2024, faqe 77),

Niveli i arkëtimit të faturës korente për UKT sh.a është përkatësisht 92.7 dhe 97% për v.2022 dhe 2023²⁵, dhe shoqëria UKT ka shënuar përmirësim të treguesit të NAK, në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, me (+4.80%). Nga analizat e treguesve rezultoi se për UKT sh.a., norma e arkëtimit korrent është mbi mesataren e realizuar në shkallë sistemi të UK-ve. Kështu, për vitin 2022 dhe 2023, NAK e UKT sh.a. është përkatësisht + 11,23% në v.2022 dhe +13.5% në v.2023 më shumë se mesatarja e sistemit UK, (kundrejt nivelit të arritur prej 81.44% në vitin 2022 dhe 83.9% në v.2023 për sistemin). Kjo evidenton një ecuri pozitive të këtij treguesi, duke treguar ndërgjegjësimin e konsumatorëve në drejtim të pagesës së faturës së ujit të konsumuar. UKT sh.a., krahas arkëtimit të faturave korente, ka marrë masa për mbledhjen e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma, si lidhja e akt - marrëveshjeve shoqëri – klient, për pagesën e tyre me këste,

etj. Në tregues relativë të dhënat e pasaportës së indikatorëve të sistemit të UK si dhe indikatorët e “*performancës së mirë*” shprehen si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 15: Treguesit e performancës së Sektorit UK për periudhën 2022 dhe 2023.


Tabela nr. 4. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitet 2022,2023					
Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2022	2023	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	63.7	64.7	↘	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	90.3	100.5	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	66.8	72.8	↗	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	97.3	103.5	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	81.4	83.9	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	82.8	86.5	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.73	4.56	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	16.3	16.3	=	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	54.2	54.8	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	78	75.3	↘	n/a
11	Efiçenca e Energjisë FU (kwh/m³)*	0.65	0.63	↗	n/a
12	Ankesat e Klientëve (%)*	2.8	4.23	↘	n/a

Burimi: ERRU

Burimi: ERRU, Raporti Performancës 2023, Tiranë 2024, faqe 14

Treguesit e NAK të UKT sh.a., krahasuar me 17 shoqëri UK që operojnë në këtë sektor rezultoi me *performancën më të mirë* pasi për këtë tregues UKT sh.a. renditet mbi mesataren e UKR-ve, të tilla si, UK Vorë (93.70%), UKR Berat (90.4%), UKR Pogradec (90.10%), etj. Kjo dinamikë e arkëtimit të faturës korente paraqitet në grafikun në vijim:

Grafiku nr. 7: Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente, 2023 për sh.a. UK.



Burimi: ERRU, Raporti i Performancës UK 2023, Tiranë 2024.

Referuar Aneksit nr. 2, Tabela 25. “Norma e Arkëtimit Korente dhe e Përgjithshme, Vitet 2022-2023”, të Raportit të Performancës së ERRU 2023, (Tiranë 2024, faqe 70) janë ruajtur trendet e rritjes së indikatorit të NAP për vitet 2022 dhe 2023:

Tabela nr. 16: Norma e Arkëtimit Korente dhe e Përgjithshme, Vitet 2022-2023

Emërtimi	Norma e Arkëtimit Korente		Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	
	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2023
UK Tiranë sha	92.67%	97.40%	101.16%	105.60%
Total sistemi UK	81.44%	83.90%	97.29%	103.50

Burimi: ERU, Raporti i Performancës 2023, (Tiranë 2024, faqe 70) dhe të dhënat e AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

NAP për UKT sha: Për UKT sh.a. norma e arkëtimit të përgjithshëm është mbi mesataren e arritur

në shkallë sistemi të UK-ve, për vitin 2022 dhe 2023, ku NAP e UKT sha është përkatësisht + 3.87% në v.2022 dhe +2.1% në v.2023, më shumë se mesatarja e sistemit të ujësjellës kanalizimeve, (ku niveli i arritur është 97.29% në vitin 2022 dhe 103.5% në v.2023 për sistemin).

UKT sh.a. për vitet 2020 deri 2024 nuk ka arritur indikatorin e ujit pa të ardhura dhe niveli i tij është mjaft i lartë e i papranueshëm.

Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve njihet si "Ujë pa të ardhura". Analizimi i humbjeve të ujit, atyre reale dhe administrative ndihmon në pasqyrimin real të shkaqeve dhe dobësive të shoqërisë UKT lidhur me shërbimin që nuk gjeneron të ardhura. Bilanci i ujit pasqyron një llogaritje të kërkesës për ujë nga konsumatorët si formë e konsumit të dobishëm ose humbjeve të panevojshme, gjë që do të çojë në përmirësimin e treguesve ekonomike dhe financiar të shoqërisë.

Në dokumentin “Manuali për Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës të UK”, përgatitur nga ERRU, Shoqata e UK-ve dhe GIZ, në paragrafin 5.3.4.2 të tij, lidhur me reduktimin e humbjeve të ujit është nënvizuar se: ”Reduktimi i humbjeve të ujit mbetet një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve. Reduktimi i humbjeve të ujit mund të ndikojë në mënyrë të ndjeshme në performancën financiare të shoqërisë UK. *Kjo për faktin se, prodhimi i ujit është i kushtueshëm nëse analizohen kostot e ndërtimit të instalimeve në pikën e prodhimit, kimikatet, puna dhe sasia e madhe e energjisë elektrike që shpenzohet në stacionet e pompimit. Këto kosto duhet të mbulohen nga shitja e ujit, dhe në rastin e shoqërive që kanë normë të lartë të humbjeve të ujit, konsumatorëve u bie të paguajnë tarifa më të larta për këtë inefficencë. Kështu, reduktimi i humbjeve të ujit redukton kostot, dhe në shumë raste ul ndjeshëm shpenzimet, prandaj humbjet e ujit përfaqësojnë çështjen më të rëndësishme dhe me ndikim në besimin e donatorëve / investitorëve në manaxhimin e shoqërisë”. Në paragrafin 1.2 “Çështjet aktuale të lidhura me Reformën e Sektorit të Ujit në Shqipëri”, (faqe 5 e këtij dokumenti), është dhënë dhe niveli mesatar i këtij indikator në shkallë vendi, ku cilësohet se: “*Humbjet teknike dhe administrative të ujit (uji pa të ardhura) vlerësohen të jenë në një mesatare prej 47% në zonat urbane të Shqipërisë*²⁶... *Sistemet modern të heqjes dhe trajtimit të ujërave të përdorura mungojnë gjerësisht në gjithë vendin*”.*

Për vitin 2022, shoqëria UK Tiranë ka raportuar prodhimin total të ujit në sasinë 97,740,100 m³, i cili rezultoi i matur në nivelin 75% ndërsa pjesa tjetër llogaritet e vlerësuar. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë rezultoi 265,159 lidhje, nga të cilat vetëm 239,446 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë është pjesërisht i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) e për pasojë shoqëria e ka të vështirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e shërbimit, si dhe në ndërtimin e strategjisë për zvogëlimin e tyre duke u fokusuar me prioritet tek DMA-të më problematike. “Uji Pa të Ardhura“ (UPA) në nivelin **59.78% konsiderohet mjaft i lartë dhe i papranueshëm**²⁷. Konstatohet se ka vështirësi në administrimin e rrjeteve shpërndarëse për shkak të shtrirjes së madhe territoriale, si dhe gjatë 30 viteve nga zhvillimi urbanistik i pakontrolluar rrjetet e furnizimit kanë qenë subjekt abuzimi nga banorët me lidhje dyfishe apo të paligjshme dhe shpesh herë jashtë standardeve teknike.

Niveli i këtij treguesi për vitin 2023, rezultoi në nivelin **64.7%** që tregon një trend negativ krahasuar me vitin 2022 dhe larg nivelit të përcaktuar nga ERRU prej **30% të performancës së mirë**


²⁶ -Ky nivel prej 47% i është referuar të dhënave të vitit 2009, kurse bazuar në të dhënat e AKUK për periudhën e analizuar 2020-2024, (ky tregues është përkatësisht 65.9%, 65.39%, 64.35%, 64.52% dhe 61.3%), e për rrjedhojë ky indikator i ujit pa të ardhura për 5-vjeçarin është mesatarisht **64.29%**.

²⁷ - ERRU, Bilanci i ujit të UK Tiranë 2022, Link:

<https://www.bing.com/ck/a?!&p=f664c71eeae3712980490cdb821b0ef16a2e5e4f93c2f04eec8d858ded4b6b3Jmlt dHM9MTc0ODA0NDgwMA&ptn=3&ver=2&hsh=4&fclid=2b3aa82b-1e7f-6b71-171c-bbb51fad6ae9&psq=ERRU+bilanci+i+ujit+te+UK+Tirane&u=a1aHR0cHM6Ly9lcnJlLmFsL3dwLWNvbnRlbnQv dXBsb2Fkcy8yMDI0LzA1L0JpbGFuY2ktaS1Vaml0LXBldi1TaGEtVUstVGlyYW5lX2ZpbmFsLnBkZg&ntb=1>

dhe mbi 50% të konsideruar si tregues i performancës së dobët. Faktorët kryesorë në përkeqësimin e treguesit UPA 2023 ndaj 2022 me (+4.93%) janë rritja e sasisë së ujit të prodhuar (duke qenë se vazhdon të jetë i pamatur në shumë prej burimeve) dhe mospërmirësimi i sasisë së ujit të faturuar i cili ka mbetur në të njëjtin nivel. Problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, niveli i ulët i matjes dhe vlerësimi i volumeve të ujit të prodhuar dhe faturuar për disa nga shoqëritë UK, apo historiku i raportimit të të dhënave jo të sakta nga ana e ish shoqërive UK tregojnë arsyet e luhatjeve të herë pas hershme të treguesit UPA në shoqëritë e UK-ve.

Grafiku nr.8: Uji pa të ardhura në sistemin UK, viti 2023.



Burimi: ERRU, “Raporti i Performancës për sha UK 2023”, Tiranë, Korrik 2024.

Referuar grafikut të këtij treguesi vihet re se, UKT sh.a. **nuk ka performuar nën kufirin 30% të treguesit të performancës së mirë.** Vihet re, **se në nivele të ulëta përkeqësimi të këtij treguesi rezultoi Sh.A.UK Tiranë (+0.2%)**

Treguesit e raportuar nga UKT sh.a. në AKUK për periudhën 2020-2024 mbi ujin pa të ardhura, si pjesë e pasaportës së indikatorëve të performancës, janë si më poshtë:

Tabela nr. 17: Treguesi i ujit pa të ardhura të UKT sh.a., Vitet 2020-2024

Treguesi	Njësia	2020	2021	2022	2023	2024
Shitjet e Ujit	l/f/d	162.35	158.9	156.38	152.64	154.21
Shitjet e Ujit - Familjarë	l/f/d	132.73	126.6	123.06	120.2	120.98
Uje pa të ardhura	%	61.43	61.6	59.79	59.95	61.83

Burimi: AKUK

Bazuar në indikatorët e caktuar nga ERU, UKT sh.a. **përsa i takon ujit pa të ardhura vazhdon të operojë mbi kufirin 50% për periudhën 2020 deri më 2024, që vlerësohet si performancë e dobët.**

Tabela nr. 18: Indikatorët e caktuar nga ERRU për UKT sh.a. mbi UPA

Treguesit e Performancës	Viti 2018	Viti 2019	Pritshmëria Viti 2022
Uji Pa të Ardhura (humbjet)	65%	60%	40%
Cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standardeve	sipas standardeve	sipas standardeve

Burimi: ERRU

Sipas indikatorëve që aplikon ERU, performanca e përgjithshme e shoqërive të Ujësjetës Kanalizime jepet përmes 12 treguesve të performancës të paraqitura në tabelën e mëposhtme, që merren në analizë nga ERRU dhe që përmbledhen e rishikohen sipas metodologjisë së re të tarifave. Në tabelë krahas tendencës së treguesve të performancës (2023 krahasuar me vitin 2022) jepen edhe objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU, ku për ujin pa të ardhura performancë e mirë është nën **30%**.

Tabela nr. 19: Indikatorët e performancës Sistemit UK 2022-2023

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	2022	2023	Tendencë	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	63.7	64.7	↘	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	90.3	100.5	↗	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	66.8	72.8	↗	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	97.3	103.5	↗	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	81.4	83.9	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	82.8	86.5	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.73	4.56	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	16.3	16.3	=	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	54.2	54.8	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	78	75.3	↘	n/a
11	Efiçenca e Energjisë FU (kwh/m ³)*	0.65	0.63	↗	n/a
12	Ankesat e Klientëve (%)*	2.8	4.23	↘	n/a

Burimi: ERU, Raporti Performancës 2023, Tiranë 2024, faqe 14.

UKT sh.a. dhe analiza me shoqëritë rajonale të UK-ve në vend.

Referuar grafikut të mësipërm të këtij treguesi për v.2023, vihet re se, UKT sh.a. ka performuar më mirë se UK Kamza, UK Durrës, UK Fier për ujin pa të ardhura, por më dobët se UK Pogradec, UK Berat, UK Gjirokastrë, UK Kukës, etj. Në grupimin me performancë të dobët për këtë indikator përfshihet edhe UKT sh.a.

★ Fact box nr. 2: Uji pa të Ardhura (UPA) për UKT sh.a.

UKT sh.a.:

- UPA për vitin 2024 është 61.83%
- Mbi nivelin kombëtar prej 61.3% dhe mbi kufirin 50% të ERRU për "performancë të dobët".
- Nuk është arritur objektivi i performancës sipas Planit të Biznesit (≤ 40% pas vitit 2022).

📉 Tendencë Negative (2020–2024):

- Humbjet e ujit kanë vijuar të mbeten të larta, pavarësisht rritjes së nivelit të matjes me ujëmatës (91.18% e lidhjeve të matura në vitin 2024).
- Faturimi ka rënë: nga 162.35 l/f/d në 2020 në 154.21 l/f/d në 2024.

📊 Krahasimi me BE-në:

- Vendet me performancë të mirë: Gjermani (5%), Danimarkë (7%), Poloni (17%).
- UKT është më afër niveleve të humbjeve me Bullgarinë (60%), etj.

⚠️ Faktorët që ndikojnë te NRË:

- Mungesa e matësve në burim dhe te klientët;
- Infrastruktura e vjetruar dhe rrjedhje në rrjet;
- Raportim jo i saktë i të dhënave;
- Mungesa e investimeve për reduktimin e humbjeve reale.

📌 Reduktimi i UPA është jetik për qëndrueshmërinë financiare të UKT sh.a., besueshmërinë të donatorët dhe për uljen e kostove për konsumatorët.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk janë paraqitur observacione nga subjektet e audituara.

8. Gjetje nga auditimi:

Strategjia Kombëtare Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030 dhe kuadri ligjor në fuqi përcaktojnë Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve, së bashku me Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës Kanalizimeve, si përgjegjës për zgjerimin dhe përmirësimin e aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura për popullsinë.

Nga auditimi rezultoi mungesa e aksesit të qëndrueshëm dhe të sigurt në shërbimet e kanalizimeve urbane për një pjesë të popullsisë në kryeqytet. *Më hollësisht,*

- Tirana ka një sistem kanalizimesh të përzier (të kombinuara dhe të ndara), që sjell kapërderdhje të ujërave të ndotura dhe përmytje.
- Deri në vitin 2022, 50% e popullsisë urbane nuk ka patur akses në kanalizime të menaxhuara në mënyrë të sigurt.
- 30% e popullsisë përdor sisteme jo të lidhura me rrjet kanalizimesh (gropa septike), shpesh pa trajtim të mëtëjshëm.
- Ujërat e ndotura derdhen drejtpërdrejt në lumenj, përfshirë Lanën dhe lumin e Tiranës.

Mungesa e koordinimit institucional dhe investimeve të mjaftueshme, veçse në mospërputhje me Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023 – 2030, ka sjellë përkeqësim të situatës në kohë, si dhe mungesën e zhvillimit të infrastrukturës në të njëjtin ritëm me urbanizimin e shpejtë, gjë që përbën risk për ndotje të mjedisit, përmytje dhe për shëndetin publik.

9. Gjetje nga auditimi:

Infrastruktura e rrjetit të kanalizimeve është e ndarë në disa nivele (primar, sekondar, terciar), por shumë pjesë të tij janë ndërtaur nga banorët dhe si të tilla nuk janë të dokumentuara. Aktualisht nuk ka një informacion të detajuar mbi numrin dhe menaxhimin e gropave septike që lidhen me lumin e Lanës. Lumi i Lanës ka rreth 85 pika shkarkimi që derdhen në të, shumica e të cilave ndodhet në segmentin e sistemuar, por pavarësisht kësaj, gjatë reshjeve të dendura, rrjeti i kanalizimeve nuk arrin të përballojë volumin e ujërave, duke shkaktuar përmytje në disa zona të kryeqytetit. Edhe pse ka një plan për përditësimin e rrjetit të kanalizimeve përmes sistemit GIS, përsëri nuk ka pasur investime të mjaftueshme deri tani dhe aktualisht nuk ka një inventar për pikat e trajtimit për ujërat e ndotura që derdhen në lumin e Lanës.

10. Gjetje nga auditimi:

a. Sipas planit të biznesit të Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a., miratuar nga Enti Rregullator i Ujit me Vendimin nr. 47, datë 07.11.2017, norma e arkëtimit është përcaktuar prej 92% deri në fund të vitit 2022. Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a. nuk ka arritur të përmbushë objektivat e miratuara të performancës për normën e arkëtimit të detyrimeve gjatë periudhës 2018 - 2022, sipas planit të biznesit të miratuar. Norma e arkëtimit të faturës korrente ka qenë ndjeshëm më e ulët (prej 62.98% në vitin 2022 deri në 65% për vitin 2024, referuar të dhënave të raportuara në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve). Edhe norma e arkëtimit të përgjithshëm për vitin 2023 dhe 2024 prej 87% dhe 89% është nën objektivat e miratuara të performancës. Mosrealizimi i objektivave të arkëtimit ndikon në qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të Shoqërisë së Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë, si dhe në mbulimin e kostove dhe programimin e investimeve për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, siç parashikohet nga VKM nr. 1304, datë 11.12.2019 dhe nga rregulloret përkatëse të Entit Rregullator të Ujit.

b. Strategjia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve 2023-2030 ka parashikuar rritjen e nivelit të arkëtimit të detyrimeve, duke synuar zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Bazuar në të dhënat e Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. për vitin 2023 dhe në Raportin e Audituesve Ligjorë për certifikimin e tyre (nr. prot. 1041/5, datë 02.07.2024), rezultoi një nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme të mbartura ndër vite. Më datën 31.12.2023, kjo vlerë bruto arrin në 6,329,607 mijë lekë, ku krahasuar më 31.12.2022 ka shënuar një rritje prej 297,690 mijë lekë (ose +4.9%). Ky nivel i detyrimeve të pambledhura përfaqëson rreth 30% të vlerës së aktiveve afatgjata materiale në datën 31.12.2023. Vlera e lartë e këtij treguesi shpreh mungesë të eficiencës në procesin e arkëtimit dhe ndikon në vështirësinë financiare të shoqërisë për shkak të mos marrjes së masave apo investimeve në përmirësimin e sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

11. Gjetje nga auditimi:

Objektivi i performancës për treguesin e “*ujit pa të ardhura*” referuar Planit të Biznesit të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. është nën 40% pas vitit 2022, kurse Enti Rregullator i Ujit vlerëson shoqëritë mbi kufirin 50% të ujit pa të ardhura si “*performancë e dobët*”.

Nga auditimi në Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. rezultoi se treguesi i ujit pa të ardhura është mbi 50% dhe konsiderohet mjaft i lartë e i papranueshëm. Indikatorit ka shënuar një rritje nga 59.8% në vitin 2022 në 61.83% në vitin 2024, si dhe është mbi nivelin kombëtar të tij prej 61.3%. Të dhënat e bilancit të ujit dhe pasaporta e indikatorëve të performancës për periudhën 2020–2024, për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, eidentojnë se prodhimi i ujit për frymë në ditë ka pësuar ulje nga 471.56 l/h/d në 460.76 l/h/d, ndërkohë që përqindja e lidhjeve të pajisura me ujëmatës është përmirësuar nga 88.47% në 91.18% dhe sasia e ujit të faturuar është ulur nga 162.35 l/h/d në 154.21 l/h/d.

Mospërputhja e ndjeshme ndërmjet sasisë së ujit të prodhuar, të matur dhe të faturuar në nivel sektori dhe në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, që reflekton një nivel të lartë të ujit pa të ardhura (UPA) dhe mangësi në menaxhimin e kërkesës për ujë, dëshmon për efikasitet të pamjaftueshëm në menaxhimin operacional të sistemeve të furnizimit me ujë nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., përfshirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e kontrollit.

Konkluzion 5:

Situata aktuale pasqyron mospërputhje mes zhvillimit urban dhe investimeve në infrastrukturën e kanalizimeve, duke rrezikuar objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmbushjen e të drejtave bazë të qytetarëve për shërbime bazike. Bazuar në sa më sipër, nuk është përgatitur inventari i shkarkimit të ujërave të ndotura dhe në përgjithësi statusi i cilësisë së ujit në lumin e Lanës nuk është vlerësuar në mënyrë të përshtatshme në qytetin e Tiranës. Rezultatet e të dhënave tregojnë një nevojë të madhe për investime për menaxhimin e qëndrueshëm të infrastrukturës “të padukshme” të kullimit të ujërave të ndotura në kryeqytet. Niveli i njohurive për gjendjen e sistemeve të kanalizimeve dhe infrastrukturës nëntokësore të banesave private është ende i ulët. Është e nevojshme që strategjitë e UK të miratuara, të zbatohen për të luftuar erozionin afatgjatë të aseteve të sistemit publik të kanalizimeve. Kjo kërkon që vendimmarrësve vendorë t’u ofrohet informacioni i domosdoshëm për këtë çështje.

Konkluzion 6:

UKT sh.a. kryen shërbimin e furnizimit me ujë, por nuk performon nën kufirin 30% të performancës së mirë për ujin pa të ardhura, pasi rezultoi me nivel të këtij indikatorit mbi kufirin 50%, duke u ekspozuar si *performancë e dobët*. Niveli i indikatorit të ujit pa të ardhura, referuar të dhënave të UKT sh.a. ka ardhur në përkeqësim, pasi nga niveli 59.8% në për vitin 2022 arrin në 61.83% për v.2024, duke tejkaluar treguesin mesatar të ujit pa të ardhura në shkallë sistemi prej 61.1%.

Këto tregues për UKT sh.a. janë dukshëm:

- larg mesatares së vendeve të Bashkimit Evropian (ku 25% e të gjithë sasisë së ujit të futur në rrjet, përfshihet në kategorinë e ujit pa të ardhura);
- më të larta se ato të vendeve të zhvilluara (të tilla si, Spanja 24%, Belgjika 21%, Kina 21%, Kanadaja 18%, Polonia 17%, Danimarka 7%, Gjermania 5%, etj.), si dhe
- përtej kufirit prej 40% të përcaktuar si pritshmëri duke filluar nga viti 2022, në bazë të Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU me nr. 47, datë 07.11.2017, për Qytetin e Tiranës.

8.1. Rekomandimi:

Bashkia Tiranë dhe Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. të bashkëpunojnë lidhur me planifikimin e fondeve dhe investimeve për zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në zonat e bardha (që nuk mbulohen me rrjet kanalizimi) dhe për përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve, bazuar në analizën e moshës së kanalizimeve dhe rrjetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Rekomandimi:

Bashkia Tiranë dhe Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. të marrin masa për përditësimin e informacionit, hartave dhe të dokumentacionit teknik mbi rrjetin e kanalizimeve, në përputhje me ndërtimet e reja dhe zhvillimet e qytetit. Në këtë kuadër të realizohet inventarizim i dekantuesve/gropave septike për të menaxhuar informacionin e domosdoshëm dhe monitoruar ndotjen.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1 Rekomandimi:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. të ndërmarrë masa për përmirësimin e nivelit të arkëtimit të të ardhurave nga shitja, si dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit, për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, nëpërmjet:

- Hartimit dhe zbatimit të një *plani operacional të përmirësimit të arkëtimit*, duke përfshirë rishikimin e procedurave të ndjekura për debitorët, forcimin e mekanizmave të ndjekjes ligjore për mos likuidimet në afat të faturës së ujit, dhe përdorimin e teknologjisë për menaxhimin e faturimit dhe pagesave;
- Rritjes së transparencës dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për performancën financiare në institucionet shtetërore (Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, Enti Rregullator i Ujit), për të garantuar vendimmarrje të bazuar në informacion të saktë e të rakorduar;
- Vlerësimi i strukturës aktuale tarifore dhe inicimi i rishikimit të saj pranë Entit Rregullator të Ujit, në përputhje me kostot reale të shërbimit dhe objektivat afatgjata të investimeve.

Në vijimësi

11.1 Rekomandimi:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. të analizojnë shkaqet e mospërmbushjes së objektivave të normës së arkëtimit dhe të merren masat për të rikthyer nivelin e performancës brenda standardeve të përcaktuara nga vendimet rregullatore. Në këtë kuadër, të punohet për hartimin dhe zbatimin e një plani operativ për reduktimin progresiv të stokut të llogarive të arkëtueshme, duke përfshirë masa për nxitjen e pagesave, procedura për ndjekje ligjore të debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.2 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse trajtimin e ujërave të ndotura urbane që gjenerohen në qytetin e Tiranës?

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime, Bashkia Tiranë dhe Ujësjetllës – Kanalizime Tiranë sh.a. nuk kanë arritur të sigurojnë trajtimin e ujërave të ndotura urbane që gjenerohen në qytetin e Tiranës.

Ujërat e ndotura urbane përfaqësojnë një presion të konsiderueshëm në mjedisin ujor, me efekte të mundshme të dëmshme, si kronike ashtu edhe akute në ekosistemin ujor, nga ngarkesa e lëndës

organike, lëndëve ushqyese, substancave të rrezikshme dhe nga grimcat e kudondodhura të mikroplastikës.

Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura janë jetësore për uljen e ndotjes në lumenj, liqene dhe ujëra bregdetare²⁸. Ato ndihmojnë në eliminimin e substancave të dëmshme si bakteret, viruset, azoti dhe fosfori. Trajtimi efektiv i ujërave të ndotura i shërben përmirësimit të shëndetit të njeriut dhe cilësisë së mjedisit. Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura është një strukturë industriale ku përdoret kombinimi i proceseve *mekanike, fizike, kimike dhe biologjike* për të arritur largimin e ndotësve nga ujërat e ndotura hyrëse dhe që përpunon ujërat e ndotura nga banesat, bizneset dhe industrinë, përpara se ato të shkarkohen përsëri në mjedis. Këto impiante largojnë papastërtitë dhe ndotësit, duke e bërë ujin të sigurt për ripërdorim ose shkarkim në ujëra.

★ Fact box nr. 3: Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane:

Ujërat e ndotura urbane të shkarkuara në mjedis mund të përmbajnë ndotës organikë, baktere, viruse, azot dhe fosfor. Prandaj, ujërat e ndotura urbane duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, trajtimi i ujërave të ndotura urbane rregullohet nga Direktiva 91/271/KEE në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura urbane (UWWTD).

Në përgjithësi, ujërat e ndotura duhet t'i nënshtrohen trajtimit sekondar (trajtimit biologjik)²⁹, i cili largon një përqindje shumë të lartë të ndotjes organike, baktereve dhe viruseve. Megjithatë, në zonat urbane që gjenerojnë më shumë se 10,000 p.e. ujëra të ndotura, duhet të aplikohet trajtim më i rreptë me heqje të mëtejshme të azotit dhe/ose fosforit. Heqja e azotit dhe/ose fosforit mbron ujërat e ndjeshme nga rreziku i lulëzimit të algave.

Të dhënat tregojnë se mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotura po përmirësohen në të gjithë kontinentin. Në vendet e BE-së, rreth 90% e ujërave të ndotura urbane mblidhen dhe trajtohen në përputhje me Direktivën e BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotura. Bazuar në profilet e vendeve, katër vende - Austria, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda - trajtojnë 100% të ujërave të tyre të ndotura urbane në përputhje me kërkesat e Direktivës, ndërsa 10 vende të tjera kanë arritur një shkallë përputhshmërie më shumë se 90%. Në anën tjetër të shkallës janë pesë vende - Irlanda, Bullgaria, Rumania, Kroacia dhe Malta - që përmbushin standardet në më pak se gjysmën e zonave të tyre urbane sipas të njëjtave standarde³⁰.

²⁸ WISE - Sistemi i Informacionit të Ujit për Evropën. Link: <https://water.europa.eu/freshwater/countries/uwwt>

²⁹ Eurostat dhe Enciklopedia Britannica raportojnë këto tre nivele të trajtimit që mund të pësojnë ujërat e zeza urbane në impiantet e trajtimit të ujërave si parësore, dytësore dhe terciare. **Trajtimi Parësor** konvencional i ujërave të zeza kryesisht heq lëndët e ngurta ose materialet që notojnë dhe përfshin proceset fizike të sitës, grimcimit, heqjes së zhavorrit dhe sedimentimit, etj. Trajtimi primar siguron ndarjen e ndotësve grimcorë (mbeturina, rërë, vajra, yndyra dhe mbetje grimcore), në veçanti, falë ndarjes gravitacionale në një rezervuar të madh sedimentimi. **Niveli i Dytë** trajton lëndët ushqyese, patogjenët dhe disa kimikate. Largimi zakonisht arrihet me anë të proceseve biologjike në të cilat mikrobet konsumojnë papastërtitë organike si ushqim, duke i shndërruar ato në dioksid karboni, ujë dhe energji për rritjen dhe riprodhimin e tyre. Ekzistojnë tre metoda themelore të trajtimit biologjik: filtri me pika, procesi i llumit të aktivizuar dhe pellgu i oksidimit. Një metodë e katërt, më pak e zakonshme, është kontaktuesi biologjik rrotullues. **Niveli Terciar** mund të përfshijë heqjen dhe dezinfektimin më intensiv të lëndëve ushqyese. Trajtimi terciar i ujërave të ndotura është faza e fundit dhe më e avancuar e trajtimit. Ai është projektuar për të hequr ndotësit e mbetur që proceset e trajtimit parësor dhe dytësor nuk arrijnë t'i eliminojnë, duke përfshirë lëndët ushqyese, patogjenët, metalet e rënda dhe lëndët e tjera të ngurta të pezulluara. Kjo fazë shpesh përfshin metoda të avancuara si filtrimi dhe dezinfektimi për të siguruar që uji i trajtuar përmbush standardet mjedisore përpara se të kalojë përsëri në mjedis. Komisioni Evropian ka propozuar një rishikim të Direktivës UWWT në tetor 2022 në përpjekje për të trajtuar mikro-ndotësit dhe mikroplastikët në ujërat e zeza duke futur standarde dhe kërkesa të reja monitorimi. Më konkretisht, propozimi prezanton një nivel **Trajtimi Kuaternar** për të eliminuar spektrin më të gjerë të mundshëm të mikro-ndotësve. Ky rishikim, tashmë afër miratimit, do të ndihmojë në reduktimin e shfaqjes së substancave shqetësuese në rrjedhjet nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.

³⁰ <https://water.europa.eu/freshwater/countries/uwwt>

Qyteti i Tiranës nuk ka një impiant funksional për trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

★ Fact box nr. 4: Mungesa e ITUN në Tiranë:

Qyteti i Tiranës, me mbi 800 mijë banorë dhe një nga shtatë qytetet më të mëdha në Gadishullin e Ballkanit, nuk ka asnjë trajtim të ujërave të ndotura urbane. Niveli i mbulimit nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane është 0%, në kundërshtim me kërkesat e Direktivës së BE-së 91/271/EEC që kërkon një mbulim minimal prej 85% për qytetet me më shumë se 10,000 banorë.

Procesi i trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura sipas ligjit “Për trajtimin e ujërave të ndotura”³¹ synon, ndër të tjera, trajtimin e ujërave të ndotura në një fazë të mëparshme, që të mos pengojë përpunimin dhe përdorimin e mëtejshëm të ujërave të ndotura, pakësimin sa më shumë të lëvizjes së lirë të ujërave të ndotura dhe trajtimin sa më pranë burimit dhe në impiantin më të afërt, si dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh. Ujërat urbane të kryeqytetit, ku sipas INSTAT-it jetojnë rreth 800 mijë banorë, vazhdojnë të derdhën në lumenj pa asnjë trajtim duke shndërruar Lumin e Tiranës dhe atë Lanës, sipas raporteve të institucioneve shtetërore, ndër zonat më të ndotura të vendit.

Punimet e impiantit të Kasharit, nisën 10 vite të shkuara, por institucionet shqiptare ndërprejnë në maj të vitit 2018 në mënyrë të njëanshme, kontratën e ndërtimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura të Tiranës me kompaninë që u përzgjedh në vitin 2014.

Raporti Përfundimtar i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm (Shkurt 2023), miratuar me VKM nr. 624, datë 08.11.2023, në komentarin për “*presionet kyçe, gjendjen ose ndikimin*” (Tabela nr. 2-1, faqe 40), ka pranuar situatën dhe ekzistencën e risqeve të tilla të rëndësishme të lidhura me shkarkimin dhe ndotjen e ujërave, si: mostrajtimi i ujërave të ndotura në Tiranë, në një zonë me intensitet të lartë të popullsisë dhe aktivitet industrial; degradimi dhe ndotja e lartë të lumenjve nga shkarkimet e pa trajtuara dhe pa u pajisur me leje për këto aktivitete, si dhe mosarritja e standardeve të nevojshme të cilësisë së mjedisit nga lejet e shkarkimit.

Raporti i Performancës për shoqëritë UK për vitin 2023³², hartuar nga ana e ERRU-së, arrin në përfundimin se mbulimi i shërbimit me KUN dhe ITUN do vijojnë të mbeten një sfidë për sektorin UK për t’u realizuar në të ardhmen duke pasur parasysh që është edhe një nga kërkesat që duhen plotësuar në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE si dhe në zhvillimin e turizmit sipas standardeve evropiane.

Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura urbane në Tiranë është në kontrast me qytetet e tjera të vendit.

Aktualisht ujërat e ndotura të qytetit të Tiranës shkarkohen në lumin e Lanës, pasi kryeqyteti vijon të jetë pa një impiant funksional. ITUN Kashar, parashikuar për të kryer një nivel trajtimi sekondar (për kapacitetin 350,000 p.e) për fazën e parë dhe terciar në nivelin përfundimtar të trajtimit³³ (për kapacitetin 681,680 p.e), është jashtë funksionit, duke regjistruar 0% trajtim të ujërave të ndotura. Kjo situatë e mos trajtimit të UN në kryeqytetin e vendit nga AKUK, Bashkia Tiranë dhe UKT sh.a., mbetet kritike dhe është në kontrast me mesataren në shkallë vendi të trajtimit të ujërave të ndotura. Nga raportet e AKM dhe AKU evidentohet ekzistenca e impianteve funksionale të TUN në disa qytete të vendit si në Lezhë, Pogradec, Durrës, Korçë, etj., kurse kryeqyteti, ende është i përjashtuar plotësisht nga ky sistem.

Strategjia Sektoriale e UK 2020-2023³⁴ sjell në vëmendje faktin se “rreth 54% e popullsisë së vendit jeton në qytete. Tri bashkitë më të mëdha (Tiranë, Durrës dhe Fier) përbëjnë gjysmën e popullsisë totale, ku 30% e popullsisë totale banon në Bashkinë e Tiranës. Tirana është një nga qytetet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe renditet e shtata me një popullsi rreth 800,000

³¹ Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”

³² ERU, Raporti i performancës për shoqëritë UK 2023, Tiranë 2024, faqe 52. Link: <https://erru.al/wp-content/uploads/2024/08/Raporti-i-Performances-ERRU-2023.pdf>

³³ Aneksi 2.13 “Tirana sha UK”, e raportit të SETEC and SWECO, faqe 30.

³⁴ Fletorja Zyrtare, Viti 2023, Nr. 115, faqe 14144

banorë”. Dokumenti “*Cilësia e ujërave sipërfaqësore në vendin tonë 2021*”³⁵, (Agjencia Kombëtare të Mjedisit, Tiranë 2022, faqe 51-55) ka analizuar situatën e 14 ITUN-eve në sistemin e kanalizimeve të vendit. Tirana, pavarësisht pozicionit të saj si qendra më e madhe urbane e vendit, nuk kontribuon në këtë përqindje, duke mbetur jashtë këtij sistemi thelbësor për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.

Si përfundim, mungesa e një ITUN-i aktiv në Tiranë përbën një rrezik mjedisor dhe shëndetësor, duke cenuar standardet evropiane për qytetet me mbi 10,000 banorë, që kërkojnë 85% mbulim. Prandaj, kjo e bën ndërtimin dhe funksionalizimin e ITUN-it në Tiranë një emergjencë kombëtare.

I. Kritere ligjore e rregullatore të brendshme:

○ Strategjia Kombëtare Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet për periudhën 2011-2017, miratuar me VKM nr. 643, datë 14.09.2011³⁶, ka përcaktuar politikat dhe masat për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit dhe përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit të BE-së për trajtimin e ujërave. Në dokument është nënvizuar se “*Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit gjatë periudhës 2006-2009 tregojnë një tendencë negative të cilësisë së ujit në disa lumenj që po dëmtohen shumë nga shkarkimet e ujërave të zeza nga familjet dhe bizneset. Nivelet e ndotjes organike janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në pellgun ujëmbledhës të lumit Ishëm (lumi i Lanës, Tiranës dhe Ishmit)*” (faqe 15).

○ Strategjia Kombëtare Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet për periudhën 2020-2030³⁷, është dokument i hartuar në vitin 2019 nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane (zbatuar përmes GIZ Albania), por që rezultoi i pa miratuar nga KM.

○ Strategjia Kombëtare Sektoriale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet për periudhën 2023-2030, është miratuar me VKM nr. 448, datë 26.07.2023 dhe shfuqizon VKM nr. 643, datë 14.09.2011. Në aneksin nr.2 “*Formatet e masave prioritare*” të Strategjisë, në lidhje me Projektin e Përmirësimit të sistemit të Kanalizimeve të ujërave të zëza për pjesën veriore të Tiranës së Madhe, (*Kashar SD Phase II Project*), është parashikuar (*cituar*): “*Periudha e ndërtimit për projektin Kashar Faza II pritet të jetë nga 2016 - 2021 (6 vjet), dhe projekti i zgjerimit është nga 2024 - 2026 (3 vjet)*. Impianti i trajtimit të ujërave të zeza (STP) për projektin Faza II nuk ka dhomë grithëse pasi ujërat e zeza pompohen nga Stacioni i Pompës së Kasharit.”

Nga auditimi evidentohet se dy strategjitë për Sistemin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet 2020-2030 dhe 2023-2023, përmbajnë projeksione apo nivele të ndryshme të trajtimit të UN-ve, që në shkallë vendi, projektohen si vijon;

• *Strategjia 2020-2030, faqe 17: “Sipas Njesisë së Monitorimit pranë AKUM, vetëm 10.45% e popullsisë urbane është e lidhur me impiant trajtimi të ujërave të ndotura, shifër e cila mbetet shumë e ulët ndërkohë në zonat rurale nuk ka mbulim me impiant të trajtimit të ujërave të ndotura. Këto nivele të mbulimit janë shumë mbrapa objektivit të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të UK 2011-2017, i cili synon të arrijë në 40% mbulimin e trajtimit të ujërave të ndotura deri në fund të vitit 2017”.*

• *Strategjia 2023-2030, në treguesit e Tabelës nr.3, “Objektivat strategjikë dhe indikatorët e performancës”, (FZ nr. 115/2023, fq. 14158), ka parashikuar që projeksionet për shërbimin e zgjerimit të numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane sipas viteve do të jetë përkatësisht: 14.4% për v.2021, 15% për v.2022, 15.5% për v.2023, 16% për v.2024, 16.5% për v.2025, 18% për v.2026 dhe 20% në vitin 2027, si në tabelë:*

³⁵ Agjencia Kombëtare të Mjedisit, Tiranë 2022, faqe 51-55

³⁶ Fletore Zyrtare Nr. 141, datë 17.10.2011

³⁷ link: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb214413.pdf>

Nr	Objektivat Strategjike / Indikatorët e vlerësueshëm me %	Viti Bazë 2021	Plani Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030	
1	Përshkrimi i qëllimit të politikës											
	Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit											
	1.1	Mbulimi me Ujesjellës (Niveli Kombëtar)	77.7%	78.3%	79.7%	80.8%	82.0%	83.5%	85.1%	87.7%	88%	90%
	1.2	Mbulimi me Ujesjellës për zonat urbane	92.0%	93.0%	94.0%	94.5%	95.0%	95.5%	96.0%	97.0%	98.0%	99.0%
	1.3	Mbulimi me Ujesjellës për zonat rurale	57.9%	58.0%	60.0%	62.0%	64.0%	67.0%	70.0%	75.0%	80.0%	85.0%
	1.4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	15	15.5	16	17	18	19	20	21	22.5	24
	1.5	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) në zonat urbane	16	17	18	19	20	21	22	23	24	24
	1.6	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë (orë/ditë) në zonat rurale	12	13	14	15	16	17	18	19	20	24
	1.7	Reduktimi i Ujit pa të Ardhura	65.4%	64.0%	63.0%	62.0%	60.0%	57.0%	52.0%	50.0%	48.0%	45.0%
	1.8	Niveli i matjes së konsumit të ujit shprehur në numër lidhesh	78.4%	80.0%	82.0%	85.0%	87.0%	90.0%	93.0%	95.0%	97.0%	100.0%
	1.9	Sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm për të gjitha shoqëritë rajonale UK	-	-	30%	50%	70%	90%	100%	100%	100%	100%
	1.10	Ngritja e Laboratoreve Rajonal për Cilësinë e Ujit të Pijshëm (15)	-	-	30%	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
1.11	Plane për Sigurinë e Ujit të përfunduara për të gjitha Shoqëritë UK	-	-	10%	20%	40%	60%	80%	90%	100%	100%	
2	Përshkrimi i qëllimit të politikës											
	Zgjerimi i numrit të konsumatorëve që kanë akses në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urban dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit											
	2.1	Mbulimi me Kanalizime (Niveli Kombëtar)	53.0%	53.5%	54.0%	54.5%	55.5%	56.8%	58.8%	60.8%	62.8%	65.5%
	2.2	Mbulimi me Kanalizime për zonat urbane	82.4%	83.0%	83.5%	84.0%	84.5%	85.0%	87.0%	89.0%	91.0%	93.0%
	2.3	Mbulimi me Kanalizime për zonat rurale	12.6%	13.0%	13.5%	14.0%	15.0%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
	2.4	Mbulimi me Trajtim të Ujrave të Dëndura nga ITUP	14.4%	15.0%	15.5%	16.0%	16.5%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
	2.5	Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	-	-	5.0%	10.0%	20.0%	30.0%	45.0%	60.0%	80.0%	100.0%

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 115/2023, fq. 14158

Këto objektiva sektoriale që evidentojnë tendencën negative të cilësisë së ujit dhe nivelet e ndotjes organike të rritur në mënyrë të konsiderueshme në pellgun ujëmbledhës të lumit Ishëm (lumi i Lanës, Tiranës dhe Ishmit) nuk janë zbërthyer në objektiva lokale të matshëm për qytetin e Tiranës.

II. Standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira/ benchmark:

Dokumenti i Bashkimit Evropian që ka përcaktuar nivelin e trajtimit të ujërave të ndotura mbi 85% për qytetet me më shumë se 10,000 banorë është Direktiva e BE-së për Ujërat e Ndotura (Directive 91/271/EEC). Direktiva 91/271/EEC e Këshillit Evropian, miratuar më 21 maj 1991, normon trajtimin e ujërave të ndotura në shtetet anëtare të BE-së dhe ka si qëllim të përmirësojë cilësinë e ujërave të brendshme, të parandalojë ndotjen e ujërave nëpërmjet trajtimit dhe garantojë mbrojtjen e mjedisit dhe të resurseve hidrike të BE-së.

Pikat kyçe të direktivës:

1. Qytetet dhe aglomeratet³⁸ me më shumë se 10,000 banorë duhet të sigurojnë trajtimin e ujërave të ndotura përmes impianteve të trajtimit të ujërave.
2. Trajtimi i ujërave duhet të përfshijë një nivel minimum 85%³⁹ të trajtimit biologjik të ujërave të ndotura, për të përmirësuar cilësinë e ujit dhe për të reduktuar ndikimin në mjedis.

³⁸ **Aglomeratet** janë grumbullime të popullsisë, shpesh të përqendruara në një zonë të caktuar urbane ose periferike. Në kontekstin e Direktivës 91/271/EEC për trajtimin e ujërave të ndotura, termi "agglomerate" përdoret për të përshkruar një zonë urbane që ka një densitet të lartë popullsie dhe një infrastrukturë të ndërlidhur për menaxhimin e ujërave të ndotura. Në këtë rast, aglomerata janë ato qytete dhe qyteza që kanë më shumë se 2,000 banorë dhe që janë të detyruara të kenë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. *Agglomerata sipas Direktivës për Trajtimin e Ujrave të Ndotura:*

- Aglomeratat më të mëdha (*me mbi 10,000 banorë*) kërkojnë një nivel trajtimi të ujërave të ndotura më të avancuar, duke përfshirë trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në një shkallë prej të paktën 85%.
- Aglomeratat më të vogla (*nga 2,000 deri në 10,000 banorë*) kanë kërkesa të ndryshme për trajtimin e ujërave të ndotura, por gjithashtu duhet të sigurojnë trajtim minimal dhe ndihmojnë në mbrojtjen e cilësisë së ujërave.

³⁹ - *Official Journal of the European Communities*, No L 135/44, (Table 2: Requirements for discharges from urban wastewater treatment plants to sensitive areas which are subject to eutrophication as identified in Annex IL A (a). One or both parameters may be applied depending on the local situation. The values for concentration or for the percentage of reduction shall apply),

3. Për qytetet me më shumë se 2,000 banorë, është kërkuar gjithashtu trajtim minimal, ndonëse kërkesat specifike mund të ndryshojnë në varësi të kushteve lokale.

Për qytetet me mbi 10,000 banorë, kërkohet që përveç trajtimit të ujërave të ndotura, të jetë i detyruar gjithashtu edhe monitorimi dhe menaxhimi i këtyre ujërave, për të siguruar që cilësia e ujërave të trajtuara të përputhet me standardet e kërkuara.

Problematika të lidhura me PMBU Ishëm dhe nevoja e përmirësimit të situatës së lumit të Lanës.

Në rekomandimet e PMBU Ishëm, ku bën pjesë edhe lumi Lana, problematika kryesore lidhet me mungesën e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, i cili është një investim i nevojshëm për përmirësimin e situatës dhe statusin e trupave ujqor, si pjesë edhe e programit të masave për trupat ujqor të lumit Lana, në kushtet kur ky lum është një kolektor i shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane. Mungesa e fondeve mbetet një sfidë kryesore edhe për institucionet e përfshira në menaxhimin e integruar të burimeve ujqore. Ky fakt evidentohet edhe në Strategjinë UK 2023-2030, (FZ nr.115/2023, fq. 14149), kur nënvizohet se “pavarësisht investimeve për ndërtimin e impianteve për trajtim të ujërave të ndotura vijon të ketë nevoja të mëdha për investime në të ardhmen”. Tabela 13-9 “Përmbledhëse për kosto dhe fondet e masave për ujërat sipërfaqësorë”⁴⁰ e PMBU Ishëm, ka parashikuar që për përputhjen me kërkesat e Direktivës së Ujërave të Ndotura urbane (EU/91/271/ KEE) dhe Direktivës Kudër të Ujit (2000/60/KE), kostot kapitale ose të instalimit për përfundimin e ndërtimit dhe vënien në punë të ITUN Kashar (me autoritete zbatuese AKUM/MIE dhe Bashkia e Tiranës) janë përllogaritur në 10,653 milionë lekë.

Trajtimi i ujërave të ndotura në kryeqytetet kryesore të Evropës.

Kryeqytetet evropiane në përgjithësi kanë sisteme të zhvilluara të trajtimit të ujërave të ndotura, duke përfshirë impiante të mëdha të projektuara për të trajtuar vëllimin e ujërave të ndotura të gjeneruara nga zonat urbane. Këto impiante zakonisht synojnë të arrijnë të paktën trajtim sekondar, dhe në disa raste, trajtim më të rreptë për ujëmbledhësit, duke synuar mbrojtjen e mjedisit nga ndotja.

Londra	Beckton Sewage Works është impianti më i madh i ujërave të zeza në Evropë, që trajton ujërat e ndotura urbane të mbi 3.5 milionë njerëzve, kjo sipas Institutit të Inxhinierisë Civile (ICE) ⁴¹ .
Beogradi	Ka sisteme të shumta të pavarura të kanalizimeve, përfshirë një në periferinë veriore të Batajnicsë, ku po ndërtohet një impiant i ri për trajtimin e ujërave të zeza, sipas Balkan Green Energy News ⁴² .
Shkupi	Një impiant i ri për përpunimin e ujërave të zeza po ndërtohet në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë teknologji të përparuar dhe praktika me efikasitet energjetik për të përmirësuar cilësinë e ujit, sipas Bankës Evropiane të Investimeve ⁴³ .
Amsterdami, Athina, Berlini, Madridi, Roma, Parisi dhe Stokholmi	Një studim i realizuar nga Zyra Ndërkombëtare e Ujit në Francë (Oieau) ka evidentuar shërbimet e trajtimit të ujërave të ndotura të këtyre tetë kryeqyteteve evropiane, duke nxjerrë në pah kontekstet e tyre përkatëse ⁴⁴ .

link: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:31991L0271>

⁴⁰ -AMBU, PMBU Ishëm për basenin e Lumit Ishëm 2024-2029, Raporti Kryesor, faqe 13-40

⁴¹ <https://www.ice.org.uk/what-is-civil-engineering/infrastructure-projects/beckton-sewage-works#:~:text=Beckton's%20sewage%20works%20were%20part,more%20than%203.5%20million%20people>

⁴² <https://balkangreenenergynews.com/preparation-begins-construction-wastewater-treatment-facility-belgrade/#:~:text=%20Batajnica%2C%20a%20Belgrade's%20northern%20suburb,%20%2C%20Krnja%2C%20and%20Bole%2C%20E2%80%93Vin%2C%20Da>

⁴³ <https://www.eib.org/en/stories/wastewater-north-macedonia#:~:text=Once%20constructed%20in%20the%20municipality,EIB%20Representative%20for%20North%20Macedonia>

⁴⁴ https://www.oieau.fr/audoc/system/files/documents/41/207795/207795_doc.pdf

Parisi	Në fund të Luftës së Parë Botërore, 50 km fusha të ujërave të zeza nuk ishin më të mjaftueshme për të mbrojtur Senën. Një program i përgjithshëm për trajtimin e ujërave të zeza, i projektuar për të përmbushur nevojat për 50 vjet, u hartua dhe u miratua nga shteti në vitin 1935. Parisi ka një rrjet impiantesh për trajtimin e ujërave të ndotura, duke përfshirë Seine Aval të SIAAP në Achères, i cili është vendi më i madh i trajtimit në Evropë. SIAAP, Autoriteti Sanitar i Parisit të Madh, menaxhon një pjesë të madhe të trajtimit të ujërave të ndotura në rajon, duke përfshirë impiantin Seine Aval ⁴⁵ .
Bukureshti	Pasi impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane (UWWTP) filloi të funksionojë në vitin 2011, përqendrimet e treguesve të ndotjes organike dhe lëndëve ushqyese u ulën ndjeshëm (2011-2015; EEA, 2016d) ⁴⁶ .
Moska	Ka katër prej këtyre impianteve të ujërave të ndotura: Rublevskaya, Zapadnaya, Severnaya dhe Vostochnaya. Ato mund të prodhojnë së bashku mbi gjashtë milionë metra kub ujë të pastër në ditë. Uji nga lumenjtë dhe rezervuarët mbetet këtu nga 8 deri në 24 orë. Gati 64% e ujit të qytetit pastrohet duke përdorur filtrimin e ozonit, thithjen e ozonit dhe filtrimin membranor ⁴⁷ .
Berlini	Impiantet e ujërave në këtë kryeqytet janë jashtëzakonisht të ngarkuara. Çdo ditë, ato trajtojnë rreth 680,000 metra kub ujëra shiu dhe ujëra të zeza nga industria, familjet dhe institucionet publike (që nga viti 2022) ⁴⁸
Athina	Impianti kryesor i trajtimit të ujërave të ndotura që i shërben zonës metropolitane të Athinës është ITUN i Psytthias, në ishullin e Psytthias në Gjirin Saronik. Psytthia është një nga impiantet më të mëdha të trajtimit të ujërave të ndotura në Evropë dhe në botë, me një kapacitet trajtues për 5.6 milionë banorë. Një tjetër impiant, IMP Metamorfofis, është i aftë të marrë dhe trajtojë ujërat e zeza septike nga zonat pa një sistem formal kanalizimesh. Kapaciteti i tij i projektuar është 24,000 m ³ /ditë ujëra të zeza septike dhe 20,000 m ³ /ditë ujëra të zeza komunale ⁴⁹

Krahasimi me vendet e rajonit.

Ujërat e papërpunuara komunale dhe industriale janë burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në Republikën e Serbisë. Në Serbi, vetëm **5-10%** e ujërave të ndotur përpunohet. Sidomos problematik është territori i Beogradit me mbi dy milionë banorë, që ende nuk ka impiante për pastrimin e ujërave të ndotura komunale që rrjedhin në Danub (CEDF, 2015). Në Bosnjë-Hercegovinë, një numër i vogël njerëzish janë të përfshirë në trajtimin e ujërave të ndotur (vlerësohet se në Bosnjë Hercegovinë janë **3%** dhe në Republikën Sërpska janë më pak se **1.43%** të popullsisë). Ka gjithsej shtatë impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura, të vendosura në territorin e Bosnjë Hercegovinës (Raporti Menaxhimi i Burimeve Ujore në Maqedoni, Shkup, 2017).

Kosova dhe ecuria e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

Kosova ende nuk e ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura, meqenëse ndodhet në fazën e ndërtimit të këtyre impianteve. Sipas të dhënave nga ARRU, shërbimi për grumbullimin e ujërave të ndotura brenda zonës së shërbimit të KRU-së gjatë vitit 2022, është ofruar për 65% të popullsisë⁵⁰. Deri më sot, në Kosovë janë trajtuar më pak se **1%** e ujërave të ndotura të kanalizimit. Sipas një raporti të KDI-së, nga 326 projekte të planifikuara nga institucionet publike për ndërtimin e kanalizimeve, të cilat derdhen në lumenjtë e Kosovës, gjatë periudhës 2017-2019 kishin

⁴⁵ <https://www.siaap.fr/>

⁴⁶ - EEA Report No 7/2018, Table 6.1 Examples of measures to reduce point source discharges, punimi: European waters — Assessment of status and pressures 2018, faqe 67

⁴⁷ <https://www.mos.ru/en/news/item/30936073/>

⁴⁸ <https://www.berlin.de/umweltatlas/en/water/rain-and-waste-water/>

⁴⁹ <https://www.eydap.gr/userfiles/c3c4382d-a658-4d79-b9e2-ecff7ddd9b76/Fact-sheet-PWWTP.pdf>

⁵⁰ <https://www.ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20menaxhimit%20t%C3%AB%20mbeturinave%20komunale%20per%20viten%202022-i%20lektoruar.pdf>

kontraktuar vetëm 8 prej tyre”⁵¹. “Ujërat urbane shkarkohen akoma në ujërat e lumenjve si të pa trajtuara. Ujërat urbane të pa trajtuara vlerësohen së janë mbi 35 - 40 milion m³. Trajtimi i ujërave urbane është i nivelit të ulët. Kosova përpos impiantit për trajtim të ujërave urbane në Skenderaj, në Gjakovë, një mini-impianiti në Batllavë dhe ai për trajtim biologjik në Halilaq, akoma nuk ka investime në këtë sektor⁵².

Raportet e BE-së:

Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza janë çelësi për reduktimin e presioneve dhe rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, veçanërisht për lumenjtë, liqenet dhe ujërat bregdetare. Komisioni Evropian dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit publikuan të dhëna të reja që tregojnë se **mbi 90% e ujërave të zeza urbane të Evropës mbliidhen dhe trajtohen në përputhje me standardet e BE-së**⁵³.

Raportet e Rregullatorit Evropian të Ujit:

Sipas Rregullatorit Evropian të Ujit (WAREG - European Water Regulators)⁵⁴, në katër vendet e Ballkanit Perëndimor, pra në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut, sektori i ujit ka disa aspekte të përbashkëta, si (i) mungesa e menaxhimit të duhur të ujërave të zeza (shkalla e ulët e trajtimit të ujërave të zeza, me rreth 20% të ujërave të zeza që trajtohen në rajon), (ii) plakja e aseteve pa planifikim adekuat për rinovimin e tyre, (iii) nevoja për mjete të fuqishme financimi për të mbuluar shpenzimet e mëdha kapitale për infrastrukturën e reja, etj.

Vlerësimet e Komisionit Evropian për vitin 2024:

Komisioni Evropian në dokumentin e vlerësimeve të publikuara në Maj 2024, të titulluar “12th Technical Assessment of UWWTD Implementation EU Report – Final Version”⁵⁵, në Kreun III, paragrafi 2.5 ka trajtuar “Llojet e impianteve të trajtimit dhe kapaciteti i tyre total i projektimit në BE dhe numri i secilit lloj për shtetet anëtare”. Duhet theksuar se **21%** e kësaj ngarkese i nënshtrohet trajtimit më të rreptë, ndërsa Direktiva kërkon vetëm trajtim dytësor në këto raste. Vetëm **Kroacia** ka ende një numër të konsiderueshëm të impianteve të trajtimit që aplikojnë vetëm trajtim parësor (52%). Në **tre vende (Rumani, Portugali dhe Letonia)**, më shumë se 52% e impianteve të trajtimit aplikojnë trajtim dytësor, me përqindjen më të lartë në Letoni. Ndër **trembëdhjetë vendet e mbetura**, aplikojnë trajtim më të rreptë në më shumë se 94% të impianteve të tyre të trajtimit, dhe pjesa tjetër zbatohet ndërmjet 59% dhe 90%, që janë norma të larta.

Raportet e Federatës Evropiane të Shoqatave Kombëtare të Shërbimeve të Ujit (EurEau) dhe Agjencisë Evropiane të Mjedisit EMA:

EurEau⁵⁶ ka nënvizuar se “kur bëhet fjalë për nivelin e trajtimit të ujërave të zeza, në të gjithë Evropën gjithsej, 3.1 për qind e ngarkesës trajtohet në nivel parësor, 28.5 për qind në nivel dytësor dhe 68.4 për qind në nivel terciar”. Sipas raportit, edhe pse trajtimi terciar nuk është përcaktuar në Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane (UWWTD), ai shpesh përdoret për “trajtim më të rreptë se trajtimi dytësor”. Referuar analizës së të dhënave nga ana e Agjencisë Evropiane të

⁵¹ - Klan Kosova, “Në Prizren filloi operimin impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, i pari në Kosovë”, datë 03.11.2021. Link: <https://klankosova.tv/ne-prizren-filloi-operimin-impianiti-per-trajtimin-e-ujerave-te-ndotura-urbane-i-pari-ne-kosove/>

⁵² - “Gjendja e ujërave në Kosovë 2020”, botim i Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, v.2021, faqe 80

⁵³ - https://environment.ec.europa.eu/news/treating-urban-waste-water-new-data-shows-improvement-across-europe-2021-11-19_en, Treating urban waste water: new data shows improvement across Europe

⁵⁴ <https://www.wareg.org/articles/water-sector-challenges-in-the-western-balkans/>

⁵⁵ <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/4c97f846-44b2-11ef-865a-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-334392299>, përgatitur nga Benoît Fribourg-Blanc, Nicolas Dhuygelaere, Jean Marc Berland, François-Xavier Imbert),

⁵⁶ Burimi: EurEau, “Europe’s Water in Figures - An overview of the European drinking water and waste water sectors” 2021 edition.

Mjedisit (EMA), del se popullsia e lidhur me trajtimin e ujërave të zeza të paktën në nivelin sekondar në BE-27, për periudhën 2000-2022⁵⁷ ka ardhur në rritje. Që nga viti 2000, përqindja e popullsisë së BE-së e lidhur me trajtimin e ujërave të zeza është rritur në mënyrë të qëndrueshme, **ku 81% e popullsisë është lidhur me të paktën trajtimin dytësor të ujërave të zeza në vitin 2022.**

Përqindja e njerëzve të lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të zeza në vendet e përzgjedhura të Evropës, në vitin 2021⁵⁸:

Përqindja e njerëzve në Evropë të lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të zeza ndryshon në mënyrë të konsiderueshme sipas vendeve për vitin 2021. Përqindja ndryshon në mënyrë drastike në pjesët lindore të Evropës, ku shkalla e lidhjes mund të bjerë nën 50 për qind. ***Për shembull, vetëm 16 për qind e popullsisë serbe ishte e lidhur me një impiant për trajtimin e ujërave të zeza në vitin 2021, Shqipëria 26.5%, Bosnje Hercegovina 36%, Rumania 58,3%, Turqia 74.04%, Lituania 79,7%, Hungaria 83.2%, Çekia 84.7%, Spanja 89.2%, Bullgaria 90.4%, Greqia dhe Irlanda nga 94.7%, etj.*** Profilet e vendeve përmbajnë harta interaktive me impiantet e trajtimit të ujërave të zeza në të gjithë Evropën. Në të gjithë BE-në, rreth 90% e ujërave të zeza urbane mblihen dhe trajtohen në përputhje me Direktivën e BE-së për trajtimin e ujërave të zeza. Bazuar në profilet e vendeve, ***katër vende⁵⁹ – Austria, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda – trajtojnë 100% të ujërave të ndotura urbane në përputhje me kërkesat e Direktivës, ndërsa 10 vende të tjera kanë arritur normën e pajtueshmërisë mbi 90%. Në anën tjetër të shkallës janë pesë vende – Irlanda, Bullgaria, Rumania, Hungaria dhe Malta – që përputhen në më pak se gjysmën e zonave të tyre urbane sipas të njëjtave standarde.***

Dokumenti i OECD “Multi-dimensional review of the Western Balkans” viti 2021, faqe 92:

Trajtimi joadekuat i ujërave të zeza është burim kryesor i ndotjes së ambientit dhe e ujit në të gjithë ekonominë e Ballkanit Perëndimor. Shërbimet e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza janë të pakta: 31% e popullsia e Bosnjës dhe Hercegovinës është e lidhur me sistemin e kanalizimit publik, dhe vetëm 15% e ujërat e zeza trajtohen. Vetëm 1% e popullsisë së Kosovës është e lidhur në një impiant për trajtimin e ujërave të zeza, edhe pse tre impiante të reja janë në zhvillim.

Kapaciteti i projektuar i ITUN Kashar nuk garanton zgjidhjen përfundimtare të problemit të trajtimit të UN për të gjithë popullsinë e Tiranës.

Nga shqyrtimi i informacioneve të vendosura në dispozicion nga ana e AKUK, mbi ITUN Kashar, evidentohet se objekti i projektit përfshin dy faza ndërtimi për trajtimin e ujërave të zeza. Megjithatë, kredia ekzistuese mbulon vetëm objektin e projektit për fazën e parë të tij.

Tabela nr. 20: Fazat e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura Kashar

Faza e parë				
Vendndodhja		Kashar, Tiranë		
Popullsia e shërbyer deri në 2018		342,500 persona		
Branch sewer		km	27.6	200 mm in Dia.
Main sewer		km	1.4	200 - 600 mm in Dia.
Trunk sewer		km	4.2	900 -1,500 mm in Dia.
Seçage Treatment Plant (STP)	at Kashar site	No.	1	Ave. Floë 77,100 m3/day Max. Floë 95,900 m3/day
Faza e dytë				
Vendndodhja		Kashar, Tiranë		
Popullsia e shërbyer deri në 2022		830,500 persona		
Branch sewer		km	27.6	200 mm in Dia.
Main sewer		km	47.6	200 - 600 mm in Dia.

⁵⁷ <https://www.eea.europa.eu/en>

⁵⁸ Burimi ”Statista”, link: <https://www.statista.com/statistics/1393560/europe-percentage-people-connected-wastewater-plants-by-country/>

⁵⁹ -https://commission.europa.eu/energy-climate-change-environment_en

Trunk sewer		km	10.4	450 -1,650 mm in Dia.
Pumping Station	Kashar STP	No.	1	257,400 m ³ /day
Expansion of STP	at Kashar site	No.	1	Ave. Floë 207,600 m ³ /day Max. Floë 257,400 m ³ /day

Burimi: AKUK

Për sa i përket fazës së parë të projektit, nëpërmjet këtij investimi AKUK ka synuar pastrimin e ujërave në lumenjtë e Tiranës (lumi Lanë dhe lumi i Tiranës) dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Tiranës. Në funksion të këtyre objektivave, projekti ka parashikuar ndërtimin e veprave dhe rrjeteve të kanalizimeve si më poshtë:

1. Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura ITUN me vendndodhje në Kashar dhe me kapacitet përpunues mesatarisht prej 77,100 m³/ditë. Impianti është përlllogaritur të plotësojë nevojat e qytetit të Tiranës për një popullsi prej rreth 342,000 banorësh;
2. Ndërtimi i kolektorit kryesor për transportimin e ujërave të ndotura nga kryqëzimi te Pallati me Shigjeta, deri në ITUN (mikrotunel (DIM 900 – 1,500 mm), gjatësia 4.2 km);
3. “Neë South Interceptor” (kolektori kryesor i kanalizimeve të ujërave të ndotura, që grumbullon zonën Jugore të Tiranës).

Për sa i përket fazës së dytë të projektit, është parashikuar në Master Planin e kanalizimeve të Tiranës, por ende nuk ka një projekt fizibiliteti për këtë fazë.

Në vijim të VKM nr. 760, datë 20.12.2023, për miratimin e afatit të disbursimit të fondeve për Marrëveshjen e Huas, e cila ka bërë efektive fondet e mbetura nga kredia deri në Tetor 2026 dhe më pas VKM Nr. 716, datë 20.11.2024 për miratimin në parim të ndryshimit në Marrëveshjen e Huas për rialokimin e fondeve për shërbimin e konsulencës, AKUK ka filluar procedurën për prokurimin e Konsulentit të ri të projektit, i cili në bazë të termave të referencës, në fazën e parë të shërbimit të konsulencës do të bëjë të mundur **rishikimin në tërësi të projektit**, duke përfshirë edhe ndërtimin e Kolektorit të Ri të Jugut (New South Interceptor), nga Ura e Shkozës deri tek Pallati me Shigjeta.

A1. AKUK ka raportuar se Short-lista e Projektit të investimeve për Wastewater (ujerat e zeza) me Kod Projekti WW111 dhe emërtim “*Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura në UK Tiranë - Faza I*”, ka parashikuar si vit fillimi vitin 2023 dhe përfundimin në vitin 2030, me kosto totale prej 127.15 Milionë Euro, e cila përfshin:

- Zgjerim të kanalizimeve në 2 aglomerate (Tiranë; Farkë e Madhe) me një gjatësi të parashikuar prej 130.8 km; Rehabilitim të kanalizimeve në 6 aglomerate (Tiranë; Farkë e Madhe; Ferraj; Prush; Krrabë; Ndroq) me një gjatësi të vlerësuar prej 107.7 km; Projektim dhe ndërtim të një ITUN-i të ri në Tiranë/Kamzë me kapacitet 96991 PE⁶⁰ dhe nivel trajtimi terciar. Për më tepër, projekti përfshin projektimin dhe ndërtimin e impianteve të tharjes diellore (përfshirë mekanizimin e trajtimit të llumit) me një kapacitet vjetor prej 1500 tDS/vit dhe kapacitet shtesë depozitimi për rreth 500 m³ llum të thatë; Përfundimi i ndërtimit të PPU në Farkë të Madhe me kapacitet 6000 PE dhe nivel trajtimi terciar; Projektimi dhe ndërtimi i 1 kolektorëve / përgjuesve (Kamza) me një gjatësi të parashikuar prej 2.1 km.
- Përfundim i ndërtimit të ITUN në Tiranë me kapacitet 350,000 PE dhe nivel trajtimi dytësor. Për më tepër, projekti përfshin projektimin dhe ndërtimin e objekteve të tharjes diellore (përfshirë mekanizimin e trajtimit të llumit) me një kapacitet vjetor prej 5,000 tDS/vit dhe kapacitet shtesë depozitimi për llumin e thatë prej rreth 2,100 m³.

A2. Referuar të dhënave të Raportit të Bankës Botërore, përgatitur në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Këshillin Kombëtar të Ujit, me titull “*Water for people- Financial Policy and implementation measures*”⁶¹, hartuar në Nëntor 2016, (Aneksi D “Calculaion of coping costs”, paragrafi D1 ”Coping costs-urban”/ Përballimi i kostove-urbane,

⁶⁰ p.e.= popullsi ekuivalente, (inkonterm që i referohet Direktivës 91/271/KEE për trajtimin e ujërave të ndotura.

⁶¹ link: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/413501546837905191/pdf/Sector-Financing-Policy-Report.pdf>

faqe 83), për efekt të llogaritjes së kostos për m³, është marrë madhësia familjare urbane e ngjashme me mesataren e Shqipërisë (3.6 për urban) dhe një konsum uji prej 36 m³ për person në vit.

A3. Bazuar në të dhënat e “Raportit të Gjendjes në Mjedis 2022”⁶², hartuar nga AKM (Tiranë 2023, faqe 276), në lidhje me projektin e ITUN Kashar, popullsia ekuivalente sipas projektit është 335,680 banorë, kurse kapacitetit trajtuesi i projektit është 75,843 m³ /ditë. Pra, këtu numri i popullsisë totale që sipas AKM-së, i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura për banorë është më i ulët se treguesi i raportuar nga AKUK.

A4. Popullsia e qytetit të Tiranës, mbështetur në të dhënat e Tabelës nr. 7 “Popullsia banuese sipas bashkisë, gjinisë dhe grup moshat kryesore”, të dokumentit “Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023- Rezultatet kryesore”⁶³, (Tiranë, Janar 2024, faqe 67), rezultoi me 598,176 banorë. Nga ana tjetër, mbështetur në raportin e ERRU “Analiza e humbjeve të ujit për vitin 2022”, për shoqërinë aksionare UK Tiranë, (Tiranë 2023, faqe 3), popullsia e regjistruar në zonën e shërbimit është 801,707 persona⁶⁴.

Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit Londër ka vendosur se ndërprerja e njëanshme e kontratës nga AKUK dhe MIE me kompaninë “C.D. & K.” për ndërtimin e ITUN Kashar është kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ka sjellë pasoja financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit (prej 13.5 milionë Euro).

Projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, është financuar përmes Marrëveshjes së Huasë Nr.ABA-P3 (datë 30 qershor 2008), lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, (zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar - JICA, në tetor 2008) dhe ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008. Objektivi kryesor i projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe” është pastrimi i ujërave në lumenjtë e Tiranës (lumi i Lanës dhe lumi i Tiranës) dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve të Tiranës.

Pas ndjekjes së hapave proceduralë të nevojshëm, në përputhje me parashikimet dhe programin në marrëveshje fillestare dhe me miratimin nga financuesi të procedurave dhe akteve respektive (për punimet dhe shërbimin e konsulencës/ supervizimit), janë nënshkruar këto kontrata:

1. **Kontrata e Konsulencës** me vlerë JPY 1,555,999,618 me kontraktor Joint Venture “T.E.C. & E.C.”, nënshkruar në 19 Tetor 2009 dhe bërë efektive në datën 18.02.2010.
2. **Kontrata e zbatimit të punimeve** me vlerë JPY 8,168,997,959 me Kontraktor Joint Venture “C. D. S.p.A and K.C.”, nënshkruar në 30 Janar 2014.

Punimet për realizimin e projektit kanë filluar zyrtarisht më datën 16 Qershor 2014 me afat fillestar për përfundimin e tyre prej 30 muajsh nga momenti i fillimit të punimeve, (deri më 16 Dhjetor 2016).

Si rezultat i dy shtyrjeve të dakordësuara ndërmjet AKUK dhe Kontraktorit, të miratuara nga financuesi JICA, afati i përfundimit të punimeve ka ndryshuar në 52 muaj nga data e fillimit të punimeve, (pra deri më datën 16 Tetor 2018).

Referuar Raportit të KLSH-së, Tetor 2019, të ushtruar në AKUMK, “Në datën 30.01.2014, është nënshkruar kontrata për përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe me kontraktorin “D.& K.C.” me vlerën rreth 81,000,000 Euro. Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze dhe është ratifikuar në Kuvend me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008. Kjo kontratë është ndërprerë në datën 04.07.2018 dhe deri në këtë datë, punimet ishin kryer rreth 70% ose në vlerën 56 Milion Euro. Ndërprerja (zgjidhja) e kësaj kontratë është bërë në mënyrë të njëanshme nga MIE nëpërmjet

⁶² link: https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2022/

⁶³ link: <https://www.instat.gov.al/media/13581/cens-i-popullsisë-2023.pdf>

⁶⁴ ERRU, “Analiza e humbjeve të ujit për vitin 2022”, sha UK Tiranë, Tiranë 2023, faqe 3.

AKUKM në kundërshtim me marrëveshjen e financimit dhe me kushtet e kontratës së lidhur me kontraktorin. MIE dhe AKUKM për zgjidhjen e kontratës nuk ka marrë miratim paraprak nga financuesi Banka Japoneze për Zhvillim “JICA” dhe nuk ka marrë parasysh sugjerimet dhe vërejtjet që i ka bërë Këshilli i Mosmarrëveshjeve, që kanë të bëjnë kryesisht për: mungesën të hapësirave për të kryer punimet; mungesën apo vonesa të tejzgatuara të pagesave në vlera bllokuesve ndaj kontraktorit si, vonesa në likuidim të TVSH dhe pagesat e situacioneve; mungesa apo vonesa të theksuar bashkëpunimi në lidhje me marrjet e lejeve, miratimet e punimeve, etj.; probleme të hasura gjatë zbatimit me projektin dhe mungesa e gatishmërisë për korrigjimin apo përmirësimin e tij, etj. Për prishjen e kësaj kontrate në kundërshtim me marrëveshjen e financimit dhe me kushtet e kontratës, kontraktori ka hapur çështje në gjykatën pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Londër. Duke marrë në konsideratë paligjshmërinë e zgjidhjes në mënyrë të njëanshme të kontratës ka shumë gjasa që kontraktori këtë çështje ta fitojë dhe buxheti i shtetit do të paguaj një shumë të konsiderueshme...”⁶⁵.

Me shkresën nr. 2004 prot., datë 04.07.2018, Drejtori i Përgjithshëm i AKUKM (sot AKUK), ka njoftuar Kontraktorin për ndërprerjen e kësaj kontrate, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, komunikuar me shkresën nr. 1225/11 prot., datë 31/05/2019, ku është urdhëruar, si më poshtë: “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUKM), brenda muajit qershor 2018, bazuar në vlerësimin e Supervisorit dhe në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të fillojë procedurat për ndërprerjen e kontratës me Kontraktorin”. Urdhërimi i ndërprerjes së kësaj kontrate është në vijim të zbatimit të masave organizative, të lëna nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të kësaj Ministrie, si rezultat i një auditimi të kryer gjatë periudhës 03.11.2017 deri 30.01.2018 në AKUKM për këtë projekt.

Çështja e ndërprerjes (zgjidhjes) në mënyrë të njëanshme të kësaj kontrate të zbatimit të punimeve nga AKUKM me kontraktorin e punimeve, është shqyrtuar dhe zgjidhur nga një forum i Arbitrazhit Ndërkombëtar. Kontraktori JV “D. & K.” në cilësinë e palës Paditëse ka depozituar kërkesën e tij për arbitrazh pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Londër sipas pikës 20.6 të kontratës, me palë të Paditur AKUK dhe MIE. Kjo dhomë me shkresën zyrtare të datës 19.12.2018 ka njoftuar zyrtarisht palët (MIE-n dhe Kontraktorin) për hapjen e kësaj çështjeje.

★ Fact Box nr. 5:

“Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), në lidhje me çështjen nr. 24140/MHM/HBH me vendimin e datës 14 mars 2024, konstatoi se, “ndërprerja e kontratës nga ana e palës përgjegjëse sipas Nën-klauzolës 15.2, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës ishte e jashtëligjshme”⁶⁶. Shkaku kryesor i vonesave dhe mosrealizimit të projektit ishte pamundësia e aksesit dhe posedimit të kantierit nga kontraktori, si dhe vonesat e theksuara në kryerjen e pagesave dhe rimbursimin e TVSH-së.

Çështjet kryesore të vlerësuara nga Gjykata e Arbitrazhit (GJA) si shkaqe të justifikuara kishin të bënin me: (a) mungesën e aksesit në kantier nga kontraktori; dhe (b) mospagesën e shumave sipas kontratës dhe rimbursimin e TVSH-së nga pala shtetërore. Gjykata vendosi se të dy këto shkaqe ishin të justifikuara plotësisht. Arsyetimet mbi vendimmarrjen janë përmbledhur në Konkluzionin e GJA në lidhje me mungesën e aksesit në kantier (paragrafi 903), formuluar si më poshtë: “Pamundësia e aksesit dhe posedimit të kantierit për ndërtimin e pusetave dhe punimeve të mikrotunelimit ndikoi negativisht në çdo aspekt të asaj që Pala e Paditur pretendon se ishin dështimet e Paditësit. Sipas mendimit të Tribunalit, ky ishte shkaku thelbësor dhe kryesor i vonesave dhe i mos përfundimit të Projektit”. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit konstatoi se,

⁶⁵ - Raport përfundimtar i auditimit të KLSH-së, ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Tiranë, Tetor 2019, fq. 3 – 4.

⁶⁶ - Referuar shkresës së Avokaturës së Shtetit me nr. 56/11, date 12.04.2024 dërguar AKUK dhe MIE, evidentohet që: “Në përgjithësi, nga Vendimi rezultoi se Gjykata e Arbitrazhit i është qasur në mënyrë të plotë e të detajuar, çështjeve komplekse faktike dhe ligjore të paraqitura nga palët. **Asnjë nga arbitrat nuk dha mendim të kundërt, duke përfshirë arbitrin e caktuar nga pala e Paditur”.**

“është e arsyeshme të supozohet se mospagesat dhe vonesat në pagesa... krijojnë vështirësi financiare për Paditësin gjatë ekzekutimit të kontratës dhe ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punimeve, në reduktimin e flukseve të parave Kontraktorit dhe privimin nga fondet për sigurimin dhe mobilizimin e materialeve, punës, dhe pajisjeve të nevojshme të cilat kanë kontribuar, përveç mungesës së aksesit në kantier, në dështimin e Paditësit për të përparuar me punimet në përputhje me Kontratën” (paragrafi 868).

Si përfundim, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICC Arbitration) Londër, në lidhje me çështjen n. 24140/MHM/HBH, sipas Vendimit të datës 14 mars 2024, në Kreun IX, Paragrafi 1400 e në vijim, (faqe 319-321), pas shqyrtimit të 10 pretendimeve/ kërkesave të palës Paditëse C.D. S.p.A, ka vendosur këto detyrime ndaj palëve, si në tabelë:

Tabela nr. 21: Përmbledhëse e detyrimeve financiare të MIE dhe AKUK ndaj “C.D.” SpA (Itali)

Zërat	Shuma e detyrimit të palës përgjegjëse (AKUK, MIE) sipas monedhës			Llogaritja e interesit vjetor 3% në vit
	CLAIM /Kërkesa nr.	JPY	LEK	EURO
1	1,613,393,481	0	0	01.10.2018
2	277,619,188	0	0	01.10.2018
3	9,534,185.42	0	90,902.38	01.10.2018
4	0	0	270,000	01.05.2019
5	0	46,964,317.00	0	14.12.2020
6	5,083,345	43,418,264.00	0	14.12.2020
7	710,009,469	0	0	14.12.2020
8	0	16,408,971	2,463,286.25	14.12.2020
9	262,060,456	0	0	14.12.2020
10	0	0	0	-
Shuma	2,877,700,124	106,791,552	2,824,188.63	-

Burimi: Vendimi i ICC Arbitration, Case n.24140/ MHM/HBH, datë 14.03.2024, administruar nga AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për sa më sipër, aplikimi i interesave vjetore, të përlllogaritura në nivelin 3% të normës së skontimit të Bankës përkatëse mbi shumën e principalit të detyrimit të pashlyer për 9 (nëntë) rastet e njohura nga Arbitrazhi është si më poshtë:

- ✓ Në 3 (tre) raste përmbi shumat prej 1.900.546.854 JPY dhe 90,902.38 Euro, duke filluar nga data 01.10.2018;
- ✓ Në 1 (një) rast përmbi shumën 270,000 Euro, duke filluar nga data 01.05.2019;
- ✓ Në 5 (pesë) raste, përmbi shumat prej 977,153,270 JPY, 106,791,552 lekë dhe 2,463,286.25 Euro, duke filluar nga data 14.12.2020.

Mbi peshën në buxhet të vendimmarrjes së Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit

Çështja “C.D. & K.C.”. vs. Republika e Shqipërisë⁶⁷ është iniciuar në vitin 2018 nga kompania C.D. & K.c., e cila është kompania zbatuese e kontratës së nënshkruar në datën 30.01.2014, “Për përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe” me vlerën rreth 81,000,000 Euro. Kontrata është ndërprerë më 04.07.2018 në mënyrë të njëanshme nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në kundërshtim me marrëveshjen e financimit dhe me kushtet e kontratës. Deri në këtë datë, punimet ishin kryer rreth 70% ose në vlerën 56 milion Euro. Referuar Tabelës nr. 20, të Relacionit mbi Projekt ligjin “Për buxhetin e vitit 2025”, detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar për MIE dhe AKUK për ICC Case 241-40 ndaj shoqërisë “C.D.” s.p.a janë gjithsej prej 13,520,741 Euro, e përbërë nga 13,492 mijë Euro dhe kosto ligjore e shpenzime gjyqësore 28.5 mijë Euro, që përbëjnë 1,2% të nivelit të detyrimeve shtetërore për vendime të arbitrazhit ndërkombëtar dhe përfaqësohen si në tabelë:

Tabela nr. 22: Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar 2024

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Detyrimi i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit/kosto ligjore (A)	Detyrime Kontigjente (B)	Totali i detyrimit (C=A+B)
MIE/AKUK	ICC Case 24140/MHM Shoqëria Costruzioni DONDI S.P.A	13,492,241	0	13,492,241
	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH Costruzioni DONDI S.P.A	28,500	0	28,500

Burimi: Ministria e Financave, Relacionit mbi Projekt ligjin “Për buxhetin e vitit 2025”

Tabela nr. 23: Të dhëna mbi kostot e çështjes së arbitrazhit nga Avokatora e Shtetit

Çështje arbitrazhi		Kosto përfaqësimi	Kosto eksperimentesh	Kosto administrative	
ICC 24140/MHM	Kosto përfaqësimi C.D. kunder AKUM/MIE	€ 1,099,000			
ICC 24140/MHM	Shërbim ekspertimi C.D. spa kundër AKUM/MIE		\$750,000.00		
ICC 24140/MHM	Shpenzime administrative C.D. kundër AKUM/MIE			\$ 35,700	
ICC 24140/MHM	Shpenzime gjyqësore C.D. spa kundër AKUM/MIE			€ 2,647	£7,612.50
ICC 24140/MHM	Shoqëria C.D. s.p.a, kundër AKUM/MIE				

Burimi: Avokatura e Shtetit (Raport i auditimit të KLSH-së)

Veprimet e ndërmarra nga AKUK dhe/ ose MIE pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në kuadër të njohjes dhe shlyerjes së detyrimeve nuk kanë paur rezultat.

Nga auditimi konstatohet se MIE dhe AKUK kanë qenë pjesë e disa takimeve të zhvilluara nga Avokatura e Shtetit, e cila ka ndjekur procesin e Arbitrazhit ICC Case N. 24140/MHM/HBH, për zgjidhjen me negociim të çështjes me shoqërinë “D.” S.p.A, por ato kanë rezultuar të pasuksesshme. Gjykata e Arbitrazhit ka dalë me vendimin final më datë 14.03.2024.

Referuar praktikave shpresore të Avokaturës së Shtetit, del se i është komunikuar AKUK-ut se për fillimin e ekzekutimit të vendimit të Arbitrazhit të datës 14.03.2024, duhet që ky vendim të regjistrohet dhe të njihet nga Gjykata e Apelit në Shqipëri. Aktualisht, ende nuk është kryer njohja e këtij vendimi nga një gjykatë shqiptare dhe për rrjedhojë ekzekutimi i tij nuk ka nisur.

⁶⁷ - **Burimi:** Top Story/ Fatura zyrtare e arbitrazheve vlerësohet 263 mln euro. Sa të tjerë janë potencialisht për tu fituar? Burimi: <https://top-channel.tv/2021/10/20/top-story-fatura-zyrtare-e-arbitrazheve-vleresohet-263-mln-euro-sa-te-tjere-jane-potencialisht-per-tu-fituar/>

Grupi i auditimit të KLSH-së ka shqyrtuar korrespondencën shkresore të mbajtur nga AKUK me institucionin e Avokaturës së Shtetit dhe MIE pas përfundimit të procesit të arbitrazhit dhe vendimit të Arbitrazhit Ndërkombëtar (ICC Case 241-40 me palë paditëse shoqëria “C. D.” s.p.a (Itali) kundër të paditurit AKUK dhe MIE (Shqipëri), sa vijon:

1.	Shkresa e Avokaturës së Shtetit me nr. 56/9 Prot. datë 03.04.2024, dërguar AKUK dhe MIE me objekt “Mbi çështjen e arbitrazhit ICC Case 24140 MHM/HHB”, administruar në AKUK me nr. 1076 Prot. datë 05.04.2024 me anë të së cilës është vënë në dispozicion Vendimi i Arbitrazhit Ndërkombëtar, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë (ICC) me Nr. Reference ICC Case No. 24140/MHM/HHB, “C.D.” S.P.A (Itali) kundër “Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë”, lëshuar nga Tribunali më datë 14.03.2024. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë dhe kostot e arbitrazhit, (Tabela Financiare mbi kostot e administrimit të ICC, datë 15.03.2024).
2.	Shkresa e Avokaturës së Shtetit me nr. 56/11 Prot. datë 12.04.2024, “Mbi çështjen e arbitrazhit ICC Case 24140 MHM/HHB”, dërguar AKUK dhe MIE, administruar në AKUK me Nr. 1076/1 Prot. datë 15.04.2024, ku është përcjellë analiza e avokatëve të studios ligjore të “F.H.” lidhur me vendimin e arbitrazhit
3.	Shkresa e AKUK me Nr. 1076/2 Prot. datë 10.05.2024, “Mbi çështjen e arbitrazhit ICC Case 24140 MHM/HHB”, dërguar ASH dhe MIE.

Analizuar sa më sipër, institucionet shtetërore përgjegjëse sipas vendimit të tribunalit (MIE dhe AKUK) do të duhet të mbulojnë pagesat financiare për:

A. Pjesën e principalit të huasë, (në referim të Seksionit 1, Neni 2 “Shlyerja, interesi dhe tarifa e detyrimit financiar”), si dhe interesat e kredisë (sipas parashikimeve të Seksionit 2 “Interesi dhe metoda e pagesës së tij”), të Ligjit nr. 9964, datë 24.07.2008, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”-(FZ nr.127, datë 4.8.2008).

Bazuar në Ligjin Nr. 9964, datë 24.07.2008 për ratifikimin e “Marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (sot JICA) për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, Programi 3 (Programi i pagesës në disa këste), ka parashikuar:

➤ 1.Shlyerja e principalit (I)

Data e kërkueshme	Shuma (në jenë japonezë)
Në 20 qershor 2018	164,460,000
Çdo 20 qershor dhe 20 dhjetor	164,409,000
Duke filluar nga 20 dhjetor 2018 deri në 20 qershor 2048	

Shuma e huasë e alokuar në kategorinë (D- Zërat e paparashikuar) e specifikuar në seksionin 1, të programit 2 është provuar të përfshihet në “Principalin (I)”.

➤ 2.Shlyerja e principalit (II)

Data e kërkueshme	Shuma (në jenë japonezë)
Në 20 qershor 2018	17,940,000
Çdo 20 qershor dhe 20 dhjetor	17,901,000
Duke filluar nga 20 dhjetor 2018 deri në 20 qershor 2048	

B. fonde të tjera destinohen nga buxhetit të shtetit për likuidimin e kostove që rrjedhin nga vendimi i Arbitrazhit Ndërkombëtar, për ICC Case 241-40 ndaj shoqërisë “C.D.” S.p.A përveç detyrimit prej 13,520,741 Euro nga prishja e kontratës në mënyrë të njëanshme nga MIE dhe AKUK me kontraktorin, të tilla si si tarifatat fikse të arbitrazhit, kosto të përfaqësimit, shpenzime gjyqësore, kosto të ekspertimit, etj.

1. Kostot e Arbitrazhit, të njohura si kosto fikse të Gjykatës me datën 26.02.2024, referuar “Financial table” datë 15.03.2024 të International Court of Arbitration, (referuar paragrafit të fundit të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit (datë 14.03.2024, faqe 321), ku përcaktohet shprehimisht se: *Pala përgjegjëse do të mbulojë detyrimet e arbitrazhit, siç përcaktohet nga Gjykata e ICC-së dhe do t'i paguhet paditësit 350,000 USD që ka paguar në formë të paradhënies*

mbi shpenzimet, dhe secila Palë do të mbulojë kostot e veta ligjore dhe të tjera të shkaktuara në lidhje me këtë arbitrazh.

2. Kostot e ekspertimit prej 750 mijë euro, kostot e përfaqësimit prej 1,099 mijë Euro, shpenzimet gjyqësore 2,647 Euro dhe 7,612.5 GBP dhe kostot administrative⁶⁸.

Referuar përcaktimeve të faqes nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së në institucionin e Avokaturës së Shtetit, del se, “nga ASH janë raportuar në Prill 2024, shpenzime përfaqësimi dhe gjyqësore **1,101,647 Euro**, shpenzime ekspertimi dhe administrative **785,700 USD** si dhe **7612.5 GBP** shpenzime gjyqësore, ndërsa në Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Faktik 2023 publikuar nga MF raportohen kosto administrative të përfaqësimit dhe kosto ligjore 28,500 Euro të palikuiduara. Në lidhje me likuidimin total apo të mbetur nga institucioni palë në çështje AKUK, Avokatura e Shtetit nuk ka informacion nga ky institucion”.

Mbi mirëmbajtjen e investimit të kryer, pas ndërprerjes së kontratës në vitin 2018

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Njesisë së Zbatimit të Projektit për Kanalizimet e Tiranës së Madhe, likuidimet ndaj kontraktorit sipas viteve pasqyrohen në tabelën e më poshtme:

Tabela nr. 24: Likuidimet ndaj kontraktorit (*shumat janë në monedhën JPY*)

Viti	Grose amount (Shuma bruto)	Retention money (5%) (Shuma e mbajtur)	Advance Payment (Pagesë paradhënie)	Net amount payable (Shuma neto e pagueshme)
2014	456,902,468	(22,845,070)	2,042,249,490	434,057,398
2015	1,077,032,669	(100,287,095)	-	976,745,574
2016	1,440,199,372	(72,009,969)	-	1,368,189,403
2017	2,181,834,701	(109,091,733)	(624,314,540)	1,448,428,428
2018	386,569,912	(19,328,496)	(60,179,488)	307,061,928
Totali	5,542,539,122	(323,562,363)	1,357,755,462	4,534,482,731

Burimi: AKUK

Punimet e certifikuara ndaj kontraktorit të punimeve sipas secilit zë punimesh janë të përmbledhura në raportin e përgatitur nga konsulenti i projektit pas terminimit të kontratës së punimeve. AKUK ka konfirmuar gjatë auditimit se nuk ka detyrime të prapambetura për sa i përket punimeve të certifikuara kundrejt kontraktorit të punimeve, ndërsa pretendimet e kontraktorit për pagesa të tjera përtej punimeve të certifikuara, janë trajtuar nga Arbitrazhi Ndërkombëtar.

Sa më sipër, vlera e kontratës për zbatimin e punimeve ka qenë JPY 8,168,997,959, ndërsa totali i punimeve të certifikuara dhe të paguara (IPC 1-37) është JYP 5,552,383,768, pra rreth 68% e vlerës së kontratës.

Pas ndërprerjes së punimeve, zyra e koordinimit të projektit “*Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së madhe*” dhe grupi i punës i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 65 Prot., datë 09/07/2018, lidhur me sigurimin e shërbimeve për mirëmbajtjen e kantierit, si dhe praktikave të ndjekura për informimin mbi rëndësinë e mirëmbajtjes dhe sigurimin e fondeve për kryerjen e shërbimeve, ka nisur praktikën shkresore me MIE dhe MFE, për alokim fondesh për mirëmbajtjen e objekteve dhe sistemeve të ndërtuar. Nëpërmjet memo-s datë 19.03.2019, drejtuar Drejtorit të AKUK, kërkohet autorizim për kryerjen e procedurave për shërbimin e mirëmbajtjes së projektit, pas marrjes së PBA e detajuar 2019-2021, ku me programin 06370, janë miratuar kosto lokale “Projektin e kanalizimeve të Tiranës së madhe”, me fond *217,757,000 lekë viti 2019 dhe 195,000,000 lekë viti 2020 dhe 2021.*

Kontratat e mirëmbajtjes të lidhura janë, si në vijim:

⁶⁸ -Referuar nga Raporti Përfundimtar i Auditimit “*Mbi auditimin e përputhshmërisë për ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar*” të ushtruar në Avokaturën e Shtetit, Tiranë”, Dhjetor 2024, (faqe 5 dhe 37), në zbatim të Programit të Auditimit nr.853/1 prot., datë 01.07.2024.

Për vitin 2019

Kontrata e Punimeve “Shërbime mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, 2019		
1.Lidhja e kontratës Nr. 1005/2 prot., datë 29.03.2019	2.Vlera e kontratës 15,044,117 lekë pa TVSH 18,052,940 lekë me TVSH; OE fitues “S.K.” sh.p.k.	3.Likuiduar deri USH. Nr.243 datë 02.07.2020
4- Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 17,947,916 lekë Vlera pa TVSH 14,956,597 lekë	5.Afat i kontratës në dite Parashikuar 275 ditë. Fillimi punimeve: 01.04.2019 Përfundimi punimeve : 31.12.2019	6. Zgjatja e kontratës Nuk ka

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1005/2 prot., datë 29.03.2019, të lidhur mes AK Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe OE “S. K.” sh.p.k. Vlera e kontratës është **15,044,117** lekë pa TVSH/ **18,052,940** lekë me TVSH, me afat zbatimi 01.04.2019 deri 31.12.2019. Urdhri i brendshëm nr.1005/3 prot., datë 01.04.2019, grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës përbëhet nga I.Sh., S.Z. dhe A.B.

Likuidimi i situacioneve pjesore është kryer si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera (lekë pa TVSH)	Urdhër shpenzimi	Shënim
1	Situacioni nr.1 (Prill 2019)	8,115,730	USH. Nr.171 datë 28.05.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 3,955,850 Shuma B:Trunk Main 4,159,880
2	Situacioni nr.2 (Maj 2019)	721,687	USH. Nr.244 datë 19.07.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
3	Situacioni nr.3 (Qershor 2019)	721,687	USH. Nr.245 datë 19.07.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
4	Situacioni nr.4 (Korrik 2019)	721,687	USH. Nr.420 datë 14.10.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
5	Situacioni nr.5 (Gusht 2019)	721,687	USH. Nr.421 datë 14.10.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
6	Situacioni nr.6 (Shtator 2019)	721,687	USH. Nr.443 datë 28.10.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
7	Situacioni nr.7 (Tetor 2019)	1,789,054	USH. Nr.505 datë 25.11.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 545,107 Shuma C:Punime të paparashikuara 716,367
8	Situacioni nr.8 (Nëntor 2019)	721,687	USH. Nr.560 datë 06.12.2019	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
9	Situacioni nr.9 (Dhjetor 2019)	721,687	USH. Nr.243 datë 02.07.2020	Shuma A: Zona e Impiantit 527,580 Shuma B:Trunk Main 194,107
	Totali	14,956,597		

Burimi: Të dhënat sipas AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për vitin 2020

Kontrata e Punimeve “Shërbime mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, 2020		
1.Lidhja e kontratës Nr. 1232 prot., datë 22.05.2020	2.Vlera e kontratës 20,000,000 lekë pa TVSH 24,000,000 lekë me TVSH; OE fitues “B.” sh.p.k.	3.Likuiduar deri Nr.276 datë 22.10.2021.
4.Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 20,000,000 lekë Vlera pa TVSH 24,000,000 lekë	5.Afat i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë. Fillimi punimeve: 22.05.2020 Përfundimi punimeve : 22.05.2021	6. Zgjatja e kontratës Nuk ka

Koordinatori i projektit të kanalizimeve të Tiranës së madhe, me memon e datës 07.05.2020, ka njoftuar zv. Drejtorin e Përgjithshëm, Titullar i autorizuar, mbi vazhdimësinë e shërbimit të mirëmbajtjes së kantierit të projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, duke renditur problematikat e konstatuara nga inspektimi në terren. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1232 prot., datë 22.05.2020, të lidhur mes AK Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe OE “B.” sh.p.k. Vlera e kontratës me objekt “Shërbime mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe” është **20,000,000** lekë pa TVSH/ **24,000,000** lekë me TVSH, me afat 12 muaj, ku fillimi i punimeve është data e lidhjes së kontratës.

Likuidimi i situacioneve pjesore, është kryer si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera (lekë pa TVSH)	Urdhër shpenzimi	Shënim
1	Situacioni nr.1 (Qershor 2020)	8,158,720	USH. Nr.254 datë 09.07.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 6,800,720 Shuma B:Trunk Main 1,358,000
2	Situacioni nr.2 (Korrik 2020)	2,821,060	USH. Nr.306 datë 28.08.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 2,049,000 Shuma B:Trunk Main 772,060
3	Situacioni nr.3 (Gusht 2020)	1,037,440	USH. Nr.339 datë 17.09.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 928,400 Shuma B:Trunk Main 109,040
4	Situacioni nr.4 (Shtator 2020)	1,011,640	USH. Nr.405 datë 09.11.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 463,260 Shuma B:Trunk Main 548,380
5	Situacioni nr.5 (Tetor 2020)	801,660	USH. Nr.429 datë 09.12.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 263,620 Shuma B:Trunk Main 538,040
6	Situacioni nr.6 (Nëntor 2020)	799,977	USH. Nr.455 datë 18.12.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 675,177 Shuma B:Trunk Main 124,800
7	Situacioni nr.7 (Dhjetor 2020)	803,890	USH. Nr.550 datë 28.12.2020.	Shuma A: Zona e Impiantit 803,890 Shuma B:Trunk Main 0
8	Situacioni nr.8 (Janar 2021)	799,060	USH. Nr.104 datë 14.04.2021.	Shuma A: Zona e Impiantit 799,060 Shuma B:Trunk Main 0
9	Situacioni nr.9 (Shkurt 2021)	798,489	USH. Nr.107 datë 16.04.2021.	Shuma A: Zona e Impiantit 798,489 Shuma B:Trunk Main 0
10	Situacioni nr.10 (Mars 2021)	1,001,985	USH. Nr.108 datë 16.04.2021.	Shuma A: Zona e Impiantit 552,877 Shuma B:Trunk Main 449,108
11	Situacioni nr.11 (Prill 2021)	1,006,262	USH. Nr.138 datë 14.05.2021.	Shuma A: Zona e Impiantit 850,262 Shuma B:Trunk Main 156,000
12	Situacioni nr.12 (Maj 2021)	959,817	USH. Nr.276 datë 22.10.2021.	Shuma A: Zona e Impiantit 540,053 Shuma B:Trunk Main 419,764
		20,000,000		

Burimi: Të dhënat sipas AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për vitin 2021

Kontrata e Punimeve “Shërbime mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe” 2021		
1.Lidhja e kontratës Nr. 1481 prot., datë 2.07.2021	2.Vlera e kontratës 17,357,000 lekë pa TVSH 20,828,400 lekë me TVSH; OE fitues “M.” sh.p.k.	3. Likuiduar deri USH. Nr.271 Datë 29.08.2022
4.Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 20,828,400 lekë Vlera pa TVSH 17,357,000 lekë	5.Afat i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë. Fillimi punimeve: 22.07.2021 Përfundimi punimeve : 22.07.2022	6. Zgjatja e kontratës Nuk ka

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1481 prot., datë 02.07.2021, të lidhur mes AK Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe OE “M.” sh.p.k. Vlera e kontratës është **17,357,000** lekë pa TVSH/ **20,828,400** lekë me TVSH, me afat 12 muaj, ku fillimi i punimeve është data e lidhjes së kontratës. Urdhri i brendshëm nr.1481/1 prot., datë 05.07.2021, grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës përbëhet nga A.K., L.R. dhe S.Z., ndryshuar me Urdhrin nr. 2453 prot., datë 26.11.2021 S.Z. me A.Y.

Likuidimi i situacioneve pjesore, është kryer si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera (lekë pa TVSH)	Urdhër shpenzimi	Shënim
1	Situacioni nr.1 (22.07.2021-10.11.2021)	5,833,333	USH. Nr.338 datë 10.12.2021	Shuma A: Zona e Impiantit 5,833,333 Shuma B:Trunk Main 0
2	Situacioni nr.2 (11.11.2021-25.01.2022)	3,000,000	USH. Nr. 88 datë 09.05.2022	Shuma A: Zona e Impiantit 3,000,000 Shuma B:Trunk Main 0
3	Situacioni nr.3 (25.01.2022-06.05.2022)	5,416,667	USH. Nr.121 Datë 20.05.2022	Shuma A: Zona e Impiantit 5,416,667 Shuma B:Trunk Main 0
4	Situacioni nr.4 (06.05.2022-22.07.2022)	3,107,000	USH. Nr.271 Datë 29.08.2022	Shuma A: Zona e Impiantit 1,890,000 Shuma B:Trunk Main 1,217,000
	Totali pa TVSH	17,357,000		

Burimi: Të dhënat sipas AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Për vitin 2023

Kontrata e Punimeve “Mirëmbajtje e kantierit të Tiranës së Madhe” 2023		
1.Lidhja e kontratës Nr. 545 prot., datë 08.03.2023	2.Vlera e kontratës 13,994,600 lekë pa TVSH 16,793,520 lekë me TVSH;	3.Likuiduar deri USH. Nr.98 dhe Nr.99

	BOE fitues "N.S." sh.p.k. dhe "M." sh.p.k.	Datë 16.04.2024
4. Situacioni Përfundimtar Vlera me TVSH 16,793,520 lekë Vlera pa TVSH 13,994,600 lekë	5. Afati i kontratës në dite Parashikuar 365 ditë. Fillimi punimeve: 8.03.2023 Përfundimi punimeve : 7.03.2024	6. Zgjatja e kontratës Nuk ka

Koordinatori i projektit të kanalizimeve të Tiranës së madhe, me memon e datës 02.09.2022, ka njoftuar Titullarin mbi zhvillim e procedurës së mirëmbajtjes së kantierit të projektit "Përmirësimi I sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe", si dhe ka renditur problematikat e konstatuara nga inspektimi në terren. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 545 prot., datë 08.03.2023, të lidhur mes AK Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve dhe BOE "N.S." sh.p.k. dhe "M." sh.p.k. Vlera e kontratës është **13,994,600** lekë pa TVSH/ **16,793,520** lekë me TVSH, me afat 12 muaj, ku fillimi i punimeve është data e fillimit të shërbimeve në kantier. Urdhri i brendshëm nr. 576 prot., datë 10.03.2023, grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës përbëhet nga A.K., A.Y. dhe S.Z., ndryshuar me Urdhrin nr. 576/1 prot., datë 03.08.2023 S.Z. me A.Xh.

Likuidimi i situacioneve pjesore, është kryer si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera (lekë pa TVSH)	Urdhër shpenzimi	Shënim
1	Situacioni nr.1 (08.03.2023-05.06.2023)	3,613,583	USH. Nr.201, 25.08.2023 USH. Nr.202, 25.08.2023	Shuma A: Zona e Impiantit 3,508,333 (NG Structures) + 105,250 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
2	Situacioni nr.2 (06.06.2023-06.07.2023)	1,201,667	USH. Nr.206, 30.08.2023 USH. Nr.207, 30.08.2023	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,667 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
3	Situacioni nr.3 (07.07.2023-31.07.2023)	944,167	USH. Nr. 380, 08.01.2024 USH. Nr. 381, 08.01.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 916,667 (NG Structures) + 27,500 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
4	Situacioni nr.4 (01.08.2023-31.08.2023)	1,201,667	USH. Nr. 380, 08.01.2024 USH. Nr. 381, 08.01.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,667 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
5	Situacioni nr.5 (01.09.2023-30.09.2023)	1,201,666	USH. Nr. 380, 08.01.2024 USH. Nr. 381, 08.01.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,666 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
6	Situacioni nr.6 (01.10.2023-31.10.2023)	1,201,667	USH. Nr. 380, 08.01.2024 USH. Nr. 381, 08.01.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,667 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
7	Situacioni nr.7 (01.11.2023-30.11.2023)	1,201,666	USH. Nr. 380, 08.01.2024 USH. Nr. 381, 08.01.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,666 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
8	Situacioni nr.8 (01.12.2023-26.12.2023)	1,201,667	USH. Nr. 82, 11.04.2024 USH. Nr. 83, 11.04.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,667 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
9	Situacioni nr.9 (26.12.2023-29.01.2024)	1,201,667	USH. Nr. 98, 16.04.2024 USH. Nr. 99, 16.04.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 1,166,667 (NG Structures) + 35,000 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
10	Situacioni nr.10 (30.01.2024-07.03.2024)	1,025,183	USH. Nr. 98, 16.04.2024 USH. Nr. 99, 16.04.2024	Shuma A: Zona e Impiantit 983,095 (NG Structures) + 42,088 (Meteo) Shuma B:Trunk Main 0
	Totali pa TVSH	13,994,600		

Burimi: Të dhënat sipas AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabela përmbledhëse mbi kontratat e mirëmbajtjes 2019-2024:

Nr.	Kontrata e mirëmbajtjes	Periudha	Vlera e situacionuar (lekë pa TVSH)	Vlera e situacionuar (lekë me TVSH)
1	Nr. 1005/2 prot., datë 29.03.2019	01.04.2019-31.12.2019	14,956,597	17,947,916
2	Nr. 1232 prot., datë 22.05.2020	22.05.2020-22.05.2021	20,000,000	24,000,000
3	Nr. 1481 prot., datë 2.07.2021	22.07.2021-22.07.2022	17,357,000	20,828,400
4	Nr. 545 prot., datë 08.03.2023	08.03.2023-07.03.2024	13,994,600	16,793,520
Totali			66,308,197	79,569,836

Burimi: Të dhënat sipas AKUK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Në preventivin e vitit 2023 zëri “*Mirëmbajtje e rrugës së komunitetit*” është shtuar me 280 metër linear gjatësi rrugë komuniteti, e cila nuk është argumentuar në memon e parashikimit të zërave/punimeve të cilat janë përfshirë në preventivin e punimeve të mirëmbajtjes, në krahasim me vitet paraardhëse.

Nga auditimi i kontratave të mirëmbajtjes dhe auditimit në terren u konstatua se:

1. Mirëmbajtja e investimit të kryer deri në këtë moment kryesisht ka konsistuar në një mirëmbajtje rutinë si pastrim vegjetacioni, mirëmbajtje rruge të brendshme të impiantit, mirëmbajtje rruge e komunitetit, mirëmbajtje sistemi furnizimi me ujë, zyrave, rrjetit elektrik të cilat përbëjnë më shumë se 85% e vlerës vjetore të kontratës së mirëmbajtjes;

2. Ndërkohë janë parashikuar shumë pak vlera ose aspak për sistemet e ndërtuara si strukturat e betonit, *shaft*-et, sistemet e pompimit, sistemet mekanike etj., për të cilat gjatë vizitës në terren u konstatua se hekuri i *sludge digesters* është i ndryshkur dhe në prezencë uji, si rrjedhojë e mosparashikimit në mirëmbajtje të lyerja me bojë antikorrozion e tyre. Mbulesa e *shaft*-eve me element druri ka sjellë që këto punime janë kërkuar dhe marrë në çdo kontratë mirëmbajtje, kur mund të parashikohej lyerja e tyre me bojë kundër lagështirës.

Mbi gjendjen aktuale në kantierin e ITUN Kashar

Grupi i auditimit realizoi një vizitë në terren në kantierin ku është ndërtuar ITUN Kashar në datën 13.05.2025, në prezencë të përfaqësuesit të AKUK ing. S. Z.

Foto nr. 13-23: Në ambientet e kantierit dhe pjesë përbërëse/ ITUN Kashar





Mbi rivënien në jetë të projektit

Duke qenë se në Tetor 2019 ka përfunduar edhe afati për disbursimin e huasë, ndërkohë që punimet e realizuara ishin në nivelin prej rreth 68% dhe asnjë prej objekteve të parashikuara në projekt nuk kishte përfunduar, me anë të një Note Shpjeguese është kërkuar shtyrja e afatit të disbursimit të huasë nga data 24.10.2019 deri më datë 24.04.2022.

Për shkak se një sërë ngjarjesh të rënda të ndodhura menjëherë pas shtyrjes së dytë të dhënë nga Qeveria e Japonisë për periudhën e disbursimit të Marrëveshjes së Huasë (Tërmeti i Nëntorit 2019 dhe më pas pandemia Covid-19), ndryshuan rendin e prioriteteve dhe bënë që të gjitha Akt-Marrëveshjet dhe dakordësimet ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Japoneze të konkretizoheshin me VKM Nr. 877 më datë 11.11.2020.

Shtyrja e afatit të disbursimit të kredisë është miratuar me VKM Nr. 760 datë 20.12.2023, me afat deri në Tetor 2026.

Pavarësisht bërjes efektive të fondeve të kredisë, për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit nevojitet alokimi i shumave të huasë nga Kategoria (A) “Punimet civile dhe prokurimi i mallrave”, në Kategorinë (B) “Shërbimet e konsulencës” pasi kontraktimi i konsulentit bëhet i pamundur nëse nuk është siguruar financimi.

Me VKM-në nr. 716, datë 20.11.2024 është miratuar në parim ndryshimi në Marrëveshjen e Huasë për rialokimin e fondeve për shërbimin e konsulencës dhe menjëherë pas kësaj kanë filluar procedurat për prokurimin e Konsulentit të ri të projektit. Ndërsa me VKM Nr. 56 datë 29.01.2025 është marrë miratimi përfundimtar i Marrëveshjes së Huasë për sa më sipër.

Aktualisht, AKUK është duke zhvilluar procedurën për prokurimin e shërbimit të konsulencës/supervizionit, në bazë të Udhëzimeve të JICA-s për këtë shërbim.

Midis AKUK dhe JICA janë kryer gjithë aprovimet e nevojshme mbi dokumentacionit standard të prokurimit të shërbimit të konsulencës (Request for Proposal) dhe kompanitë e Short-listuara.

Me Urdhrin Nr. 216 datë 31.12.2024, Nr. 3949 Prot. datë 31.12.2024, të Drejtorit të përgjithshëm të AKUK është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dhe më datë 28.02.2025 është bërë vetëm hapja e ofertave teknike.

Referuar ToR-ve vënë në dispozicion grupit të auditimit nga AKUK, rezultoi se:

1. Detyra kryesore të konsulentit janë vlerësimi e statusit aktual të punimeve, rishikimin e projektit ekzistues, përgatitjen e dokumenteve të procedurës së zbatimit dhe do të kryejë supervisionin e punimeve, vlerësojë impaktin mjedisor etj.
2. Në lidhje me ToR-t e përgatitur nga AKUK theksojmë se ai nuk adreson zhvillimet demografike dhe urbane të qytetit të Tiranës. Mos saktësimi apo mosparashikim i numrit të popullsisë, lëvizjeve demografike gjithmonë në rritje në qytetin e Tiranës, në ToR-t e hartuara mbart riskun që konsulenti mund të hartojë një projekt të rishikuar kapacitetet e të cilit mund të mos i përgjigjen nevojës reale të Qytetit të Tiranës për trajtimin e ujërave të ndotura.
3. AKUK nuk disponon të dhëna të sakta në lidhje me investimet e kryera ndër vite nga UKT, komplekset private të banimit etj., e cila i nevojitet konsulentit për projektimin e kapacitetit ITUN Kashar. Gjithashtu ekziston rreziku që rrjetet terciare dhe sekondare të ndërtuara nga këto investime, të ketë bashkim ujërash të ndotura me ujërat e shiut, e cila sjell rritjen e fluksin e prurjeve në këto tubacione, duke mbi dimensionuar linjën kryesore të projektit të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së madhe. Si rrjedhojë mund të kemi një projekt preventiv i cili do të rriste fiktivisht kostot e projektit. Konsulenti duhet të kushtojë një vëmendje të shtuar përdorimit të teknikave dhe metodave më të mira të mundshme, të bazuara në kritere mjedisore, të miratuara me një akt normativ⁶⁹, dimensionimit të linjave të reja që do të projektojnë si në aspektin e diametrave (theksojmë se përdorimi i tubacioneve me diam. 200 mm mund të mos jetë efektiv për kushtet aktuale të qytetit të Tiranës), ashtu dhe në trasimin e gjurmës së linjave kryesore dhe sekondare duke marrë në konsideratë rrjetin nëntokësor i Qytetit të Tiranës është shumë i dendur.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk janë paraqitur observacione nga subjektet e audituara.

12. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 9115/2003 dhe Direktiva e BE-së 91/271/EEC kërkojnë mbulim minimal 85% të trajtimit të ujërave të ndotura urbane për qytetet me mbi 10,000 banorë. Aktualisht, niveli i mbulimit me Impiant të Trajtimit të Ujërave të Ndotura për Tiranën është 0%, ndërkohë që mesatarja kombëtare është 13.8% për vitin 2023, duke reflektuar një mospërputhje të konsiderueshme me projeksionet zyrtare dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Për të garantuar trajtimin e ujërave të ndotura urbane në qytetin e Tiranës, u iniciua projekti "*Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe*", me vlerë kontrate për zbatimin e punimeve 8,168,997,959 JPY. Deri në ndërprerjen e kontratës në vitin 2018, totali i punimeve të certifikuar dhe të paguara (IPC 1-37) është 5,552,383,768 JPY⁷⁰, pra rreth 68% e vlerës së Kontratës.

Për sa më sipër, pavarësisht investimit të kryer dhe fondeve të shpenzuara për këtë qëllim, për qytetin e Tiranës, që përfaqëson mbi 30% të popullsisë së vendit, nuk është siguruar shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura urbane, duke sjellë që ujërat e ndotura urbane që gjenerohen, të derdhen në lumin e Lanës, pa iu nënshtruar regjimit të trajtimit të tyre.

13. Gjetje nga auditimi: Ndërprerja e kontratës së zbatimit të punimeve për ndërtimin e ITUN Kashar dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në qytetin e Tiranës, u vlerësua nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICC) në Londër si e njëanshme dhe e kundërligjshme, duke arsyetuar se është shkelur marrëveshja e financimit dhe kushtet e kontratës, duke caktuar në ngarkim të palës

⁶⁹ Referuar nenit 5, të Ligjit nr.9115, datë 24.07.2005 "*Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura*".

⁷⁰ Referuar Raportit Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë i KLSH-së, ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Tiranë, Tetor 2019, "Në datën 30.01.2014, është nënshkruar kontrata për përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe me kontraktorin "D...I...&K...J.... me vlerën rreth 81,000,000 Euro. Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze dhe është ratifikuar në Kuvend me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008. Kjo kontratë është ndërprerë në datën 04.07.2018 dhe deri në këtë datë, punimet ishin kryer rreth 70% ose në vlerën 56 Milion Euro".

së paditur MIE dhe AKUK një vlerë prej afërsisht 13.5 milionë Euro⁷¹. Kostot financiare deri në maturimin dhe shlyerjen e plotë të detyrimeve, do të rriten edhe nga aplikimi i interesave vjetore, të përllogaritura në nivelin 3% të normës së skontimit të Bankës përkatëse mbi shumën e principalit të detyrimit të pashlyer. Nga auditimi rezultoi se, deri në datën 30.04.2025, ky vendim nuk ka qenë në proces njohje/ nuk është njohur nga Gjykata e Apelit, për të marrë fuqi juridike.

Efektet e këtij vendimi, përfshirë interesat, do të përfaqësojnë një ngarkesë të konsiderueshme financiare për buxhetin e shtetit, ndërkohë që këto fonde buxhetore mund të përdorëshin efektivisht në ndërtimin dhe përfundimin deri në operim të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Tiranë, që do t'i jepte një zgjidhje situatës së shkarkimit të ujërave të ndotura urbane të patrajtuara në lumin e Lanës.

14. Gjetje nga auditimi: Kapacitetet e impianteve të trajtimit të ujërave duhet të jenë në përputhje me popullsinë që ato shërbejnë, duke respektuar standardet e projektimit për infrastruktura të ujërave të ndotura dhe udhëzimet e BE-së për mjedisin. Standardet ndërkombëtare për trajtimin e ujërave të ndotura kërkojnë që impiantet të mundësojnë trajtimin efikas dhe të qëndrueshëm të ujërave për popullsi në rritje. Sipas të dhënave zyrtare të Entit Rregullator të Ujit popullsia e regjistruar në zonën e shërbimit të Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë sh.a. është 801,707 banorë. Ndërkohë, impianti i trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) në Tiranë, (në fazë ndërtimi) është përllogaritur me një kapacitet prej 350,000 persona ekuivalentë, i cili nuk është në përputhje me numrin aktual të banorëve të qytetit. Për më tepër, ndonëse impianti përfshin objekte moderne si tharja diellore dhe trajtimi mekanik i llumit, mungesa e kapacitetit të mjaftueshëm mund të ndikojë në funksionimin efikas dhe në cilësinë e trajtimit të ujërave të ndotura.

15. Gjetje nga auditimi: Pas ndërprerjes së punimeve të ndërtimit të Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura Kashar në vitin 2018, nga viti 2019-2024 Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve ka lidhur 4 kontrata për mirëmbajtjen e investimit të kryer, me vlerë totale 66,308,197 lekë pa TVSH. Në Memo-t përkatëse për fillimin e procedurës së prokurimit për kontratat e mirëmbajtjes, janë listuar gjithë problematikat e hasura në kantierin e Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura Kashar, disa prej të cilave janë: humbja e kuotës së tubave të gizës, vaskat e klorimit janë dëmtuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, mungesa e dyerve në *Sludge dewatering machine house*, masa për mbrojtjen e *digester*-ave nga rrëshqitjet e mundshme, punime të cilat nuk janë përfshirë në asnjë nga preventivat e mirëmbajtjes 2019-2024. Kontrata e mirëmbajtjes nuk garanton mirëmbajtjen e punimeve thelbësore të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së madhe, sidomos të strukturave beton arme si tanke *shaft*-e, apo të sistemeve mekanike etj. Në këto kushte gjendja e godinave në momentin e rifillimit të punimeve do të ketë nevojë për rehabilitim.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të lidhura nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve, me objekt mirëmbajtjen e investimit të kryer për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Kashar, ka rezultuar se:

a. Neni 53, pika 2 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, si dhe kapitulli II, pika 3.2.2 e DST-së, përcaktojnë se nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total, për të cilën AK njofton menjëherë për këto korigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Referuar preventivit fitues ka një gabim në vlerë pasi është i përberë nga dy kolona punime në muajin e parë me vlerë totale 8,554,230 dhe vlera e punimeve rutinë në 9 muajt e tjerë 5,773,500 lekë. Por, referuar kontratës nr.1005/2 prot., datë 29.03.2019, afati i shërbimit të mirëmbajtjes është 9 muaj total. Pra preventivi duhet të ishte i përbërë nga muaji i parë dhe 8 muajt e tjerë dhe vlera e preventivit (përfshirë fondin rezervë) duhet të ishte 14,370,542 lekë pa TVSH/ 17,244,650 lekë me TVSH. Ky gabim duhet të ishte rishikuar gjatë negociimit të çmimit ose duhej anuluar procedura, pasi gabimi është më i madh se 2% e vlerës

⁷¹ Sipas përllogaritjeve të Avokaturës së Shtetit, shkresa nr. 56/11 datë 12.04.2024, dërguar AKUK dhe MIE

së kontratës. Për sa më sipër vlera e totale e punimeve deri në situacion përfundimtar, përfshirë dhe punimet e paparashikuara duhet të ishte 14,402,597 lekë pa TVSH, ose **554,000 lekë më pak se vlera e certifikuar**. Kontraktori i punimeve në situacionet e punimeve 2-9 ka rritur çmimet e zërave me 13%, pasi ka marrë në konsideratë një preventiv të ri ku janë rregulluar çmimet pa ndryshuar vlerën e kontratës.

b. Referuar preventivit të punimeve të shërbimit të mirëmbajtjes të vitit 2019 dhe krahasuar me preventivin e punimeve të shërbimit të mirëmbajtjes të vitit 2020, u konstatua se janë kryer punime montim zhvendosje gjatë dy viteve, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi 2019	Çmimi 2020	Vlera 2019	Vlera 2020
1	Zhvendosja dhe sistemimi i tubave te gizës te pamontuar	copë	8	12,000	980	96,000	7,840
2	Mbulimi i tubave të montuar për të shmangur presionet e kundërta nga ujërat e shiut	Shumë fikse	1	204,000	295,000	204,000	295,000
3	Mbyllja e të gjithë dritareve te hapura (Dewatering House) Chlorination tank, pumping station etj.	copë	9	11,900	14,500	107,100	130,500
4	Mbyllja e të gjithë dyerve te hapura (Dewatering House) Chlorination tank, pumping station etj.	copë	2	33,025	24,500	66,050	49,000
Totali lekë pa TVSH						473,150	482,340

Referuar specifikave të këtyre zërave janë punime të cilat kryhen vetëm njëherë dhe nuk janë punime për mirëmbajtje rutine, në këto kushte duhet të ishte specifikuar që në fazën e hartimit të preventivit, arsyeya pse janë përfshirë në dy preventive. Pra, vlera e punimeve e paguara më tepër në situacione është **473,150 lekë**, pasi janë punime të realizuara në vitin 2020.

Për sa më sipër, në Kontratën e mirëmbajtjes 2019 rezultoi se për shkak të gabimeve aritmetike në preventivin e punimeve dhe punimeve të sistemimit të marra dhe në kontratën pasardhëse, vlera totale e punimeve e marrë më tepër është **1,027,150 lekë me TVSH**.

Konkluzion 7: Projekti "Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe" është përbërur me pengesa të rëndësishme që kanë ndikuar në vonesat për përfundimin e tij. Për më tepër, ndërprerja e kontratës dhe efekti i vendimit të arbitrazhit do të përfaqësojnë një ngarkesë të konsiderueshme financiare për buxhetin e shtetit, ndërkohë që këto fonde buxhetore mund të përdoren efektivisht në ndërtimin dhe përfundimin deri në operim të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Tiranë. Si rezultat, shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura në Tiranë nuk është realizuar, ndërkohë që vazhdojnë të llogariten interesat për huanë që ka financuar projektin. Menaxhimi i projektit ka treguar mangësi, gjë që kërkon një rishikim të procedurave dhe përmirësim të menaxhimit të kontratave dhe monitorimit të projekteve, për të shmangur vonesat mëtejshme dhe optimizuar përdorimin e fondeve. Sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura për qytetin e Tiranës vijon të jetë ende larg standardeve të BE-së dhe objektivave kombëtarë të vendosur në strategjitë sektoriale përkatëse.

Bazuar në analizën e dokumentacionit ligjor, vlerësimin e veprimeve institucionale dhe krahasimin me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale, arrihet në përfundimin se, institucionet shtetërore përgjegjëse (*MIE/ AKUK, Bashkia e Tiranës/ UKT sh.a.*) nuk kanë garantuar trajtimin e plotë dhe funksional të ujërave të ndotura urbane në qytetin e Tiranës, siç kërkohet nga kuadri ligjor kombëtar dhe praktikën e BE-së. Investimi i parashikuar për projektin WW111 në Tiranë përfaqëson një përpjekje për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të popullsisë për menaxhimin e ujërave të ndotura.

Konkluzion 8: Kontratat e mirëmbajtjes, kanë për qëllim ruajtjen e investimit dhe riparimet e dëmtimeve që shfaqen gjatë kësaj periudhe, por mosparashikimi i këtyre problematikave të pazgjidhura që janë zëra të nevojshëm për mirëmbajtjen e sistemit të ndërtuar, do të sjellin rritje të kostos së projektit e ri që do realizohet nga konsulenti, pavarësisht shpenzimeve për mirëmbajtjen. Kontratat e mirëmbajtjes janë konsideruar në përgjithësi si kontrata shërbimi mirëmbajtje rutinë

duke mos patur si fokus synimin për ruajtjen/mbrojtjen e strukturave nga amortizimi, e cila do të sjellë rritje të kostove për rivënien në punë të tyre në momentin e rinisjes së investimit. Si rrjedhojë e mosparashikimit të saktë të zërave të punimeve të mirëmbajtjes dhe për shkak të moskorrigjimit të ofertës ekonomike nga ana e AKUK, ka sjellë përdorimin pa ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike, përkatësisht për kontratën nr. 1005/2 prot., datë 29.03.2019 vlerën prej **554,000 lekë** dhe **473,150 lekë**.

12.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masat për (i) programimin e treguesve të qëndrueshëm të investimeve, në koordinim me institucionet dhe donatorët, dhe (ii) përfshirjen në prioritetet buxhetore të ndërtimit, të vënies në funksion dhe të operimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në Kashar, si projekt prioritar kombëtar, në PBA-në dhe buxhetin 2026–2028, në mënyrë që të përmbushin objektivat strategjike sektoriale dhe të shmangin ndikimet negative mjedisore dhe sociale.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe JICA-n të kryejnë vlerësimin e situatës për kapacitetin e impiantit të trajtimit të ujërave në përputhje me popullsinë aktuale dhe projeksionet për rritjen demografike të qytetit të Tiranës, me qëllim marrjen e masave sa më efektive për trajtimin e ujërave të ndotura në Qytetin e Tiranës. Kjo sidomos, në kushtet që Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve ka filluar procedurën për prokurimin e shërbimit të konsulencës së projektit, i cili në bazë të termave të referencës, në fazën e parë të tij do të bëjë të mundur rishikimin në tërësi të projektit, duke përfshirë edhe ndërtimin e Kolektorit të Ri të Jugut (New South Interceptor), nga Ura e Shkozës deri tek Pallati me Shigjeta.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1. Rekomandimi:

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve, nëpërmjet një grupi pune, të vlerësojë gjendjen aktuale të investimit, efektivitetin e shërbimeve të marra referuar kontratave të lidhura për mirëmbajtjen, si dhe të evidentojë problematikat në të. Në përfundim, të hartohet një relacion i posaçëm, i cili të shërbejë si pikënisje për shërbimet që do të kontraktohen për vitin pasardhës, brenda buxheteve në dispozicion nëpërmjet planifikimit në mënyrë më efektive për mirëmbajtjen e investimeve, deri në vënien e tyre në funksion.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1. Rekomandimi:

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës që kanë sjellë përdorimin pa ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të institucionit në vlerën totale prej 1,027,150 lekë me TVSH për kontratat “Shërbime mirëmbajtje për kantierin e punimeve për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, për vitin 2019 dhe 2020.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT